



NËPËR FEMINIZËM

qika

Nöpër Feminizëm

qika



PRISHTINA

Ky botim u realizua nga Qendra për Informim, Kritikë dhe
Aksion - QIKA, me mbështetjen e Komunës së Prishtinës.

Kopjen online të librit mund ta gjeni në www.qika.org.
Krijimi i kësaj platforme u mundësua me përkrahjen e European
Endowment for Democracy - EED.

Nëntor, 2022

NËPËR FEMINIZËM

qika

Pak fjalë mbi botimin

Teksa po diskutonim grumbullin e teksteve që ishin përkthyer nga aktivistet e QIKA-s, filluam ta imagjinojmë një libër të vogël që do të përmbledhte brenda disa nga trajtimet më të rëndësishme që na kishin influencuar. Pse pikërisht këto tekste? Pse jo disa të tjera?

Konceptet e feminizmit u shprehën në shkrime, vepra letrare e diskutime publike edhe para se të ekzistonte termi "feminizëm". Zhvillimi i gjuhës që i flet pabarazitë e shumëfishta ndikoi edhe në zgjerimin e mendimit dhe angazhimit për çështje që dikur i takonin sferës private dhe kodit moral, i cili fliste vetëm përmes zërit të burrit. Për më tepër, qasja në lexime feministe shpesh ka qenë e kufizuar për shumë gra, sidomos ato që vijnë nga vendet e vogla e të izoluara ku tekstet në gjuhën vendore ishin tejet të rralla.

Duke vlerësuar përkthimin e teksteve feministe si një formë të angazhimit, QIKA me anë të platformës online www.qika.org, tenton të zvogëloj këtë boshllëk, duke ofruar lajme, hulumtime e tekste të rëndësishme të përkthyer në gjuhën shqipe. Lirshëm mund të themi se asnjëherë më parë nuk ka pasur më shumë tekste në gjuhën shqipe që trajtojnë shtypjen dhe diskriminimin gjinor. Ne besojmë se përkthimi kontribuon në thellimin e mendimeve dhe krijimin e ideve për organizim, përtej kufijve.

Këto tekste të larmishme për nga temat që trajtojnë, e të fuqishme për nga qëndrimet, janë ofruar të përkthyer në gjuhën shqipe për herë të parë si koleksion - **Nëpër Feminizëm**. Në këtë botim, artikujt dhe intervistat nga autore e aktiviste të angazhuara, shtjellojnë disa nga çështjet kryesore që shqetësojnë botën.

Ky libër sot u bë i vërtetë, falë bindjes e përkushtimit të aktivisteve feministe në idenë se dija është publike dhe duhet të jetë e qasshme për të gjithë. Falas.

Leonida Molliqaj

Drejtore Ekzekutive dhe Kryeredaktore në QIKA

Përmbajtja

1. Elena Ferrante: “Edhe sot, pas një shekulli me feminizëm, nuk mund të jemi plotësisht vetja.”	1
2. Intervistë e Simone De Beauvoir-së: “Seksi i dytë” 25 vite më vonë...3	
3. Kam vendosur të mos kërkoj më falje.....	22
4. Judith Butler: Kur vrasja e grave nuk është krim.....	28
5. Neuroseksizmi: Miti se truri i burrave dhe i grave janë të ndryshëm.....	34
6. Kriza e përkujdesjes në kapitalizëm.....	40
7. Politikat mbi shtienat – Një histori e shkurtër e kundërshtimit feminist mbi to.....	50
8. Izolimi shpërfaq shfrytëzimin e grave nga sistemi ekonomik. Federici e ka paraparë këtë që moti.....	54
9. Stigma mbi menstruacionet është një formë e mizogjinisë.....	70
10. Si ndikojnë kapitalizmi dhe epërsia e të bardhëve në standardet e bukurisë.....	74
11. ‘Miti i virgjërisë’ ende po vazhdon!.....	81
12. Unë nuk jam feministe, por.....	87



ILLUSTRATION BY GABRIELA VANILA

Elena Ferrante: “Edhe sot, pas një shekulli me feminizëm, nuk mund të jemi plotësisht vetja”

Gjithçka është e kodifikuar në bazë të nevojave të burrave – madje edhe të brendshmet tona, praktika seksuale e amësia.

Në parim, unë refuzoj të flas keq për një grua tjetër, edhe nëse më ka ofenduar në formë të patolerueshme. Ndihej e detyruar të pozicionohem në këtë mënyrë, sepse jam e vetëdijshme për situatat nëpër të cilat kalojnë: e shoh te vetja, e shoh te të tjerat, dhe e di që nuk ka asnjë grua që për ta përfunduar ditën nuk i është dashur të kalojë nëpër situata të lodhshme e të mërzitshme. Të varfra apo të pasura, të shkolluara e të pashkolluara, të bukura e të shëmtuara, të famshme e të panjohura, të martuara apo beqare, të punësuara apo të papunësuara, me fëmijë ose pa fëmijë, rebele apo të dëgjueshme, që të gjitha vlerësohem nga një botë që sado që pretendojmë se është e jona, është e helmuar në rrënjë nga dominimi i burrave për shekuj të tërë.

Gratë jetojnë në mes të kontradiktave të përhershme e me punë të paqëndrueshme. Gjithçka, vërtet gjithçka, është e rregulluar sipas nevojave të burrave – madje edhe të brendshmet tona, praktikat seksuale dhe amësia. Ne duhet të jemi gra sipas roleve dhe mënyrave që i bëjnë burrat të lumtur. Mirëpo gjithashtu duhet të ballafaqohemi me ta; të garojmë kundër tyre në vende publike; t'i paraqesim më të mirë sesa që janë dhe sigurisht të kujdesemi që mos t'i ofendojmë.

Një grua e re të cilën e pëlqej shumë më tha: është gjithmonë problem me burra dhe jam mësuar të mos e “teproj”. Donte të thoshte se i është dashur ta mësojë veten që të mos jetë tepër e bukur, tepër inteligjente, tepër e kujdesshme, tepër e pavarur, tepër zemërgjerë, tepër agresive, apo tepër e sjellshme. Kjo “TEPËR” e një gruaje është shkaktare e veprimeve të dhunshme të burrave dhe përveç kësaj, shkakton armiqësi me gratë e tjera, të cilat çdo ditë janë të obliguara të luftojnë njëra-tjetrën për troshat që kanë mbetur nga burrat. Kurse, “TEPËR” e burrave shpie drejt një admirimi të përgjithshëm dhe fuqizimi të pozitës së tyre. Pasojë e kësaj nuk është vetëm fakti që e mbyl fuqinë e grave, por edhe që për hatër të paqes dhe qetësisë, ne ia zëmë frymën vetvetes. Edhe sot, pas një shekulli me feminizëm nuk mund të jemi tërësisht vetvetja, nuk i përkasim vetvetes.

Defektet, mizoritë, krimet, virtytet, kënaqësitë, si dhe gjuha jonë janë të gdhendura në hierarkinë e burrave; ato dënohen ose lavdërohen me kriteret që nuk na përkasin, prandaj edhe na stërlodhin. Është rrethanë e tillë në të cilën është e lehtë të jesh e urryer nga të tjerët e edhe nga vetja. Të tregojmë se kush jemi drejt një përpjekjeje për autonomi, kërkon të kemi vëmendje të pamëshirshme për vetveten.

Prandaj ndihem e afërt me të gjitha gratë, dhe ndonjëherë për një arsye, ndonjëherë për arsye tjetër, e shoh veten të më të mirat dhe të më të këqijat. A është e mundur, më pyesin njerëzit, që nuk e njeh as edhe një BITCH? I njoh disa, pa dyshim: në letërsi ka shumë, njësoj edhe në jetën e përditshme. Por, kur i konsideroj të gjitha rrethanat, prapëseprapë unë jam në anën e tyre.

Elena Ferrante në The Guardian

Përktheu: Njomza Tmava



© PORTRAIT BY ELLIOTT ERWITT

2

Intervistë e Simone De Beauvoir-së: “Seksi i dytë” 25 vite më vonë

Gerassi: Kanë kaluar rreth 25 vjet që kur “Seksi i dytë” është botuar. Shumë njerëz, sidomos në Amerikë, e shohin librin si fillimin e lëvizjes feministe. A e shihni edhe ju si të tillë?

Beauvoir: Unë nuk e shoh si të tillë. Lëvizja aktuale feministe, e cila realisht filloi rreth pesë apo gjashtë vite më parë, nuk e njihte vërtet librin tim. Pastaj, ndërsa lëvizja rritej, disa nga udhëheqëset morën prej librit disa prej bazës së tyre teorike. Por “Seksi i dytë” në asnjë mënyrë nuk nisi/solli lëvizjen feministe. Shumica e grave që u bënë shumë aktive në lëvizje, ishin shumë të reja në vitet 1949-50, kur doli libri, për t’u ndikuar nga ai. Ajo që më kënaq, sigurisht, është se ato e zbuluan atë më vonë. Sigurisht, disa nga gratë e moshuara – Betty Friedan, për shembull, e cila më kushtoi Mistikën Femërore – e kishin lexuar atë dhe ndoshta ishin ndikuar disi nga ai. Por të tjerët, aspak. Kate Millet, për shembull, nuk më citon një herë të vetme në punën e saj. Ato mund të jenë bërë feministe për arsyet që shpjegoj te “Seksi i dytë”; por ato i zbuluan ato arsye përmes përvojave të tyre të jetësore, jo përmes librit tim.

Gerassi: Keni thënë se vetëdija juaj feministe erdhi nga përvoja e shkrimit të “Seksit të dytë”. Si ndodhi kjo dhe si e shihni zhvillimin e lëvizjes pas botimit të librit në një trajektore personale?

Beauvoir: Duke shkruar “Seksin e dytë”, për herë të parë u bëra e vetëdijshme se unë vetë po bëja një jetë të rreme, ose më mirë të them pa ditur po përfitoja nga kjo shoqëri e orientuar nga burrat. Çfarë kishte ndodhur është se mjaft herët në jetën time kisha pranuar vlerat mashkullore dhe po jetoja në përputhje me to. Sigurisht, unë isha mjaft e suksesshme dhe kjo më forcoi besimin se burri dhe gruaja mund të ishin të barabartë nëse gruaja dëshironte një barazi të tillë. Me fjalë të tjera, unë isha një intelektuale. Pata fatin të vija nga një klasë e shoqërisë siç është borgjezia, e cila mund të përballonte jo vetëm të më dërgonte në shkollat më të mira, por edhe të më lejonte të luaja me ide. Për shkak të kësaj, unë arrita të hyj në botën e burrave pa shumë vështirësi. Unë u tregova se mund të diskutoja filozofinë, artin, letërsinë, etj. në “nivelin e burrave”. U sigurova të mbaja në vete gjithçka që e bën të veçantë gruan. Për të vazhduar më tutje, u përforcova nga suksesi im. Përgjatë kësaj, pashë se mund të bëja jetesë aq të mirë sa çdo intelektual burrë dhe se po merresha seriozisht si çdo burrë. Duke qenë ajo që isha, pashë se nëse doja mund të udhëtoja vetë, mund të ulesha në kafene, të shkruaja dhe të respektohesha si çdo shkrimtar burrë etj. Çdo fazë ma forcoi ndjenjën e pavarësisë dhe barazisë. Prandaj, u bë shumë e lehtë për mua të harroja se një sekretarëshë nuk mund të gëzonte në asnjë mënyrë të njëjtat privilegje. Ajo nuk mund të ulej në një kafene dhe të lexonte një libër pa u ngacmuar. Ajo ishte rrallë e ftuar në festa për shkak të “mendjes së saj”. Ajo nuk mund të merrte kredi ose të kishte pronë të sajën. Unë mundesha. Çfarë ishte edhe më e rëndësishme, isha e prirë të përbuzja llojin e gruas që ndihej e paafte financiarisht ose shpirtërisht, për t’i treguar pavarësinë e saj nga burrat. Në fakt, mendoja se “nëse unë mundem, edhe ato munden”. Gjatë hulumtimit dhe shkrimit të “Seksit të dytë”, unë kuptova se privilegjet e mia ishin rezultat i largimit të disa aspekteve thelbësore të të qenit grua. Nëse e kthejmë në terma ekonomikë të klasës, do ta kuptonit lehtë: Unë isha bërë një bashkëpunëtore e klasës. Në fakt, unë isha njëloj edhe për sa i përket

luftës së seksit. Përmes “Seksit të dytë”, u bëra e vetëdijshme për luftën që ishte e nevojshme. E kuptova se shumica dërrmuese e grave thjesht nuk i kishin zgjedhjet që unë kisha pasur, se gratë, në fakt, përcaktohen dhe trajtohen si seksi i dytë nga një shoqëri e orientuar nga burrat, struktura e së cilës do të prishej e do të kolapsonte totalisht nëse ai orientim shkatërrohet. Por te njerëzit në pozita të larta ekonomike dhe politike, zhvillimi i rebelimit është shumë i vështirë dhe i ngadaltë. Së pari, njerëzit e tillë duhet të bëhen të vetëdijshëm për këtë dominim. Më pas ata duhet të besojnë në forcën e tyre për ta ndryshuar atë. Ata që përfitojnë nga “bashkëpunimi” i tyre duhet të kuptojnë natyrën e tradhtisë së tyre. Dhe së fundmi, ata që dëmtohen më së shumti kur pozicionohen, domethënë gratë si unë që kanë gdhendur një karrierë të suksesshme, duhet të jenë të gatshëm të marrin rrezikun e pasigurisë – qoftë kjo thjesht tallje – në mënyrë që të fitojnë respekt për veten. Ata duhet të kuptojnë se motrat e tyre që janë më të shfrytëzuara do të jenë të fundit që do të mund t’i bashkohen lëvizjes. Gruaja e një punëtori, për shembull, është më pak e lirë të bashkohet me lëvizjen. Ajo e di se burri i saj është më i shfrytëzuar se shumica e lidereve feministe dhe se ai varet nga roli i saj si amvise dhe nënë për të mbijetuar. Sidoqoftë, për shkak të këtyre arsyeve, gratë nuk iu bashkuan lëvizjes. Kishte disa lëvizje shumë të mira, shumë të mençura, të cilat luftuan për pjesëmarrjen e grave në politikë e në qeveri. Por unë nuk mund të bashkohesha me grupe të tilla. Pastaj erdhi viti 1968 dhe gjithçka ndryshoi. Unë e di se disa ngjarje të rëndësishme kanë ndodhur edhe para kësaj. P.sh. libri i Betty Friedan-it, i cili u botua para vitit ’68. Në fakt, gratë amerikane ishin pjesë e lëvizjes edhe në atë kohë. Ato, më shumë se çdo grua tjetër, për arsye të qarta ishin më të vetëdijshme për kontradiktat midis teknologjisë së re dhe rolit konservator të mbajtjes së grave në kuzhinë. Ndërsa teknologjia zgjerohet – teknologjia si fuqi e trurit dhe jo e forcës fizike – arsyetimi mashkullor se gratë janë seksi i dobët dhe kështu duhet të luajnë një rol dytësor logjikisht nuk mund të ekzistojë më.

Meqenëse inovacionet teknologjike ishin kaq të përhapura në Amerikë, gratë amerikane nuk mund t'u shpëtonin kontradiktave. Kështu ishte normale që lëvizja feministe mori shtysën e saj më të madhe në zemrën e kapitalizmit imperialist, edhe nëse kjo shtysë ishte ekonomike, domethënë përmes kërkesës për pagë të barabartë të punës së barabartë. Zhvillimi i vetëdijes së vërtetë feministe ishte përbrenda vetë lëvizjes anti-imperialiste. Qoftë në lëvizjen kundër Luftës së Vietnamit në Amerikë, qoftë pas rebelimit të vitit 1968 në Francë dhe në vendet e tjera të Evropës, gratë filluan të kuptojnë fuqinë e tyre. Duke e kuptuar se kapitalizmi çon domosdoshmërisht në dominimin mbi popujt e varfër në të gjithë botën, masat e grave filluan t'i bashkohen luftës së klasave – edhe nëse nuk e pranonin vetë termin “luftë e klasave”. Ato u bënë aktiviste. U bashkuan me marshimet, demonstratat, fushatat, grupet ilegale, militantët e së majtës. Ato luftuan, ashtu si çdo njeri, për një të ardhme joshfrytëzuese, jotjetërsuese. Por çfarë ndodhi? Në grupet ose organizatat ku ato u bashkuan, zbuluan se ishin po aq “seks i dytë” sa në shoqërinë që dëshironin të përmbysnin. Këtu në Francë, dhe mund të them edhe në Amerikë, ato zbuluan se udhëheqësit ishin gjithmonë burrat. Gratë u bënë daktilografe e kafebërëse të këtyre grupeve pseudo-revolucionare. Në fakt nuk duhet të them pseudo. Shumë prej aktivistëve burra të lëvizjes ishin revolucionarë të mirëfilltë. Por të stërvitur, të rritur, të formuar në një shoqëri të orientuar nga burrat, këta revolucionarë sollën atë orientim edhe në lëvizje. Kuptohet, njerëz të tillë nuk do të heqin dorë vullnetarisht nga ky orientim, ashtu si klasa borgjeze nuk do të heqë dorë vullnetarisht nga fuqia e saj. Pra, ashtu siç u takon të varfërve që të marrin pushtetin nga të pasurit, ashtu u takon grave që të marrin pushtetin nga burrat. Dhe kjo nuk do të thotë se burrat tani të jenë të dominuar. Do të thotë të vendoset barazi. Ndërsa socializmi, socializmi i vërtetë, vendos barazinë ekonomike mes të gjithë njerëzve, lëvizja feministe mësoi se duhej të vendoste barazinë midis gjinive duke marrë pushtetin nga klasa sunduese brenda lëvizjes, domethënë nga burrat. Për ta thënë ndryshe: sapo hynë në luftën e klasave,

gratë e kuptuan se lufta e klasave nuk e eliminonte luftën e seksit. Në atë moment unë vetë u bëra e vetëdijshme për atë që sapo thashë. Para kësaj isha e bindur se barazia e gjinive mund të jetë e mundur vetëm kur shkatërrohet kapitalizmi, prandaj – dhe mashtrimi qëndron te kjo “prandaj” – ne së pari duhet të luftojmë dallimet klasore. Është e vërtetë se barazia e gjinive është e pamundur në kapitalizëm. Nëse të gjitha gratë punojnë sa burrat, çfarë do të ndodhë me ato institucione nga të cilat varet kapitalizmi, institucione të tilla si kisha, martesja, ushtria dhe miliona fabrika, dyqane etj., të cilat varen nga puna me orar të pjesshëm dhe fuqia punëtore e paguar lirë e pak? Por nuk është e vërtetë se një revolucion socialist vendos domosdoshmërisht barazi gjinore. Shikoni Rusinë Sovjetike ose Çekosllovakinë, ku (edhe nëse jemi të gatshëm t’i quajmë ato vende “socialiste”, edhe pse jo nga unë) ka një paqartësi të thellë midis emancipimit të proletariatit dhe emancipimit të grave. Disi, proletariati gjithmonë del të jetë i përbërë nga burrat. Vlerat patriarkale kanë mbetur të paprekura si atje, si këtu. Dhe kjo – kjo vetëdije mes grave që lufta e klasave nuk mishëron luftën e seksit – është risia. Megjithatë, shumica e grave në lëvizje tashmë e dinin këtë. Kjo është arritja më e madhe e lëvizjes feministe. Është një arritje që do të ndryshojë historinë në vitet që vijnë.

Gerassi: Por një vetëdije e tillë është e kufizuar vetëm te gratë që janë pjesë e së majtës, domethënë gratë që janë të përkushtuara në ristrukturimin e të gjithë shoqërisë.

Beauvoir: Natyrisht, kjo vjen si pasojë e pjesës tjetër që është konservatore, domethënë ata duan të ruajnë atë që ka qenë ose atë që është. Gratë e së djathtës nuk duan revolucion. Ato janë nëna e gra të përkushtuara ndaj burrave të tyre. Edhe nëse ato janë rebele, thjesht e bëjnë sepse duan një copë më të madhe të “tortës”. Ato duan të fitojnë më shumë, të zgjedhin më shumë gra në parlament, të shohin një grua presidente. Ato besojnë thelbësisht në pabarazi, problemi këtu është se ato duan të jenë në krye të kësaj pabarazie e jo në fund.

Por ato përshtaten mirë në këtë sistem ashtu siç është, ose do të përshtateshin edhe nëse ky sistem ndryshon pak sa për të përmbushur kërkesa të tilla. Sigurisht që kapitalizmi mund të lejojë gratë të bashkohen në ushtri apo në polici. Sigurisht kapitalizmi është mjaftueshëm inteligjent sa të lejojë më shumë gra të jenë pjesë e qeverisë. Pseudosocializmi sigurisht që mund të lejojë një grua të bëhet sekretare e përgjithshme e partisë së saj. Këto janë vetëm reforma si sigurimet shoqërore ose pushimet me pagesë. A e ndryshoi institucionalizimi i pushimeve të paguara pabarazinë e kapitalizmit? A e ndryshoi e drejta e grave për të punuar në fabrika me pagë të barabartë me burrat orientimin burrëror të shoqërisë çeke? Revolucionar do të ishte ndryshimi i gjithë sistemit të vlerave të shoqërisë dhe shkatërrimi i konceptit të amësisë.

Gerassi: Por një vetëdije e tillë është e kufizuar vetëm te gratë që janë pjesë e së majtës, domethënë gratë që janë të përkushtuara në ristrukturimin e të gjithë shoqërisë.

Beauvoir: Natyrisht, kjo vjen si pasojë e pjesës tjetër që është konservatore, domethënë ata duan të ruajnë atë që ka qenë ose atë që është. Gratë e së djathtës nuk duan revolucion. Ato janë nëna e gra të përkushtuara ndaj burrave të tyre. Edhe nëse ato janë rebele, thjesht e bëjnë sepse duan një copë më të madhe të “tortës”. Ato duan të fitojnë më shumë, të zgjedhin më shumë gra në parlament, të shohin një grua presidente. Ato besojnë thelbësisht në pabarazi, problemi këtu është se ato duan të jenë në krye të kësaj pabarazie e jo në fund. Një feministe, pavarësisht nëse e quan veten të majtë apo jo, nga përkufizimi është e majtë. Ajo po lufton për barazi totale, për të drejtën që të jetë po aq e rëndësishme, aq relevante, sa çdo burrë. Prandaj, e mishëruar në revoltën e saj për barazi gjinore është kërkesa për barazi klasore. Në një shoqëri ku burri mund të jetë “nënë”, ku, për të shtyrë argumentin mbi vlerat, e ashtuquajtura “intuitë femërore” është po aq e rëndësishme sa “njohuria mashkullore”. Për ta thënë në gjuhën absurde të së sotmes – ku të jesh i/e kujdesshëm/e ose i/ e butë është më

mirë sesa të jesh i/e vrazhdë dhe i/e ashpër, me fjalë të tjera, në një shoqëri ku përvojat e secilit person janë ekuivalente me të tjetrit, automatikisht ke vendosur barazi, që nënkupton barazi ekonomike, politike dhe shumë më tepër. Kështu, lufta e seksit mishëron luftën e klasave, por lufta e klasës nuk mishëron luftën e seksit. Pra, feministët janë të majtë të mirëfilltë. Në fakt, ata janë në të majtë të asaj që ne tani tradicionalisht e quajmë të majtë politike.

Gerassi: Por ndërkohë, duke zhvilluar luftën e seksit vetëm brenda së majtës – pasi, siç e keni thënë, lufta gjinore, të paktën përkohësisht, është e parëndësishme brenda sektorëve të tjerë politikë – a nuk janë feministët që dobësojnë të majtën, duke forcuar ata që shfrytëzojnë gratë dhe të varfrit?

Beauvoir: Jo, dhe në planin afatgjatë vetëm mund të forcojnë të majtën. Në fakt, duke u ballafaquar si të majtë, domethënë, si kundërshtarë të shfrytëzimit, burrat e majtë janë të detyruar të fillojnë të filtrojnë veten. Gjithnjë e më shumë grupet ndihen të detyruar të mbajnë nën kontroll drejtuesit e tyre që janë burra “macho”. Ky është progres. Në gazetën tonë, Libération, shumica e orientuar drejt burrave u ndie e detyruar të linte një grua të bëhej drejtoreshë e gazetës. Ky është progres. Burrat e së majtës kanë filluar të kenë kujdes me gjuhën e tyre, kanë filluar...

Gerassi: Por a është kjo e vërtetë? Unë kam mësuar për shembull të mos e përdor kurrë fjalën “chick”; t’u kushtoj vëmendje grave në çdo diskutim grupor; t’i laj enët; ta pastroj shtëpinë; t’i bëj pazaret. Por a janë mendimet e mia më pak seksiste? A i kam hedhur poshtë vlerat mashkullore?

Beauvoir: Do të thuash brenda teje? Të them hapur, kujt i intereson? Mendoni për një minutë. Ju e njihni një racist. E dini se ai është racist, sepse e keni njohur gjatë gjithë jetës së tij. Por tani ai kurrë nuk thotë “nigger”. Ai dëgjon të gjitha ankesat e burrave të zinj dhe përpiqet të bëjë më të mirën për t’u marrë me to. Ai bën gjithçka për t’i qortuar racistët.

Ai këmbëngul që fëmijëve të zinj t'u jepet një arsimim mbi mesataren për të kompensuar vitet e tyre pa arsimim. Ai jep referenca të mira për burra të zinj kur ata aplikojnë për kredi. Ai mbështet kandidatët zezakë në qytetin e tij me para, ashtu edhe me votë. A mendoni se zezakët merakosen nëse ai është ende racist “në shpirtin e tij”? Një pjesë e madhe e shfrytëzimit objektiv është zakonor. Nëse mund të kontrolloni zakonet tuaja, bëjeni “të natyrshme” të keni kundërveprime. Nëse lani enët, pastroni shtëpinë dhe pranoni se nuk ndiheni më pak “burrë” kur e bëni, ju po ndihmoni në krijimin e zakoneve të reja. Kur disa breza ndiejnë se në çdo kohë duhet të duken joracistë, brezi i tretë do të jetë joracist. Prandaj luani si joseksist dhe vazhdoni të luani si të tillë. Mendojeni tërë procesin si një lojë. Në mendimet tuaja private, vazhdoni e mendoni se jeni më superior se gratë. Por për sa kohë që ju luani bindshëm – vazhdoni t'i lani enët, t'i bëni pazaret, ta pastroni shtëpinë, të kujdeseni për fëmijët – krijoni precedentë, veçanërisht nëse jeni burra si ju që keni një qëndrim “macho”. Problemi është se unë nuk e besoj se vërtet do t'i bëni. Unë nuk mendoj se ju me të vërtetë do të vazhdoni të bëni atë që thoni. Është një gjë t'i lani enët; është një tjetër gjë t'i ndryshoni pelenat ditë për ditë.

Gerassi: Por unë nuk kam fëmijë...

Beauvoir: Dhe pse nuk keni? Sepse keni vendosur të mos keni. A mendoni se disa nga nënat që kanë fëmijë kanë vendosur vetë për këtë? Apo janë detyruar të kenë? Apo të themi më mirë janë rritur në atë mënyrë që të mendojnë se të kesh fëmijë është krejtësisht natyrore dhe femërore, kështu duke i bërë të mendojnë se ato kanë vendosur vetë? Kush e ka bërë këtë vendim të paevitueshëm? Këto janë vlerat që duhen të ndryshohen.

Gerassi: Në rregull. Kjo është arsyeja pse unë e kuptoj që shumë feministe kanë insistuar të jenë separatiste. Por për sa i përket revolucionit, a mund të fitojmë nëse ndahemi në grupe krejtësisht të veçanta? A mundet lëvizja feministe të arrijë qëllimet e saj duke përjashtuar burrat nga lufta e saj?

Pjesa dominuese e lëvizjes të grave sot, këtu në Francë të paktën, po ashtu edhe në Amerikë, janë separatiste.

Beauvoir: Ne duhet të hetojmë pse ato janë separatiste. Nuk mund të flas për Amerikën, por këtu në Francë ka shumë grupe, grupe të ndërgjegjes, të cilat përjashtojnë burrat sepse e kanë shumë të rëndësishme ta rizbulojnë identitetin e tyre si gra për ta kuptuar veten si gra. Ato mund ta bëjnë këtë vetëm duke folur mes tyre, duke i thënë njëra-tjetrës gjëra që kurrë nuk do të guxonin t'i thoshin para burrave, të dashurve, vëllezërve, baballarëve ose ndonjë fuqie tjetër mashkullore. Nevoja e tyre për të folur me intensitetin dhe ndershmërinë e kërkuar mund të përmbushet vetëm në këtë mënyrë. Ato kanë arritur të komunikojnë me një thellësi, që kur isha 25 vjeç kurrë nuk e kam menduar si të mundur apo të imagjinueshme. Problemet e grave nuk u diskutuan kurrë edhe kur isha me mikeshat më të afërta. Për shkak të këtyre grupeve të ndërgjegjes dhe për shkak të ashpërsisë së dëshirës për t'u përballur me problemet e grave brenda këtyre grupeve, miqësi të vërteta janë zhvilluar midis grave. Dua të them, në të kaluarën, në rininë time, deri para pak kohësh, gratë nuk ishin kurrë kaq miqësore me gratë e tjera. Ato e shihnin njëra-tjetrën si rivale e armike ose të paktën si konkurrente. Tani, si rezultat kryesisht i këtyre grupeve të ndërgjegjes, jo vetëm që gratë janë të afta të jenë shoqe, por ato kanë mësuar të jenë të ngrohta, të hapura, thellësisht të buta me njëra-tjetrën: ata po e bëjnë motërzimin realitet – dhe pa e bazuar atë marrëdhënie vetëm në seksualitet. Sigurisht, ka shumë beteja, ndër to beteja të rrepta feministe e me ndikim shoqëror në të cilat gratë presin që burrat të bashkohen. Në shumë prej tyre edhe janë bashkuar. Unë jam duke menduar, për shembull, luftën për legalizimin e abortit. Kur organizuam protestën e parë masive në lidhje me këtë çështje, tre ose katër vjet më parë, më kujtohet mirë numri i madh i burrave të pranishëm. Kjo nuk do të thotë se ata nuk ishin seksistë: të çrrënjosësh atë që është ngulitur në modelin e sjelljes dhe sistemin e vlerave të dikujt

nga ditët e hershme të fëmijërisë kërkon vite, dekada. Por këta ishin burra që të paktën ishin të vetëdijshëm për seksizmin në shoqëri dhe morën një qëndrim politik kundër tij. Në raste të tilla burrat janë të mirëpritur e të inkurajuar t'i bashkohen luftës.

Gerassi: Por ka edhe shumë grupe, të paktën këtu në Francë, të cilët shpallin me krenari separatizmin e tyre dhe e përcaktojnë luftën e tyre si tërësisht lezbike.

Beauvoir: Le të jemi të qartë. Brenda LÇG-së [Lëvizja Çlirimtare e Grave] ka shumë grupe të cilat e quajnë veten lezbike. Shumë nga këto gra, në sajë të LÇG-së dhe grupeve të ndërgjegjes, tani janë në gjendje të thonë haptas se janë lezbike dhe kjo është e mrekullueshme. Dikur nuk ishte kështu. Ka gra të tjera që nga angazhimi politik janë bërë lezbike: domethënë, ato mendojnë se është një akt politik të jesh lezbike. Kjo pak a shumë është ekuivalente me përpjekjen feministe të grave të zeza përbrenda luftës racore. Është e vërtetë që këto gra priren të jenë më dogmatike në lidhje me përjashtimin e burrave nga lufta e tyre. Por kjo nuk do të thotë se ato i injorojnë betejat e shumta që po bëhen kudo kundër shtypjes. Për shembull, kur Pierre Overney, organizatori i ri maoist, u vra nga një polic i fabrikës Renault për mosnënshtrim gjatë një demonstrate dhe e gjithë e majta bëri një marshim proteste nëpër Paris, të gjithë këto të ashtuquajtura separatiste lezbike radikale u bashkuan me demonstratën dhe çuan lule te varri i tij. Kjo, nga ana tjetër, nuk do të thoshte se ato shprehën solidaritetin e tyre me Overney-n, por që ato u identifikuan me protestën kundër shtetit, i cili shfrytëzon dhe abuzon njerëzit – gra dhe burra.

Gerassi: Një nga pasojat e çlirimit të grave, sipas sondazheve të fundit të kryera në kampuset amerikane, është se paaftësia e burrave është rritur shumë, veçanërisht midis atyre të rinjve që përpiqen të përballen me seksizmin e tyre...

Beauvoir: Është faji i tyre. Ata përpiqen të luajnë role ...

Gerassi: Por, tani ata janë bërë të vetëdijshëm se dikur luanin role, të vetëdijshëm që ka qenë e lehtë të ishte “macho” dhe të pretendojë se ishte tip egoist e i fuqishëm. Ata tani e kuptojnë se shpesh mendonin se duhej të kryenin marrëdhënie ose të tentonin të joshnin gruan, sepse kjo ishte ajo që pritej nga ta, ndërsa tani...

Beauvoir: Ata ishin bërë të vetëdijshëm për rolin që luanin, i cili megjithatë i kënaqte ata – në të dyja aspektet, domethënë ishte i lehtë dhe i kënaqte ata seksualisht – ndërsa tani ata duhet të shqetësohen për të kënaqur gruan e kështu nuk mund të kënaqin veten e tyre. Shumë keq. Nëse ata ndiejnë dashuri të sinqertë për gratë me të cilat janë, nëse janë të sinqertë me veten dhe me partnerët e tyre, ata automatikisht do të mendonin të kënaqnin edhe ato, edhe veten. Tani ata janë të shqetësuar nëse shihen si seksist nëse nuk e kënaqin gruan, kështu që nuk ndërmarrin veprim fare. Por e gjithë kjo është një lloj veprimi, apo jo? Burra të tillë janë të paafte për shkak të kontradiktës që e jetojnë. Është i pafat ky grup burrash, që të paktën janë të vetëdijshëm për seksizmin dhe vuajnë më shumë nga lëvizja e grave. Ndërsa shumica dërrmuese e burrave përfitojnë prej saj, duke e bërë jetën më të patolerueshme për gratë...

Gerassi: Përfitojnë?

Beauvoir: Pak kohë më parë po flisnim se si LÇG-ja ka ndihmuar gratë të krijojnë motërzim, afërsi për njëra-tjetrën etj. Kjo mund të ketë krijuar përshtypjen se unë mendoj se gratë tani janë më mirë. Ato nuk janë më mirë. Lufta sapo ka filluar dhe në fazat e hershme e bën jetën shumë më të vështirë. Për shkak të publicitetit, fjala “çlirim” është në majë të gjuhës së çdo burri, pavarësisht nëse është i vetëdijshëm për shtypjen seksuale të grave apo jo. Tani qëndrimi i përgjithshëm i burrave është se “mirë, jeni çliruar. Tani le të shkojmë në shtrat”. Me fjalë të tjera, burrat tani janë shumë më agresivë, vulgarë e të dhunshëm. Në rininë time mund të shëtisnim në “Montparnasse” ose të uleshim në kafene pa u ngacmuar. Merrnim buzëqeshje, shikime, vështrime etj. Por tani është e pamundur

që një grua të ulet vetëm në një kafene e të lexojë një libër. Dhe nëse ajo është e vendosur kur burrat e ngacmojnë, vërejtjet e tyre e cilësojnë atë shpesh si salope [kurvë] ose putain [lavire]. Tani ka shumë më shumë përdhunime. Në përgjithësi, agresiviteti dhe armiqësia e burrave është bërë aq e zakonshme, sa asnjë grua nuk ndihet e qetë në këtë qytet e në asnjë qytet tjetër në Amerikë. Kjo nuk vjen në shprehje nëse gratë qëndrojnë në shtëpi. Dhe kjo është ajo që qëndron pas këtij agresiviteti mashkullor: kërcënimi që, në sytë e burrave, çlirimi i grave ka sjellë pasigurinë e tyre, prandaj zemërimi i burrave ka bërë që ata tani të sillen sikur vetëm gratë që qëndrojnë në shtëpi janë “të pastra”, ndërsa të tjerat janë shënjestra të lehta. Kur gratë tregojnë se nuk janë shënjestra aq të lehta, burrat sfidohen në nivel personal. Ideja e tyre është të “marrin” gruan.

Gerassi: Çfarë ka ndodhur me mitin, të cilin çdo burrë francez e mbështeti, por që sigurisht nuk ishte kurrë i vërtetë, se dashuria është një art dhe se ai ishte artisti më i mirë nga të gjithë?

Beauvoir: Me përjashtim të disa shtresave parazitare shumë të pasura të shoqërisë, miti ka vdekur. Francezët tani sillen si burra amerikanë ose italianë: ata thjesht duan “të shënojnë”. Përveç një numri të vogël të burrave që përpiqen të përballen me seksizmin e tyre, shumica mbajnë qëndrimin që sa më e lirë të jetë një grua dhe sa më shumë ajo përpiket për aspektin material dhe karrierën e saj, në botën e tyre, në botën e burrit, aq më e lehtë duhet të jetë ajo për të shkuar në shtrat me ta.

Gerassi: Biseda për liri më të madhe për gratë më çudit. Në shoqërinë tonë, liria arrihet me para dhe pushtet. A kanë më shumë pushtet gratë sot, pas gati një dekade të lëvizjes së grave?

Beauvoir: Në kuptimin në të cilin ju po pyesni, jo. Gratë intelektuale, gratë e reja që janë të gatshme të rrezikojnë marginalizimin, bijat e të pasurve kur janë të gatshme dhe të afta të heqin dorë nga sistemi i vlerave të prindërve të tyre: këto gra janë më të lira. Pra, për shkak të arsimimit, stilit të jetës ose burimeve të tyre financiare, gratë e tilla mund të tërhiqen nga

shoqëria e ashpër konkurruese, të jetojnë në vendbanime të caktuara dhe të zhvillojnë marrëdhënie me gra ose burra të tjerë të ngjashëm, që ndajnë problemet e njëjta me to dhe kështu të ndihen më të lira. Me fjalë të tjera, si individë, gratë që mund ta përballojnë këtë liri, për çfarëdo arsye, mund ta kenë atë. Por si klasë, gratë sigurisht që nuk janë më të lira, pikërisht sepse siç thoni ju, ato nuk kanë fuqi ekonomike. Në ditët e sotme ka lloj-lloj statistika që vërtetojnë se numri i grave avokate, politikane, mjeke etj. po rritet. Por statistika të tilla janë mashtruese... Sa gra avokate mund të telefonojnë një gjykatës ose zyrtar qeveritar për të rregulluar ndonjë çështje ose për të kërkuar një të mirë? Gratë e tilla gjithmonë duhet të veprojnë përmes burrave ekuivalentë në detyrë. Gra mjeke? Sa janë kirurge, drejtore të spitaleve? Gra në qeveri? Po, ca sa për simbolikë. Në Francë kemi dy. Njëra, serioze e punëtore, Simone Veil, e cila është ministre e Shëndetësisë. Tjetra, Françoise Giroud, e cila është ministrja që ka për detyrë të merret me gratë. Kjo e fundit është kukull që synon të fashisë nevojat e grave borgeze për integrimin e tyre në sistem. Por sa gra kontrollojnë ndarjet buxhetore të Senatit? Sa gra kontrollojnë politikën editoriale të gazetave? Sa janë gjyqtare? Sa janë presidente të bankave të afta për të financuar ndërmarrjet? Vetëm sepse ka shumë më tepër gra në pozicione të nivelit të mesëm, siç thonë gazetarët, në asnjë mënyrë nuk do të thotë se ato kanë pushtet. Madje edhe ato gra në pozicione të mesme, që të kenë sukses duhet të luajnë lojën e burrave. Kjo nuk do të thotë që nuk besoj se gratë nuk kanë bërë përparim në luftën e tyre. Por progresi është rezultat i veprimtimit masiv. Konsiderojeni ligjin e ri të abortit të propozuar nga Simone Veil. Pavarësisht nga fakti se abortet nuk do të mbulohen nga programi kombëtar shëndetësor dhe kështu do të jenë më të qasshëm për të pasurit sesa për të varfrit, prapëseprapë ligji është një hap i madh përpara. Me gjithë mundin që Simone Veil luftoi për një ligj të tillë, arsyeja që ajo mund ta ngriste si çështje në rend të parë, është sepse mijëra gra kanë krijuar trazira në të gjithë Francën për një ligj të tillë, sepse mijëra gra kanë pohuar

publikisht se kanë kryer aborte (duke detyruar qeverinë që ose t'i ndjekë ato ligjërisht, ose të ndryshojë ligjin), sepse qindra mjekë dhe mami kanë rrezikuar ndjekje penale kur pranuan se kanë kryer aborte, sepse disa nga ta u gjykuan dhe luftuan për këtë çështje në gjykata etj. Ajo që unë po them është se përmes veprimeve masive, gratë mund të kenë fuqi. Sa më shumë gra të ndërgjegjësohen për nevojën e një veprimi të tillë masiv, aq më shumë përparim do të arrihet. Dhe për t'u kthyer te gruaja që ka mundësi të kërkojë çlirimin individual, sa më shumë që ajo mund të ndikojë te miqtë dhe motrat e saj, aq më shumë do të përhapet vetëdija, e cila nga ana tjetër, kur zhgënjehet nga sistemi, do të stimulojë veprim masiv. Sigurisht që sa më shumë që përhapet vetëdija, aq më shumë burra do të jenë agresivë dhe të dhunshëm. Por sa më shumë burra të jenë agresivë, aq më shumë gra do të kenë nevojë për gra të tjera për të luftuar, kështu nevoja për veprim masiv do të jetë e qartë. Shumica e punëtorëve të botës kapitaliste sot janë të vetëdijshëm për luftën e klasave, pavarësisht nëse ata e quajnë veten marksistë apo jo, madje pavarësisht nëse ata kanë dëgjuar ndonjëherë për Marks. Kjo duhet të ndodhë edhe në luftën e seksit. Kështu do të ndodhë.

Gerassi: Ju vitin e kaluar më thatë se po mendonit të shkruanit një libër tjetër për gratë, një lloj vazhdimi i “Seksit të dytë”. A jeni duke e shkruar?

Beauvoir: Jo. Në radhë të parë, një punë e tillë do të duhej të ishte një përpjekje kolektive. Më pas ajo përpjekje më parë duhet të rrënohet në praktikë sesa në teori. “Seksi i dytë” u fokusua në teori. Kjo nuk është më e vlefshme. Vetëm në praktikë mund të shihet se si ndërthuren lufta e klasave dhe lufta e seksit, ose të paktën se si ato mund të artikulohen. Por kjo është e vërteta për të gjitha betejat: ne duhet ta nxjerrim teorinë tonë nga praktika, jo e kundërta. Ajo që në të vërtetë është e nevojshme, është që një grup i tërë grash, nga të gjitha vendet, të mbledhin përvojat e tyre dhe që ne më pas të nxjerrim modelet me

të cilat përballen gratë kudo nga përvojat e tilla. Për më tepër, një informacion i tillë duhet të grumbullohet nga të gjitha klasat dhe kjo është dyfish më e vështirë. Gratë që luftojnë sot luftën për çlirim janë kryesisht borgjeze intelektuale; në përgjithësi, gratë e punëtorëve dhe madje edhe punëtorët mbeten fort të lidhura me sistemin e vlerave të klasës së mesme të shoqërisë. Përpiquni, për shembull, të flisni me punëtorët gra për të drejtat e prostitutave dhe respektin që u takon atyre. Ky koncept në vetë është tronditës për shumicën e grave punëtoresh. Rritja e ndërgjegjësimit të grave punëtoresh është një proces shumë i ngadaltë që kërkon shumë ndjeshmëri. Unë e di se ka ekstremistë të LÇG-së që po përpiqen të bëjnë që gratë e punëtorëve të rebelohen kundër burrave të tyre si burra shtypës. Unë mendoj se kjo është gabim. Gruaja e një punëtori, të paktën këtu në Francë, do të përgjigjet se, “armiku im nuk është burri im, por shefi im”. Përgjigje kjo që vjen edhe nëse asaj i duhet t’ia lajë çorapet burrit dhe t’ia bëjë supën, edhe pasi ajo ka punuar një ditë të tërë në ndonjë fabrikë. E njëjta gjë ndodhi edhe në Amerikë, ku gratë e zeza nuk pranuan të dëgjonin misionaret e lëvizjes çlirimtare të grave për arsyen se ato ishin të bardha. Këto gra të zeza mbetën mbështetëse të burrave të tyre pavarësisht shfrytëzimit, thjesht sepse personat që përpiqeshin t’i vinin në dijeni të shfrytëzimit ishin të bardha. Megjithatë, gradualisht, një feministe borgjeze mund të ndikojë gruan e një punëtori, njëjtë sikur sot në Amerikë ka disa gra të zeza – shumë pak, jua them unë – që thonë: “jo, ne nuk duam t’i nënshtrohemi shtypjes së burrave tanë me pretekstin se janë të zinj dhe se duhet të luftojmë së bashku me ta kundër të bardhëve; jo, kjo nuk është një arsye që burrat tanë të na shtypin, vetëm sepse ata janë burrat tanë të zi”.

Sidoqoftë, në disa mënyra shumë konkrete, lufta e klasave inkurajon dhe zhvillon luftën e seksit. Për shembull, gjatë viteve të fundit ka pasur shumë greva këtu në Francë ku punëtorët ishin pothuajse të gjitha gra. E kam fjalën për grevën e tekstitil në Troyes, në Veri, ose në Galeritë Nouvelles në Thionville ose grevën e famshme në Lip. Në secilin rast, gratë punëtoresh

jo vetëm që fituan një vetëdije të re, por fituan edhe një besim të ri ose më të fortë në fuqinë e tyre dhe ky besim prishi sistemin mashkullor me të cilin përballeshin në shtëpitë e tyre. Në Lip, për shembull, gratë uzurpuan punëtorinë dhe refuzuan ta evakujnë atë pavarësisht kërcënimeve nga policia që ata do të përdornin forcën për t'i nxjerrë ato jashtë. Në fillim, burrat e punëtoreve ishin shumë krenarë për gratë e tyre luftarake. Burrat u sollën atyre ushqim, u ndihmuan në realizimin e pankartave të protestave etj. Por kur gratë vendosën të ishin plotësisht të barabarta me ata pak burra që gjithashtu punonin në Lip dhe që ishin po ashtu në grevë, atëherë lindën problemet. Grevistët e Lipit vendosën të organizoheshin me ndërrime për të mbrojtur fabrikën nga pushtimi i policisë. Kjo nënkuptonte edhe ndërrimin e natës. Oh, tani, papritmas, burrat e grave në grevë ishin të mërzhitur. “Ju mund të godisni dhe të trazoni gjithçka që dëshironi”, thanë ata. “Por vetëm ditën, jo natën.” “Doni të bëni rojë? Jo! Duke fjetur së bashku në dhoma të përbashkëta me ndërrime? Jo!” Natyrisht, gratë punëtore rezistuan. Ato kishin luftuar për barazi dhe nuk do të hiqnin dorë tani. Kështu që ato u angazhuan për një luftë të dyfishtë: nga njëra anë luftën e klasave kundër shefave të Lipit, policinë, qeverinë, etj., dhe nga ana tjetër luftën e seksit kundër burrave të tyre. Organizatorët e sindikatës në Lip raportuan se pas grevës gratë ishin transformuar plotësisht, duke thënë se “një gjë që mësuam nga e gjithë kjo është se kurrë më nuk do t'i lejojmë burrat tanë të luajnë shefin në shtëpi. Tani jemi kundër të gjithë shefave”.

Gerassi: A ndryshoi vetëdija juaj për pleqërinë përderisa keni shkruar për të, ashtu siç ndryshoi vetëdija e të qenit grua gjatë shkrimit të “Seksit të dytë”?

Beauvoir: Realisht jo. Zbulova shumë gjëra; mësova shumë për njerëzit e moshuar. Por në të vërtetë nuk fitova një vetëdije të re, sepse kuptimi që isha e vjetër më bëri të ndërmarr librin në radhë të parë. Por tani unë mund të bashkëndiej me të vjetrën shumë më mirë se më parë.

Dikur isha shumë më e ashpër. Tani e kuptoj se kur një person i moshuar është shumë i ndjeshëm, shumë egoist, ai vetëm po vetëmbrohet. Por e shihni, një grua mund të kalojë gjithë jetën duke refuzuar të përballet me faktin se ajo është thelbësisht ndryshe nga burrat, në vlera, përvojë dhe qasje jetësore. Por është shumë e vështirë të shmangësh ndërgjegjësimin se po plakesh. Vjen një kohë kur thjesht e dini se duhet të vendosni limite ose që i keni kaluar limitet. Unë e di që sot kurrë nuk do të jem në gjendje të endem nëpër kodra në këmbë, se nuk do të ngas biçikletë kurrë më, se kurrë më nuk do të kem marrëdhënie me një burrë. Unë isha shumë e frikësuar ose të paktën shumë e shqetësuar për plakjen edhe para se ta arrija atë. Pastaj, kur erdhi, kur e dija që e kisha kaluar limitin, ishte shumë më lehtë sesa prisja. Sigurisht, ju duhet të ndaloni së shikuari prapa. Por të jetuarit nga dita në ditë është shumë më e lehtë sesa mendoja. Por mësova se e kisha kaluar atë limit pavarësisht nga hulumtimi im për librin tim mbi pleqërinë. Puna për librin thjesht më mësoi të kuptoj të vjetrën dhe të jem më tolerante.

Gerassi: Çfarë po punoni tani?

Beauvoir: Faktikisht, asgjë. Po ndihmoj në një skenar, në lidhje me pleqërinë, për një regjisor suedez. Unë do të ndihmoj Sartre-n me projektin e tij televiziv. Ju e dini se ai ka nënshkruar një kontratë me televizionin kombëtar për të bërë dhjetë shfaqje njëorëshe, që do të fillojnë në tetor dhe kanë të bëjnë me shtatëdhjetë e pesë vitet e këtij shekulli dhe lidhjen e tij me ngjarjet kryesore gjatë kësaj kohe. Por nuk kam ndërmend të ndërmarr ndonjë projekt të veçantë. Kjo është diçka e re për mua. Dikur kisha në mendjen time lloj-lloj projekti edhe përgjatë kohës kur isha duke punuar në ndonjë libër specifik.

Gerassi: Ju keni shkruar që keni pasur një jetë të mirë dhe nuk pendoheni për asgjë. A jeni në dijeni se ka shumë çifte që e shikojnë jetën tuaj me Sartre-n si model, veçanërisht në kuptimin që nuk ishit xhelozë për njëritjetrin dhe që kishit atë që quhet një marrëdhënie e hapur dhe se funksionoi për dyzet e pesë vjet?

Beauvoir: Është qesharake të na përdorësh si model. Njerëzit duhet të eksplorojnë vullnetet e tyre, strukturat e tyre. Unë dhe Sartre ishim shumë me fat, por edhe prejardhja jonë ishte shumë e veçantë, shumë e jashtëzakonshme. Ne takuam njëri-tjetrin kur ishim shumë të rinj. Ai ishte 23 vjeç. Unë isha 20. Ne nuk ishim akoma të pjekur, megjithëse asokohe ishim formësuar si intelektualë me motive të ngjashme. Për të dytë, letërsia e kishte zëvendësuar fenë.

Gerassi: Megjithatë mund të kishit qenë kundërshtarë, rivalë...

Beauvoir: E vërtetë, personalitete të ngjashme me ambicie të ngjashme shpesh ndihen si rivalë. Por kishim edhe diçka tjetër të përbashkët: ishim strukturuar në mënyrë të ngjashme në rininë tonë. Fëmijëritë tona ishin shumë solide, shumë të sigurta. Kjo do të thoshte se asnjëri prej nesh nuk duhej t'i vërtetonte diçka vetes ose tjetrit. Ne ishim të sigurt në veten tonë. Ishte sikur gjithçka ishte e paracaktuar që në fillim. Prindërit e mi vepruan sikur asgjë në univers nuk mund të ndryshonte rrjedhën normale të jetës sime, e cila do të sillte një intelektuale të bukur paksa borgjeze. Gjyshi i Sartre-s, i cili e rriti atë – ju e dini se babai i vdiq kur ai ishte ende foshnjë – sillej në të njëjtën mënyrë, absolutisht i bindur se Sartre do të rritet për t'u bërë profesor. Dhe kështu ndodhi. Kështu që edhe kur ndodhën kriza, të tilla si kur nëna e Sartre-s u martua përsëri kur ai ishte 12-13 vjeç, ose të tilla si kur unë isha 14-15 vjeç dhe mësova se babai im nuk më donte më ashtu siç e prisja unë, stabiliteti i fëmijërisë sonë bëri që ne t'i jashtësojmë këto kriza. Ishin ata që ndryshuan, jo ne. Ne ishim shumë të strukturuar për t'u ndier të pasigurt. Përveç kësaj, pavarësisht dallimeve të vogla, ne ishim në përputhje me modelin që prindërit tanë kishin vendosur për ne. Ata donin që ne të ishim intelektualë, të lexonim, të studionim, të mësonim dhe ne ramë dakord dhe e bëmë këtë. Kështu, kur Sartre dhe unë u takuam, jo vetëm sfondi ynë u shkri, por edhe qëndrueshmëria jonë, bindja jonë individuale se ne ishim ata që ishim modeluar për të qenë.

Në atë kuadër nuk mund të bëheshim rivalë. Pastaj, ndërsa marrëdhëniet midis Sartre-s dhe meje u thelluan, u binda se isha e pazëvendësueshme në jetën e tij dhe ai në jetën time. Me fjalë të tjera, ne ishim plotësisht të sigurt duke ditur se marrëdhënia jonë ishte plotësisht solide, përsëri e paracaktuar, megjithëse asokohe ne do të qeshnim me atë fjalë. Kur keni një siguri të tillë, është e lehtë të mos jesh xheloz. Por nëse do të kisha menduar që një grua tjetër luante të njëjtin rol si unë në jetën e Sartre-s, natyrisht se do të isha xheloze.

Gerassi: Si e mendoni pjesën tjetër të jetës suaj?

Beauvoir: Nuk e mendoj fare. Them se së shpejti do të filloj të shkruaj diçka përsëri, se do të kthehem në punë, por nuk kam ende ide se çfarë do të bëj. Unë e di se do të vazhdoj të punoj me gratë, brenda grupeve feministe, brenda Lidhjes së Grave. Do të vazhdoj të ushtroj aktivizëm në njëfarë mënyre, në çfarëdo mënyre që mundem, brenda – le ta quajmë atë – luftës revolucionare. Dhe e di që do të qëndroj me Sartre-n derisa njëri prej nesh të vdesë. Por, ai tani është 70 vjeç dhe unë 67.

Gerassi: A jeni optimiste? A mendoni se do të ndodhin ndryshimet për të cilat keni luftuar?

Beauvoir: Nuk e di. Jo përgjatë jetës sime gjithsesi. Ndoshta pas katër gjeneratave. Nuk jam e sigurt për revolucionin. Por ndryshimet për të cilat gratë po luftojnë, po, për ato jam i sigurt, në planin afatgjatë gratë do të fitojnë.

Gerassi dhe Beauvoir në Marxist.org

Përktheu: Riola Morina



3

Kam vendosur të mos kërkoj më falje

Kur një burrë është i zemëruar, ne tërhiqemi, ndërsa kur një grua zemërohet, kategorizohet si “kurvë e çmendur”.

Një herë nëna ime më tha “jo kjo nuk është e vërtetë” dhe ajo shpesh më paralajmëronte se “nëse ndonjëherë i shisni stolitë e mia pasi të kem vdekur, do të ringjallet dhe do t’jua kafshoj gishtat e këmbëve”.

Nuk e di se çfarë mendonte ajo, nëse me të vërtetë do t’i hante plotësisht ose do të m’i gërryente gishtërinjtë, por isha e tmerruar nga kërcënimet e saj. Në fund të fundit, nëna ime ishte vetëm një kurvë e çmendur.

Unë nuk e konsideroj se fraza “kurvë e çmendur” do të thotë diçka më shumë përtej arsyes së saj nënçmuese, kjo ekziston thjesht për t’i bërë gratë të kenë frikë nga zemërimi dhe ndjenjat e tyre.

Gjithmonë kur ngre zërin në market, ose them diçka mjaft provokuese ndaj një personi që më ka poshtëruar, ia rikujtoj vetes që të ndalem, të shikoj përreth dhe të fokusohem se kush më ka dëgjuar, çfarë njeriu me pantallona të çuditshme fitoi të drejtën për të thënë se më ka parë në rrugë, në treg, se më ka parë duke i bërtitur fëmijës tim, burrit apo shitësit të dyqaneve dhe të thotë: “Po, më kujtohet ajo grua, ajo është një kurvë e çmendur”.

Çka më intereson më shumë është se pse këtyre personave nuk u intereson shkaku se pse një grua reagoi në atë mënyrë.

Do t'u tregoj se çfarë më ndodhi një natë, menjëherë pasi më kishte vdekur babai, kur isha në taksi duke u kthyer në shtëpi në New Jersey nga New York City. Isha duke shkuar natën vonë tek nëna ime, e cila u diagnostikua me kancer disa javë pasi vdiq babai. Isha mjaft e zemëruar që do të vonohesha për në shtëpi, pasi nëna ime kishte frikë nga udhëtimet në mbrëmje, meqenëse babai im kishte vdekur në një aksident në mbrëmje. Megjithatë, telefoni im ishte fikur pa bateri dhe po i kërkoja taksistit që të nxitonte, ku ai bëri një koment nën zë për nxitimin tim duke thënë se po nxitoja pasi dikush ishte duke më pritur në shtëpi i zemëruar.

Kjo gjë më tërboi, sepse ai nuk e dinte dhimbjen që përjetonim unë me nënën time. Ai nuk e dinte mënyrën se si ne zgjoheshim në mes të natës nga makthet ku në ëndrra dëgjonim zërin e babait tim duke bërtitur dhe vraponim në shtëpi duke e kërkuar për të parë në mos është fshehur në dollap, sepse na mungonte shumë. Trupi në arkivol ishte shaka, ishte një makth i vërtetë, natyrisht ai nuk kishte vdekur, babai im i dashur nuk kishte vdekur!

Dhe tani këtu ishte ky shofer taksie, ky i panjohur, duke bërë komente për mua se isha jashtë dhe u shqetësova për atë që do të më thoshte a do të më bënte dikush, kur nuk kishte asnjë njeri përreth, në fakt, ishte humbja e të vetmit njeri që kisha dashur ndonjëherë që më bënte të ndieja këtë frikë të pabesueshme, dhe kjo frikë shpërtheu në inat dhe unë i bërtita atij: “Çfarë the!?”

Shoferi, siç mund ta parashikoni, u zemërua nga tërbimi im dhe e ktheu makinën në autostradë, bëri një kthesë të paligjshme në një rrugë të rrezikshme dhe filloi të ngiste makinën përsëri për në New York City, larg shtëpisë sime, ku nëna ime e dija se po më priste pranë dritares, duke e ndarë ankthin me thonjtë e saj që nuk i vendoste më.

Natyrisht, isha shumë e zemëruar, jo vetëm ndaj shoferit, por me gjithçka, të gjitha vdekjet dhe sëmundjet që do të duhej t'i duroja kur të gjithë të tjerët që njihja duhej të mendonin vetëm për takimet dhe se cilat ishin vendet më të mira për kokteje.

Fillova të godas sediljet e shoferit në taksi, duke e goditur xhamin që ndan sediljet e pasme me ato të shoferit. Bërtisja tërë kohën: “NDALOJENI MAKINËN, BUDALLA!” Përderisa shqelmoja tërë kohën, fillova të mendoja se ai do të më çonte diku për të më vrarë. Por nuk ndodhi ajo që mendova; gjithçka që ndodhi ishte se i kisha treguar shoferit se unë isha një “kurvë më e çmendur” se ai, bërtisja gjithmonë e më e fort, derisa më në fund ai ndali veturën dhe më la në rrugë, ku më pas më duhej edhe një orë tjetër që të arrija në shtëpi, ku nëna ime po qante dhe pinte cigare në tryezën e kuzhinës.

Ajo që më intereson më shumë është pse kur burrat sillen si të tërbuar, ne largohemi dhe u japim hapësirë. Por kur gratë e bëjnë këtë, ne etiketohemi si të egra, irracionale, të sëmura. Nëse jemi të reja dhe zemërohem, atëherë thonë se ndodh për shkak të drogave. Kur plakemi dhe zemërohem, atëherë thuhet se nuk kemi marrë kurrë atë që kemi dëshiruar.

Çka më intereson më së shumti është se si mund ta ndryshojmë këtë. Ajo që kam mësuar pas një dekade bisede me gratë mbi dëshirat dhe frikërat e tyre është se një nga gjërat më të vështira nga të gjitha është të shtypësh inatin që të vjen nga dekada abuzimi dhe keqtrajtimi, nga dekada e burrave që nuk dinë si të vazhdojnë një marrëdhënie platonike, të cilët thonë gjëra të tilla si: “Oh, askush nuk ma mësoi këtë; askush nuk më tha se një gruaje mund të mos i pëlqente t’i thuhej të buzëqeshte kur po ecte në rrugë.”

Duhet ta ndryshojmë skenarin. Instinktet e burrave kanë qenë krenaria e vendit për kohë të gjatë. Instinktet e grave duhet të jenë gjithashtu.

Duke menduar se si ta ndryshoj skenarin, mund t’ju them se çfarë vendosa të bëj. Vendosa të mos kërkoja falje kur një burrë që bënte ca punë në shtëpi, preu disa tela aksidentalisht dhe unë bërtita “FUCK”. Unë isha në një takim të rëndësishëm në Zoom, kur papritur interneti dhe të gjitha dritat u fikën, dhe askush nuk më kishte paralajmëruar për këtë.

Po ta dija, takimin tim do ta kisha zhvilluar diku tjetër, së bashku me gjashtë takimet e mia të tjera. Sepse jam grua, jam e organizuar dhe jam bricjap. Ndërsa burri im ka një orar shumë të ngjeshur dhe ai vjen kur të mundet, mendoj se ai nuk kishte kohë të më paralajmëronte për këtë shkëputje që ndodhi. Burri im, i turpëruar nga zemërimi im, e mbylli derën dhe tha: “Ishte thjeshtë një aksident, qetësohu”.

Po, gjithashtu aksident ishte edhe kur i njëjti burrë shikonte gjinjtë e mi në vend që të më shikonte në sy, kur erdhi para një jave dhe i ra ziles, anipse në derë thoshte që: “Jam në intervistë, ju lutem mos trokisni nëse nuk është shumë e rëndësishme”.

Por ai i binte ziles gjithsesi, pastaj kaluan 45 sekonda duke folur për kërpudhat që ai gjen ndërsa shikimin e mbante në gjoksin tim, duke më pyetur nëse kisha nevojë për këshilla peshkimi, sepse ai kishte parë mjetet e peshkimit në garazh një ditë më parë, dhe unë thashë: “Jam në mes të një interviste, më falni”, sepse jam mësuar të jem e mirë, mbi të gjitha, në fshehjen e tërbimit tim, dhe jam mësuar të kërkoj falje sa herë që jam tërbuar. Kështu që unë kërkoja falje: “Më fal”, thashë, nuk mund t’i dëgjoj më këshillat tuaja budallaqe të padëshiruara për peshkim, sepse edhe unë kam punë, dhe puna ime është të mos dëgjoj zërin tënd që flet për kërpudha në mëngjes, siç nuk është puna jote që ta ndërpresësh internetin nga pakujdesia jote, por edhe nëse e bën, atëherë puna jote si një qenie njerëzore është të kërkoshe falje dhe jo të qëndrosh aty duke e goditur tokën dhe duke mallkuar se si kabloja është kaq e cekët dhe se është faji i dikujt tjetër e jo i yti, sepse sigurisht, ju jeni “burrë”; ky nuk është faji juaj por i dikujt tjetër.

Në mënyrë të ngjashme ishte “thjesht një aksident” kur një burrë në një furgon doli në korsinë e babait tim në një pasdite të bukur shtatori, duke bërë që makina e babait tim të rrëshqiste disa herë në ajër dhe babai im të lundronte nga dritarja anësore e shoferit dhe të përfundonte gjysmë i vdekur. Sidoqoftë, për të nuk ishte aksident, ku i njëjti burrë paditi pasurinë e babait tim për dëmet në automjetin e tij, një proces gjyqësor që na u dha në ditën kur e varrosëm babanë

tim në tokë pas plagëve të marra nga ky aksident.

Kështu që, kur bërtas “FUCK”, pasi më ishte ndërprerë interneti, unë nuk jam thjesht një kurvë e çmendur dhe e tërbuar që nuk dëshiron të shqetësohet. Përkundrazi unë jam më shumë se aq dhe po marr kohë t’i them gjërat brenda meje me zë të lartë, sepse mbase herën tjetër që punëtori dëgjon një grua të bërtasë “FUCK”, ai do të jetë më shumë i familjarizuar me të, mbase më i gatshëm të kërkojë falje, ndoshta më pak i prirë për ta shikuar token dhe ta ndalë gojën dhe fjalët që ai dëshiron t’i thotë me zë të lartë.

Nuk mendoj se ndonjë burrë i veçantë do ta lexojë këtë traktat mbi zemërimin, por nëse e lexon, mbase do ta kuptojë se, përveç çështjeve të mia me internet, vdekjes së babait tim dhe kancerit të nënës sime, unë gjithashtu jam e lodhur nga të gjithë burrat që më është dashur të shtirem se ndihem mirë, të gjithë burrat në lokale që nuk më tërhiqnin në mëngjes, jam duke menduar veçanërisht për një burrë që më kishte shkukur thithkat e mia, absolutisht pa leje, dhe më pas ishte zemëruar pse unë reagoja shumë e zemëruar me të!

Në librin tim, është një burrë me emrin Vic që përpiqet ta bëjë Joan-ën, protagonisten, të ndihet keq që nuk e do atë. Pas vdekjes së babait tim, unë kisha disa Vic të ndryshëm që nuhatnin përreth, duke nuhatur humbjen e babait tek unë, dhe ende jam shumë e zemëruar për këtë.

Mund të them se nuk jam e zemëruar vetëm me burrat, natyrisht. Unë jam gjithashtu e zemëruar me veten time. Jam e zemëruar me historinë time të faljes; jam e zemëruar në çdo kohë që u kërkoja falje të huajve virtualë që ishin të zemëruar. Unë jam e zemëruar nga të gjitha kohët kur një burrë është përpjekur të më shtrëngojë në krahët e tij, për të më bërë të ndihem më mirë dhe unë duke mos dashur ta ofendoj, kam krijuar justifikime, kinse diçka nuk ishte në rregull me mua që nuk doja të më përqafonin. Më vjen keq, e di që çdo grua tjetër në botë do të dëshironte krahët e tu rreth

saj tani, por ka diçka që nuk shkon specifikisht me mua. Jam e ftohtë, jam e dehur, jam e dëmtuar. Dhe më vjen keq, e di që tani nuk po dukem aq e nxehtë, sa të të refuzoj drejtpërdrejt.

Unë gjithashtu jam e zemëruar me nënën time, e cila në kohën e saj kishte mjaft probleme për t'i përballuar; ajo do të duhej të dinte edhe problemet me të cilat do të përballesha unë, ta dinte që të mos më kërcënonte me vdekjen e saj.

Në Indiana, kur isha duke hulumtuar për librin tim të parë dhe isha pa asnjë kacidhe, shita shumë stoli të saj të çmuara. Isha mjaft e frikësuar ta thosha me zë të lartë, që të mos më dëgjonte ajo. Megjithatë, unë kam vendosur të ndaloj ta kërkoj faljen nga të gjithë dhe kjo përfshin edhe prindërit e mi të vdekur.

Tani e mirëpres nënën time të më vijë natën të më kafshojë këmbët, sepse më ka marrë malli për të dhe do të doja t'i thosha: “Përsëritetje Mama, mirë që të pashë, më fal që të shita stolitë. Por unë duhej ta bëja atë, edhe pse e dija sa kisha frikë nga ti. Siç rezulton, edhe unë jam me të vërtetë një kurvë e çmendur.”

Lisa Taddeo në The Guardian

Përktheu: Medinë Dauti



4

Judith Butler: Kur vrasja e grave nuk është krim

Lufta globale për të ndaluar dhunën ndaj grave dhe lufta për barazi shoqërore janë të lidhura.

I kam shkruar filozofes Judith Butler vitin e kaluar, jo shumë kohë pasi kisha shkruar një artikull me titull “Unë jam seksist”, pasi lëvizja #MeToo kishte marrë hov të shpejtë. Shpresoja të merrja një kritikë të sinqertë mbi esenë. Fitova shumë më tepër: Një shkëmbim të fortë dhe të thellë që çoi në këtë intervistë dhe kujtesën që dhuna ndaj grave, në shumë forma, është një tragjedi globale.

Judith Butler është e njohur me dekada për punën e saj në filozofi, feminizëm dhe aktivizëm në të gjithë botën. Një profesore në departamentin e letërsisë krahasuese dhe programit të teorisë kritike në Universitetin e Kalifornisë “Berkeley”, ajo është autore e librave të shumtë me ndikim, duke përfshirë “Notes Toward a Performative Theory of Assembly” dhe librit të ardhshëm, “The Force of Non-Violence.” Kjo intervistë u zhvillua përmes email-it.

George Yancy: E di që ju e njihni lëvizjen ndërkombëtare Ni Una Menos, lëvizje e cila përfshin disa vende të Amerikës Latine dhe po lufton shumë forma të dhunës, në veçanti femicidin, vrasjen e grave dhe vajzave për shkak të gjinisë së tyre. (Një shembull: Në Argjentinë, thuhet se çdo 30 orë vritet një grua.) Në Shtetet e Bashkuara kemi lëvizjen #MeToo. Çfarë mendoni për këto mobilizime të ndryshme, por të ngjashme?

Judith Butler: Është e rëndësishme të përmendim se ka shumë feminizma tani (siç ka pasur gjithmonë) dhe ato ndryshojnë në bazë të fokusit dhe kornizës së tyre. Ni Una Menos është një lëvizje që ka nxjerrë miliona gra në rrugë nëpër Amerikën Latine për të luftuar dhunën ndaj grave, personave trans dhe indigjenëve. Slogani “As edhe një më pak” do të thotë se asnjë grua më shumë nuk duhet të vdesë si pasojë e dhunës.

Kjo është një thirrje kolektive: “Asnjë grua nuk do të vdesë më, ky kolektiv në zgjerim i reziston dhunës së drejtuar kundër tyre.” Por gjithashtu: “Si gra, ne nuk do të humbasim një jetë tjetër”. Lëvizja nuk bazohet në një ide të ngushtë të identitetit, por është një koalicion i fortë dhe intensifikues që tërheq mbështetje nga gratë dhe personat trans që janë punëtorë, që u përkasin sindikatave dhe kishave, të cilët mund të kenë ose jo ndonjë lidhje me universitetet.

Kundërshtimi i ashpër kolektiv ndaj vrasjes së grave është thelbësor, gjithashtu dhuna kundër personave trans, veçanërisht grave trans dhe “las travestis” (të cilët jo gjithmonë identifikohen si trans). Kjo është arsyeja pse nganjëherë referohet si lëvizje kundër “femicidio” – të gjithë atyre që konsiderohen “feminin”. Kjo është e rëndësishme, sepse nuk është vetëm se vrasja kryhet në bazë të gjinisë; dhuna ndaj grave është një mënyrë për të përcaktuar feminitetin e viktimës. Dhuna kërkon të sigurojë që gratë janë të vrasshme, të zëvendësueshme; është një përpjekje për të përcaktuar vetë ekzistencën e jetës së grave si diçka të vendosur nga burrat, si një prerogativë mashkullore.

Lëvizja është një lloj lufte për liri dhe barazi dhe si e tillë lufton për të drejtën e abortit, të drejtën për pagë të barabartë dhe luftën kundër ekonomisë neoliberale që po intensifikon pasigurinë, veçanërisht për gratë, indigjenët dhe të varfrit. E drejta për abort bazohet në të drejtën e secilës grua për të pohuar lirinë mbi trupin e saj, por rrjedh nga kërkesat kolektive të grave për të qenë në gjendje të realizojnë dëshirat e tyre lirisht pa ndërhyrjen e shtetit dhe pa frikën e dhunës, ndëshkimit dhe burgimit.

Lëvizja e ka ndarë veten nga mënyrat individualiste të feminizmit që bazohen në lirinë personale dhe të drejtat e subjektit individual. Kjo nuk do të thotë se tregimet dhe historitë individuale nuk kanë rëndësi. Ato kanë rëndësi, por format e feminizmit që nuk përfshijnë një kritikë të kapitalizmit priren të riprodhojnë individualizmin si një çështje e natyrshme. Kolektivët formohen përmes realizimit të një gjendjeje të përbashkët shoqërore dhe një lidhje shoqërore, e cila pranon se ajo që po ndodh me një jetë, qoftë dhuna, borxhi apo nënshtrimi ndaj autoritetit patriarkal, po ndodh gjithashtu për jetë të tjera. Dhe megjithëse këto mund të ndodhin në mënyra të ndryshme, modelet janë të dukshme dhe po ashtu janë edhe bazat e solidaritetit.

Në Shtetet e Bashkuara, “#MeToo” ka qenë shumë e fuqishme në ekspozimin e karakterit të përhapur të ngacmimeve dhe sulmeve seksuale në çdo lloj vendi të punës. Nuk ka asnjë mënyrë për të mbyllur sytë për sa kohë gratë kanë vuajtur nga ngacmimet, hakmarrjet dhe humbja e karrierës së tyre – humbja e besimit tek ata nga të cilët ato shpesh varen për punë. Por “unë” në #metoo nuk është e njëjtë me kolektivin në “ne”, dhe një kolektiv nuk është vetëm një sekuencë e tregimeve të individëve. Baza për solidaritet, për veprim kolektiv, kërkon që të largohemi nga supozimi i individualizmit; në Shtetet e Bashkuara tendenca është të riafirmojmë atë parim të liberalizmit politik në kurriz të lidhjeve të forta dhe të qëndrueshme kolektive. Në Argjentinë, Ni Una Menos në disa mënyra po merr detyrimin etik dhe politik të “Nunca Mas!” ose “Kurrë më!” si imitim nga pasojat e diktaturës. Shkatërrimi dhe zhdukja e jetës së mijëra studentëve dhe aktivistëve të së majtës ka çuar në një kundërshtim të ashpër ndaj censurës, shtypjes dhe dhunës së shtetit. Vrasja e grave është po aq e tmerrshme, shumë shpesh e ndihmuar dhe e nxitur nga policia dhe gjykatat që nuk arrijnë ta pranojnë krimin dhe nga një qeveri që refuzon të pohojë të drejtat e barabarta të grave për të jetuar jetën e tyre në liri dhe pa frikën e vdekjes.

Yancy: Arsyet për këto dy lëvizje janë të lidhura me strukturat politike dhe ekonomike që marginalizojnë dhe shtypin gratë. Strukturat politike dhe ekonomike janë të lidhura në mënyrë të pazgjidhshme me makizmin, sensin toksik të identitetit mashkullor që përkthehet në të drejtën e burrave mbi trupat e grave; realisht në atë se nëse gratë mund të jetojnë apo vdesin. Ju lutem flisni për dimensionet performative të makizmit.

Butler: Nuk jam më e sigurt se çfarë llogaritet si performative, por pikëpamja ime është se një arsye pse burrat ndihen të lirë të vendosin për jetën e grave ashtu siç e gjykojnë vetë të arsyeshme është sepse ata janë të lidhur me njëri-tjetrin përmes një pakti të vëllazërisë së heshtur (në fakt jo aq të heshtur). Ata kthejnë shikimin nga ana tjetër; i japin njëri-tjetrit leje dhe i lejojnë njëri-tjetrit pandëshkueshmëri. Në shumë vende, dhuna e ushtruar ndaj grave, përfshirë vrasjet, nuk është konceptuar as si krim. Këto krime janë “mënyra se si bota funksionon” ose “akte të pasionit” dhe këto fraza zbulojnë qëndrime të thella që kanë natyralizuar dhunën ndaj grave, domethënë e kanë bërë të duket sikur kjo dhunë është një pjesë e natyrshme ose normale e jetës së zakonshme. Kur burrat feministë thyejnë atë pakt solidariteti, ata rrezikojnë përjashtimin nga disa komunitete dhe prapëseprapë ai lloj përjashtimi është pikërisht ajo që nevojitet.

Në Barcelonë një burrë qëllimshëm më tha se nuk kishte të drejtë të bashkohej në një demonstratë feministe kundër dhunës. Por nuk isha dakord me të. Epo, mbase jam dakord me të: pjesëmarrja nuk është e drejtë; është një detyrim. Por burrat që i bashkohen asaj lufte të rëndësishme kundër dhunës ndaj grave dhe personave trans duhet të ndjekin udhëheqjen e grave. Nëse qëndrojnë së bashku kundër paktit vdekjeprurës të vëllazërisë që lejon, devijon dhe shfajëson, ata e bëjnë atë para së gjithash duke u përballur me burra të tjerë dhe duke formuar grupe që refuzojnë dhunën dhe pohojnë barazinë radikale. Mbi të gjitha, kur merret jeta e grave dhe të gjitha pakicave të tjera, kjo është një shenjë që ato jetë nuk trajtohen si të vlefshme. Lufta kundër dhunës dhe lufta për barazi janë të lidhura.

Yancy: Si flet libri juaj i ri mbi jodhunën për pyetjet në lidhje me cenueshmërinë e grave?

Butler: Libri i ri, “The Force of Non-Violence”, ka të bëjë me gratë, sigurisht, por edhe me të gjithë njerëzit që konsiderohen të jenë pak a shumë të pavajtueshëm. Unë punoj me idenë feministe të “lidhshmërisë” në mënyrë që të tregoj jo vetëm se si jetët janë të ndërvarura, por edhe se si detyrimet tona etike për të mbështetur jetën e njëri-tjetrit vijnë nga ajo ndërvarësi. Ndalimi i dhunës është një mënyrë për të pohuar dhe nderuar atë lidhje bazuar në vlerën e barabartë të jetës, por ky nuk është një parim abstrakt ose formal. Ne i kërkojmë njëri-tjetrit të jetojmë dhe kjo është po aq e vërtetë për lidhjet familjare ose fafëfisnore sa edhe për lidhjet ndërkombëtare dhe globale. Kritika e individualizmit ka qenë një komponent i rëndësishëm si i mendimit feminist, ashtu edhe i atij marksist, dhe tani ajo bëhet urgjente ndërkohë që kërkojmë të kuptojmë veten si krijesa të gjalla të lidhura me krijesa njerëzore dhe jonjerëzore, me sisteme dhe rrjete të tëra të jetës. Kërcënimet e ndryshme të shkatërrimit mund të marrin formën e dhunës shtetërore, femicidit, braktisjes së migrantëve dhe ngrohjes globale. Ne duhet të rimendojmë lidhjet e jetës për të ditur se pse jemi të detyruar të kundërshtojmë dhunën edhe kur, ose saktësisht kur armiqësitë përshkallëzohen.

Yancy: Në çfarë mënyrash adreson diskutimi juaj mbi jodhunën praktikën tonë të përhapur kulturore të dhunës, specifikisht asaj mashkullore?

Butler: Kjo është pyetje e mirë. Për mua, dhuna nuk është mashkullore apo burrërore. Unë nuk mendoj se ajo vjen nga skutat e burrave ose është e ndërtuar në një përkufizim të domosdoshëm të maskulinitetit. Mund të flasim për struktura të dominimit mashkullor, ose patriarkalizëm, dhe në ato raste janë strukturat shoqërore dhe historitë e tyre që kërkojnë të shpërbëhen. Është e vështirë të dish të kuptosh akte individuale të dhunës

brenda strukturave shoqërore që inkurajojnë, lejojnë dhe shfajësojnë akte të tilla. Mund të ndodhë që ne të jemi krijesa shoqërore, jeta e të cilave zhvillohet në struktura shoqërore të cilat kemi njëfarë fuqie për t'i ndryshuar. Kështu që nuk mendoj se burrat si individë mund të përdorin “strukturat shoqërore” si një justifikim, domethënë “struktura shoqërore e dominimit mashkullor më bëri të kryej këtë akt dhune”.

Në të njëjtën kohë, është e gjithë përgjegjësia jonë të pyesim veten se si po jetojmë, duke riprodhuar apo rezistuar këto struktura. Pra, megjithëse ndryshimi mund të ndodhë në një nivel individual, modelet e drejtësisë rikuperuese na tregojnë se individët ndryshojnë në kontekstin e bashkësive dhe marrëdhënieve dhe kjo është mënyra se si ndërtohen strukturat e reja të ndërveprimit dhe shkatërrohen ato të vjetrat. Nga ana tjetër, kjo do të thotë se etika duhet të jetë më shumë sesa një projekt individual i vetëpërmirësimit, pasi jeta përmirësohet në bashkëpunim me të tjerët. Këto marrëdhënie janë ato që na mbajnë dhe si të tilla meritojnë vëmendjen dhe përkushtimin tonë kolektiv.

Judith Butler dhe George Yancy në NY Times

Përktheu: Riola Morina



5

Neuroseksizmi: Miti se truri i burrave dhe i grave janë të ndryshëm

Lise Eliot shkruan se studimet që kanë pasur qëllim të analizojnë dallime mes trurit të grave dhe të burrave janë dëshmi për praktika të gabuara kërkimore. Disa studime të reja nga neuroshkenca po hedhin poshtë mitin e “trurit femëror”.

Në librin e saj “The Gendered Brain”, neuroshkencëtarja kognitive Gina Rippon përshkruan një studim që pretendon se “më në fund” ka përshkruar dallimet mes trurit të burrave dhe grave.

Ishte një analizë e rezonancës magnetike (MRI) e 21 burrave dhe 27 grave nga studiuesit në Universitetin e Kalifornisë, Irvine (R. J. Haier et al. NeuroImage 25, 320–327; 2005). Studim i parëndësishëm në ditët e sotme, megjithatë pati mjaft publicitet nga gazetatat, blogjet deri në televizione, libra dhe përfundimisht te mësuesit dhe konferencat e korporatave për lidërsip. U zgjova një mëngjes të vitit 2010 për të parë se sa keq e ekzagjeronin këtë studim në Early Show, një program i rrjetit televiziv amerikan. Prezantuesi, Harry Smith, nuk u përmbajt kur korrespondentja mjekësore Jennifer Ashton deklaroi se burrat kanë “gjashtë herë e gjysmë më shumë materie gri” sesa gratë, ndërsa gratë kanë “dhjetë herë më shumë materie të bardhë” sesa burrat. Më pas filluan diskutime thumbuese për talentin e burrave në matematikë dhe aftësinë e grave për të kryer shumë detyra në kohë të njëjtë.

Nuk u diskutua se nëse këto dallime do të qëndronin në të vërtetë, gratë do të duheshin të kishin kokën 50% më të madhe. Nuk u diskutua as që ekipi i Irvine-it nuk krahasonte madhësinë e kokave, por hetonte korrelacionin mes IQ-së dhe materies gri ose të bardhë.

Neuroseksizmi

Hulumtimet e panumërta lidhur me dallimet gjinore të trurit janë plot me keqinterpretime, paragjykime në botime, statistika të dobëta dhe kontrollë joadekuate. Në librin e saj ambicioz, Rippon-i ngreh zërin kundër neuroshkencës që analizon gabimisht dallimet në bazë të seksit dhe ofron shumë shembuj. Njëri nga studimet e përmendura nga Rippon-i pretendon se “Më në fund, e kemi zbuluar të vërtetën”. Studiues të tjerë menjëherë kanë ekspozuar ekzagjerimet fatale të këtij studimi dhe zhdukën këtë pretendim. Mirëpo nuk kalon shumë kohë derisa të dalë studimi tjetër me pretendime të ekzagjeruara dhe vazhdon të citohet derisa të dalë analiza tjetër që e hedh poshtë. Ky cikël përsëritet vazhdimisht. Disa studiues të tjerë ekspozojnë ekzagjerimet fatale dhe më në fund pretendimi i kundërt zhduket, deri në analizën tjetër që hedh poshtë këtë pretendim dhe më pas fillon cikli nga fillimi. Siç tregon Rippon-i, këto hulumtime për të gjetur dallimet në tru në bazë të seksit “janë shtyrë me forcë për tërë këto vite me të gjitha teknikat që shkenca mund të ofronte”, dhe ka shpërthyer në tri dekadat e fundit, qëkur studimet e MRI-së i ishin bashkuar këtij diskutimi. Megjithatë, libri i Rippon-it zbulon se këto studime nuk kanë arritur të ofrojnë rezultate konkrete. Përtej “mungesës së pesë gramëve” në trurin e grave, zbulim që bëri bujë që nga shekulli i 19-të, shkencëtarët bashkëkohorë nuk kanë identifikuar ndonjë dallim vendimtar e përcaktues që kategorizon dallimet e trurit në baza gjinore. Një studim i vogël i bërë në vitin 1995 nga Nature, proklamoi se në trurin e grave, procesimi i gjuhës

në hemisferë nuk është i përhapur në mënyrë të barabartë si te burrat (B. A. Shaywitz et al. *Nature* 373, 607–609; 1995). Ndërsa një meta-analizë më e madhe e bërë në vitin 2008, demantoi këtë teori (I. E. Sommer et al. *Brain Res.* 1206, 76–88; 2008). Madhësia e trurit rritet proporcionalisht me madhësinë e trupit, sikurse materia gri dhe e bardhë rritet proporcionalisht me zonat me prerje të tërthortë. Por këto janë dallime të vogla dhe jo madhore. Rippon-i thekson se këto dallime zhduken kur krahasojmë gratë me madhësi të kokës më të madhe me burrat me kokë më të vogël. Njëkohësisht nuk kanë ndonjë korrelacion direkt me aktivitetet e kohës së lirë apo pagën e burrave dhe grave.

Historia e paragjytimeve

Mesazhi kryesor i Rippon-it është se “një botë e ndarë në baza gjinore, prodhon një tru të tillë”. Libri i saj, së bashku me librin “Inferior” të Angela Saini-it, dhe “Delusions of Gender” të Cordelia Fine-it kanë për qëllim rrënjosjen e “neuroseksizmit” që është prezent në shumicën e përpjekjeve për të kuptuar dallimet në tru.

Historia e studimeve të kaluara është mjaft interesante për t’u lexuar, nëse do të ishte gjithçka e vërtetë. Historia që Rippon-i ofron në librin e saj fillon me një citim të vitit 1985 nga psikologu social Gustave Le Bon, i cili përdori cefalometrin e tij portativ (një instrument për matjen e kokës) për të deklaruar se gratë “përfaqësojnë format më inferiore të evolucionit njerëzor”. Libri përfundon në vitin 2017, me inxhinierin e Google-it, James Damore, i cili thotë se ka “arsye biologjike” që shpjegojnë mungesën e grave në fushën e teknologjisë dhe në pozita vendimmarrëse.

Siç tregon Rippon-i, kërkimet për të vërtetuar inferioritetin e grave, kohëve të fundit janë lënë anash në kërkim të provave për të vërtetuar “ndërvarësinë” burrë-grua. Pra, këto hulumtime të reja pretendojnë të tregojnë se gratë nuk janë më pak inteligjente se burrat, thjesht janë “ndryshe”, në një formë që përkojnë me mësimet biblike dhe status quo-të e roleve gjinore. Këto studime pretendojnë se truri i grave është

më i ndjeshëm dhe intuitiv, ndërsa truri i burrave supozohet të jetë racional dhe i arsyeshëm.

Për shembull, në vitin 2014 studiuesit në Universitetin e Pensilvanisë në Filadelfia kryen një hulumtim duke përdorur MRI. Studimi ushqeui imagjinatën e publikut me pamje të trurit të burrave dhe grave, të cilët paraqiteshin si harta metroje diametralisht të kundërta: lidhjet në trurin e grave janë kryesisht midis hemisferave dhe në trurin e burrave brenda tyre (M. Ingallhalikar et al. Proc. Natl Acad. Sci. USA 111, 823–828; 2014). Sidoqoftë, studimi i la anash dhe nuk i paraqiti ngjashmëritë e mëdha mes truve, si dhe nuk ka marrë parasysh moshën e pjesëmarrësve dhe as madhësinë e trurit në shumicën e respondentëve.

Shtigjet kulturore

Pra, nëse jo përmes trurit, atëherë si i shpjegojmë ndryshimet e mëdha në sjellje dhe interesa mes burrave dhe grave? Lidhur me këtë temë, Rippon-i flet për ndikimin e një bote të ndarë në baza gjinore në trurin e njeriut. Ajo e ndërton qëndrimin e saj në katër pjesë: nga historia e neveritshme e hulumtimeve në dallimet në bazë të seksit përmes metodave moderne të imazhit të trurit, shfaqja e neuroshkencës sociale-kognitive dhe provat e dobëta për dallimet në bazë të seksit në trurin e foshnjave të sapolindura. Rippon-i tregon se si “sfungjerët cerebralë” të fëmijëve dallojnë vetëm për shkak të kulturave të rënda, ku ndajnë ngjyrat rozë kundrejt asaj të kaltër, të cilat mvishen që nga momenti kur zbulohet seksi i foshnjave, madje edhe para lindjes.

Pjesa e katërt na sjell në shekullin e njëzet e njëte, megjithëse jo që ka një fund të lumtur. Përqendrohet te gratë në shkencë dhe teknologji dhe në mënyrën se si bota e ndarë në bazë gjinore, përfshirë edhe profesionalizimin e shkencës dhe stereotipin mashkullor të “shkëlqyeshmërisë”, ka penguar hyrjen dhe përparimin e grave në këtë fushë. Gratë e talentuara vlerësohen si “fuqi punëtore”, ndërsa burrat

si “gjeni”, një dallim që fëmijët e përbrendësojnë para moshës gjashtë vjeç, sipas hulumtimit nga Lin Bian, Sarah-Jane Leslie dhe Andrei Cimpian (L. Bian et al. *Am. Psychol.* 73, 1139–1153; 2018). Të gjithë këta faktorë hyjnë në ciklin e zhvillimit të trurit, nga pritshmëritë e ndryshme, vetëbesimit dhe ndërmarrjes së rrezikut që i shtyn djemtë dhe vajzat në trajektore të ndryshme të karrierës dhe suksesit.

Ndryshimi i mendjeve

Pjesa e fundit e këtij artikulli shpjegon nëntitullin e librit të Rippon-it “Neuroshkenca e re që shkatërron mitin mbi trurin femëror”. Një vëllim që demanton dallimet e trurit mes grave dhe burrave, pse të fokusohet vetëm në gra? Në fillim mendova se ishte goditje ndaj “The Female Brain” 2006 të Louann Brizendine-it, i zhytur në këto faqe (R. M. Young dhe E. Balaban *Nature* 443, 634; 2006). Ose mbase është për të vënë në përdorim termin “truri femëror” si një variant i çuditshëm i së vërtetës, sikurse përdorim termat një “fizikane grua” ose “kirurge grua”.

Cilido qoftë nëntitulli, libri përmbush qëllimin e tij për ta hedhur poshtë konceptin e ndarjes së trurit në bazë të identitetit gjinor. Truri, ashtu si organet e tjera si mëlçia, veshkat ose zemra, nuk ka ndonjë dallim gjinor. Në fund të librit të saj, Rippon-i flirton me implikimet e këtij zbulimi për numrin në rritje të njerëzve që kalojnë ose jetojnë mes kategorive aktuale të gjinisë, përtej binarës grua-burrë. Por tani për tani, përfundon ajo, shumica prej nesh mbetemi të mbërthyer në “paracaktimet shoqërore” që paraqesin trurin si diçka që është femërore apo mashkullore.

LISE ELIOT në *Nature*

Përktheu: Medinë Dauti



6

Kriza e përkujdesjes në kapitalizëm

Në këtë intervistë, Nancy Fraser debaton kryqëzimin shqetësues të feminizmit liberal me kapitalizmin bashkëkohor dhe ofron një vizion rrënjësisht të ndryshëm të drejtësisë gjinore.

Nancy Fraser është profesore e filozofisë dhe e politikës në The New School for Social Research dhe një nga teoricienet kritike më të respektuara sot. Në librin e saj të fundit “Fortunes of Feminism: From State-Managed Capitalism to Neoliberal Crisis”, Fraser-i debaton kryqëzimin shqetësues të feminizmit liberal me kapitalizmin dhe mënyrat në të cilat feminizmi liberal mund të sigurojë një iluzion të çlirimit për një sistem të shfrytëzimit të pamëshirshëm. Duke përpunuar një kritikë të kapitalizmit dhe një vizion rrënjësisht të ndryshëm të feminizmit, ajo tregon se si drejtësia gjinore duhet të qëndrojë në zemër të çdo lufte për një shoqëri të barabartë. Kohët e fundit, Fraser-i është kthyer për të adresuar atë që ajo e quan një “krizë të përkujdesit”.

Sarah Leonard: Çfarë është riprodhimi shoqëror dhe pse qëndron në thelbin e analizës suaj feministe?

Nancy Fraser: Riprodhimi shoqëror ka të bëjë me krijimin dhe mirëmbajtjen e lidhjeve shoqërore. Një pjesë e kësaj ka të bëjë me lidhjet midis brezave – pra, lindja dhe rritja e fëmijëve dhe përkujdesi për të moshuarit. Një pjesë tjetër ka të bëjë me mbajtjen e lidhjeve horizontale midis miqve, familjes, lagjeve dhe komunitetit. Ky lloj aktiviteti është absolutisht thelbësor për shoqërinë. Duke qenë njëkohësisht emocional dhe material, ky siguron “ngjitësin social” që mbështet bashkëpunimin shoqëror.

Pa të, nuk do të kishte organizim shoqëror – as ekonomi, as politikë, as kulturë. Historikisht, riprodhimi shoqëror është bërë çështje gjinore. Pjesa më e madhe e përgjegjësisë për të u është caktuar grave, edhe pse gjithashtu burrat gjithmonë kanë kryer disa prej këtyre përgjegjësisë.

Ngritja e kapitalizmit e shtoi këtë ndarje gjinore – duke ndarë prodhimin ekonomik nga riprodhimi shoqëror, duke i trajtuar ato si dy gjëra të ndara, të vendosura në dy institucione të ndryshme dhe të koordinuara në dy mënyra të ndryshme. Prodhimi u zhvendos në fabrika dhe zyra aty ku konsiderohej “ekonomik” dhe shpërblehej me paga e para të gatshme. Riprodhimi u la pas, u zhvendos në një sferë të re private shtëpiake, ku u sentimentalizua dhe u natyralizua, u krye për hir të “dashurisë” dhe “virtytit”, e jo parave. Në fakt, riprodhimi shoqëror asnjëherë nuk ishte vendosur vetëm brenda kufijve të familjes private, por ka qenë i vendosur gjithashtu në lagje, institucione publike dhe shoqëri civile; dhe një pjesë e tij është materializuar. Sidoqoftë, ndarja gjinore e riprodhimit shoqëror nga prodhimi ekonomik përbën bazën kryesore institucionale për nënshtrimin e grave në shoqëritë kapitaliste. Pra, për feminizmin, nuk mund të ketë çështje më qendrore se kjo.

Leonard: Sipas gjykimit tuaj, ne kemi hyrë në një krizë të përkujdesjes. Çfarë do të thotë kjo dhe si kemi arritur këtu?

Fraser: Në shoqëritë kapitaliste, kapaciteteve të disponueshme për riprodhim shoqëror nuk u jepet asnjë vlerë e monetarizuar. Ato merren si të mirëqena, trajtohen si “dhurata” falas dhe pafundësisht të disponueshme, të cilat nuk kërkojnë vëmendje ose rimbushje. Supozohet se gjithmonë do të ketë energji të mjaftueshme për të mbështetur lidhjet shoqërore nga të cilat varet prodhimi ekonomik dhe shoqëria në përgjithësi. Kjo është shumë e ngjashme me mënyrën se si natyra trajtohet në shoqëritë kapitaliste, si një rezervuar i pafund, nga i cili mund të marrim sa të duam dhe në të cilin mund të hedhim çdo sasi mbeturinash.

Në fakt, as natyra dhe as kapacitetet shoqërore riprodhuese nuk janë të pafundme; të dyja këto mund të shtrihen deri në pikën e thyerjes. Kur një shoqëri tërheq njëkohësisht mbështetjen e publikut për riprodhimin shoqëror dhe rekruton ofruesit kryesorë të saj në orë të gjata dhe rraskapitëse të punës me pagë, ajo shteron vetë kapacitetet shoqërore nga të cilat varet. Kjo është pikërisht situata jonë sot. Si një tigër që ha bishtin e vet, forma aktuale e financuar e kapitalizmit po konsumon sistematikisht kapacitetet tona për të mbështetur lidhjet shoqërore. Rezultati është një “krizë e përkujdesit” që është gjithnjë aq serioze dhe sistematike sa kriza aktuale ekologjike me të cilën është e ndërthurur në çdo rast.

Për të kuptuar se si kemi arritur këtu, unë do ta krahasoja këtë formë të kapitalizmit me format e mëparshme. Është ide e përhapur që historia e kapitalizmit përbëhet nga një varg regjimesh të ndryshme akumulimi – për shembull, kapitalizëm liberal, kapitalizëm i administruar nga shteti (ose social-demokratik) dhe kapitalizëm neoliberal i financuar. Studiuesit zakonisht bëjnë dallimin mes këtyre regjimeve për sa u përket mënyrave dalluese në të cilat shtetet dhe tregjet lidhen në secilin prej tyre. Por ata kanë lënë pas dore lidhjen midis prodhimit dhe riprodhimit, e cila është po aq e rëndësishme. Kjo marrëdhënie është një tipar përcaktues i shoqërisë kapitaliste dhe bën pjesë në qendër të analizës sonë për të. Ne mund të bëjmë një rrugë të gjatë drejt kuptimit të historisë së kapitalizmit duke u përqendruar në mënyrën se si riprodhimi shoqëror është i organizuar në secilën nga fazat e tij: për çdo epokë të caktuar, sa nga “puna e përkujdesjes” materializohet? Sa mbështetet përmes provizioneve shtetërore ose të korporatave? Sa ndodhet në familje? Në lagje? Në shoqërinë civile?

Mbi këtë bazë, ne mund të gjurmojmë një rrugë historike nga i ashtuquajtimi kapitalizëm liberal i shekullit të nëntëmbëdhjetë deri te regjimi i menaxhuar nga shteti i mesit të njëzetës dhe në kapitalizmin e

financuar të ditëve të sotme. Me pak fjalë: kapitalizmi liberal privatizoi riprodhimin shoqëror; kapitalizmi i menaxhuar nga shteti e socializoi pjesërisht; kapitalizmi i financiar gjithnjë e më shumë po e materializon atë. Në secilin rast, një organizatë specifike e riprodhimit shoqëror shkoi me një grup të veçantë të idealeve gjinore dhe familjare: nga vizioni liberal-kapitalist i “sferave të ndara” te modeli social-demokratik i “pagës familjare” te norma neoliberales e financiare e “familjes me dy fitime”. Më lejo të shpjegojmë më tutje.

Rasti i kapitalizmit liberal është mjaft i qartë. Shtetet u mënjanuan ndërsa industrialistët tërhoqën njerëzit e sapoproletarizuar, përfshirë gratë dhe fëmijët, në fabrika dhe miniera. Rezultati ishte një krizë e riprodhimit shoqëror, e cila nxiti një protestë publike dhe fushatën për “legjislacionin mbrojtës”. Por politika të tilla nuk mund ta zgjidhnin problemin dhe efekti i tyre ishte lënia e komuniteteve së klasës punëtore dhe fshatare në përkujdesin e vetvetes. Sidoqoftë, kjo formë e kapitalizmit ishte prodhuese nga ana kulturore. Me paraqitjen e riprodhimit shoqëror si rol të grave brenda familjes private, u shpik imagjinata e re dhe borgjeze e shtëpisë, “sfera të ndara”, “streha në botën e pashpirt” dhe “engjëlli në shtëpi”, edhe pse privoi shumicën e njerëzve nga kushtet e nevojshme për të realizuar ato ideale.

I shkatërruar nga kriza, regjimi liberal i dha vendit në shekullin XX një variant të ri të kapitalizmit, të menaxhuar nga shteti. Në këtë fazë, e cila u bazua në prodhim dhe konsum masiv, riprodhimi shoqëror u socializua pjesërisht, përmes sigurimit të mirëqenies sociale nga shteti dhe korporatat. Dhe modeli gjithnjë e më i çuditshëm i “sferave të ndara” ia dha vendin normës së re, më “moderne” të “pagës familjare”. Sipas asaj norme, e cila kishte mbështetjen e fortë të lëvizjeve për të drejtat e punëtorëve, punëtori industrial duhej të paguhej aq sa të mbante të gjithë familjen, duke i mundësuar gruas së tij t’u përkushtohej fëmijëve të tyre me kohë të plotë. Përsëri, vetëm një pakicë relativisht e privilegjuar e arriti këtë ideal;

por ishte frymëzues për shumë më tepër – të paktën, në shtetet e pasura të Atlantikut të Veriut, bërthamës kapitaliste. Kolonitë dhe post-kolonitë u përjashtuan nga këto rregulla, të cilat mbështeteshin në grabitjen e vazhdueshme të Jugut global. Kishte asimetri racore të integruara në Shtetet e Bashkuara, ku punëtorët shtëpiakë dhe bujqësorë ishin përjashtuar nga sigurimet shoqërore dhe format e tjera të sigurimit publik. Dhe natyrisht, paga e familjes institucionalizoi varësinë dhe heteronormativitetin e grave. Pra, kapitalizmi i administruar nga shteti nuk ishte epokë e artë, por gjithsesi krejt e ndryshme nga ajo që kemi sot.

Sot, sigurisht, ideali i pagës familjare ka vdekur. Është fatkeqësi, nga njëra anë, e rënies së pagave reale, e cila e bën të pamundur mbajtjen e një familjeje me një pagë të vetme (përveç kur dikush i përket 1 përqindëshit); dhe nga ana tjetër e suksesit të feminizmit, i cili delegjitimoi idenë e varësisë së grave që ishte ndërtuar në pagën e familjes. Si rezultat i kësaj goditjeje të dyfishtë, tani kemi normën e re të “familjes me dy burime të të ardhurave”. Tingëllon bukur, apo jo – duke supozuar se nuk jeni beqare? Ashtu si ideali i pagës familjare, megjithatë, edhe ky ideal është i turbullt. Mistifikon rritjen e madhe të numrit të orëve të punës së paguar që tani nevojiten për të mbështetur një familje dhe nëse shtëpia përfshin fëmijë ose të afërm të moshuar, ose njerëz që janë të sëmurë ose me aftësi të kufizuara dhe nuk mund të funksionojnë me pagë me kohë të plotë, atëherë aq më keq bëhet gjendja. Dhe nëse është një familje me një prind, është edhe më keq se kaq. Tani shtoji kësaj se ideali me dy fitues po promovohet në një kohë të shkurtimeve në sigurimet shtetërore. Midis nevojës për rritje të orëve të punës dhe zvogëlimit në shërbime publike, regjimi kapitalist i financuar po zbraz sistematikisht kapacitetet tona për mbajtjen e lidhjeve shoqërore. Kjo formë e kapitalizmit po shtrin energjitë tona “të përkujdesit” deri në pikën e thyerjes. Kjo “krizë e përkujdesit” duhet të kuptohet në mënyrë strukturore. Në asnjë mënyrë e papritur ose aksidentale, është shprehja, në

kushtet aktuale, e një tendence për krizë shoqërore riprodhuese që është e natyrshme në shoqërinë kapitaliste, por që merr një formë veçanërisht akute në regjimin aktual të kapitalizmit të financuar.

Leonard: A mund të flisni më shumë për rolin e feminizmit në këtë krizë? Feministet nuk synonin një familje me dy fitime.

Fraser: Jo, sigurisht që jo. Por ka ende një pyetje të thellë dhe shqetësuese se çfarë roli ka luajtur feminizmi në të gjitha këto. Feministet me të drejtë refuzuan idealin e pagës familjare si një institucionalizim i varësisë së gruas. Por ne e bëmë këtë në momentin kur zhvendosja e prodhimit ekonomikisht u nxor nga ky ideal. Në një botë tjetër, feminizmi dhe ndryshimet në industri mund të mos e kishin përforcuar njëri-tjetrin, por në këtë botë ata e bënë. Si rezultat, edhe pse lëvizjet feministe nuk e shkaktuan në asnjë mënyrë atë zhvendosje ekonomike, ne përfunduam pa dashur duke siguruar një legjitimim për të. Ne siguruam karizëm e çakëll ideologjik për agjendat e të tjerëve.

Por, mos të harrojmë, ndërkohë, se ka vërtet feministë neoliberalë që janë plotësisht në pajtim me këtë agjendë, të cilët po ashtu përfaqësojnë 1 përqindëshin. Madje guxoj të them se duket sikur do të zgjedhim njërin prej tyre si president të Shteteve të Bashkuara. Feministët neoliberalë janë feministë; nuk mund të themi se nuk janë. Por në atë fillesë të feminizmit ne shohim ide feministe të thjeshtuara, të cingëruara dhe të riinterpretuara në terma miqësorë ndaj tregut, si për shembull, kur mendojmë për vartësinë e grave në drejtim të diskriminimit, që parandalon gratë e talentuara të ngrihen në majë. Një mendim i tillë vërteton tërë imagjinatën hierarkike të korporatës. Legjitimon një botëkuptim që është në thelb armiqësor ndaj interesave të shumicës së grave, në të vërtetë të të gjithë njerëzve në mbarë botën. Ky version i feminizmit siguron një iluzion emancipues për grabitjen neoliberale.

Leonard: A mund të thuash më shumë se si shpërndarja e përkujdesjes në ekonominë tonë të financuar i vë gratë kundër njëra-tjetrës?

Fraser: Absolutisht. Tani kemi një organizim të dyfishtë të punës së përkujdesit, në të cilën ata që kanë mundësi të ndihmojnë në shtëpi thjesht paguajnë për të, ndërsa ata që nuk mund të përpiqen të përkujdesen për familjet e tyre, shpesh duke bërë punën e paguar të përkujdesit për grupin e parë, dhe shpesh me paga shumë të ulëta dhe pa mbrojtje. Ne kemi filluar të shohim fushata për të drejtat dhe pagat e jetesës në këtë sektor. Pra, qartë, kjo është një vendosje e drejtpërdrejtë e interesave kundër njëritjetrit. Gjithmonë kam menduar se ideja “Lean In” e Sheryl Sandberg-ut ishte ironike; është e mundur vetëm për lexuesit e saj që të parashikojnë animin në sallën e bordit të korporatave për aq sa ata mund të mbështeten te punonjësit e përkujdesit me pagë të ulët që pastrojnë tualetet dhe shtëpitë e tyre, t’ua ndërrojnë pelenën fëmijëve të tyre, të përkujdesen për prindërit e tyre të moshuar etj.

Këtu duhet të flasim për racën. Në fund të fundit, janë kryesisht gratë emigrante me ngjyrë, gratë afro-amerikane dhe gratë latine që po bëjnë këtë punë. Ju duhet të shkoni vetëm në ndonjë park në një lagje të klasës së mesme të New York City-t për ta parë këtë – është më se e qartë. Ka shtete, strategjia e ashtuquajtur “e zhvillimit” e të cilave është të lehtësojnë emigrimin e grave në vendet dhe rajonet e pasura për këtë qëllim. Filipinet, për shembull, varen shumë nga dërgesat e parave nga punëtorët vendas që punojnë jashtë vendit. Dhe kjo është një shkëmbim i punës i organizuar nga shteti – është strategjia shtetërore e zhvillimit. Shtetet në fjalë i janë nënshtruar rregullimit strukturor. Ata janë në borxh, të zhytur në para dhe kanë nevojë për valutë të fortë dhe nuk kanë asnjë mënyrë për ta marrë atë përveç dërgimit të grave të tyre për të bërë këtë punë, duke lënë fëmijët e tyre dhe familjet prapa në përkujdesin e njerëzve të tjerë të varfër. Unë nuk po sugjeroj se puna e përkujdesit nuk duhet të jetë kurrë një punë e paguar, por bën një ndryshim të madh se si paguhet, si është e organizuar dhe nga kush.

Leonard: A ka ndonjë punë specifike organizuese që shihni se

adreson këto probleme në një mënyrë që arrin në rrënjën e tyre?

Fraser: Ka një sasi të jashtëzakonshme organizimi dhe aktivizmi që po ndodh, shumë kreativitet, shumë energji. Por mbetet mjaft e shpërndarë dhe nuk ngrihet në nivelin e një projekti kundër-hegjemonik për të ndryshuar organizimin e riprodhimit shoqëror. Nëse bëni përpjekje për një javë më të shkurtër pune; për të ardhura themelore të pakushtëzuara; për përkujdesin publik të fëmijëve; për të drejtat e punëtorëve migrantë shtëpiakë dhe punëtorëve që bëjnë punë të përkujdesjes në shtëpi pleqsh, spitale, qendra të përkujdesit për fëmijë – atëherë shtoni betejat për ujin e pastër, strehimin dhe degradimin e mjedisit, veçanërisht në Jugun global – na sjell, për mendimin tim, te një kërkesë për një mënyrë të re të organizimit të riprodhimit shoqëror.

Betejat për riprodhimin shoqëror janë gjithandej. Ato thjesht nuk etiketohen si të tilla. Por nëse do të ndodhte që këto beteja ta kuptojnë veten në këtë mënyrë, do të kishte një bazë të fuqishme për t'i lidhur ato së bashku në një lëvizje të gjerë për transformimin shoqëror. Nëse ato gjithashtu e kuptuan që baza strukturore e krizës së sotme të përkujdesit është shtytja e qenësishme e kapitalizmit për të nënshtuar riprodhimin ndaj prodhimit, atëherë gjërat mund të bëhen vërtet interesante.

Leonard: Duke pasur parasysh interesin në rritje për socializmin mes të rinjve amerikanë, a e lidhni betejën për riprodhim shoqëror me betejën për socializëm?

Fraser: Absolutisht. Unë e quaj veten një socialiste demokrate, ashtu si Bernie Sanders, por ne po jetojmë në një kohë kur duhet të pranojmë sinqerisht se nuk e dimë saktësisht se çfarë do të thotë kjo. Ne e dimë se nuk do të thotë asgjë si ekonomia komanduese autoritare, modeli njëpartiak i komunizmit. Ne e dimë se kjo do të thotë diçka më të thellë dhe më të fortë dhe barazuese sesa demokracia sociale. Ne e dimë se nuk mund të jetë shtet-komb i kufizuar në një botë ku shfrytëzimi, shpronësimi dhe nxjerrja janë plotësisht transnacionale.

Ne i dimë të gjitha gjërat që nuk mund të jenë, me fjalë të tjera, por e kemi të vështirë të përcaktojmë programin pozitiv.

Një pjesë në të cilën unë do të insistoja është që riimagjinimi i riprodhimit shoqëror duhet të jetë thelbësor për çdo formë të socializmit që ne mund ta pretendonim si të dëshirueshme në shekullin e njëzet e njëttë. Si duhet të shpiket sot dallimi i riprodhimit/prodhimit dhe çfarë mund ta zëvendësojë familjen me dy burime të të ardhurave? Është interesante – nëse shikoni historinë e socializmit, madje edhe socializmin e vjetër utopik që Marx-i dhe Engels-i refuzuan, kishte një përqendrim të madh në atë që unë po e quaj riprodhim shoqëror: si ta organizojmë jetën familjare, të komunitetit etj. Ishte utopike në mënyra që nuk janë të zbatueshme për ne, por problematika ishte atje, madje edhe në historinë e socializmit modern, socializmit marksist dhe socializmit industrial jomarksist, kjo problematikë është hedhur brenda dhe jashtë diskutimit. Për pjesën më të madhe ai është trajtuar si dytësor ndaj problemit se si të organizohet industrializimi dhe të planifikohet prodhimi. Por nëse përqendrohesh vetëm në një pol të dyshes së prodhimit/riprodhimit, tjetra do të kthehet dhe do të të kafshojë në mënyra të padëshiruara dhe që do ta dëmtojë tërë projektin.

Leonard: Shumë nga pyetjet që shtroni në lidhje me jetën shoqërore dhe familjen janë dukur përsëri utopike, si disa mbetje të viteve 1960 dhe jo domosdoshmërisht thelbësore për një program socialist. E megjithatë, ju argumentoni se ne jemi në të vërtetë në një pikë krize dhe se këto çështje duhet të jenë thelbësore. Sfidat e riprodhimit shoqëror është aq thelbësore për përvojën e përditshme të jetuar të të gjithëve, sa që ka qenë befasuese për mua që shpesh mungon në ringjalljen aktuale të socializmit.

Fraser: Pajtohem shumë me këtë. Duke pasur parasysh mprehtësinë e kësaj krize të riprodhimit shoqëror, do të ishte utopike, në kuptimin e keq, që e majta të mos përqendrohej në këtë. Ideja që ne disi mund ta rikthejmë prodhimin është utopike – përsëri, në kuptimin e keq.

Ndryshe nga ideja që ju mund të ndërtoni një shoqëri që supozon se çdo i rritur është një person me përgjegjësi të përkujdesit parësor, angazhime të komunitetit dhe angazhime shoqërore. Kjo nuk është utopike. Është një vizion i bazuar në atë se si është në të vërtetë jeta njerëzore.

Leonard: A e shihni një rol pozitiv të teknologjisë në gjithë këtë, apo mekanizimi i punës së brendshme thjesht çon në thellimin e problemit? Kohët e fundit kemi dëgjuar shumë për ngrirjen e vezëve në Google, e cila është krijuar për të lejuar gratë të punojnë më gjatë para se të bëjnë fëmijë. Meqenëse priremi të mendojmë se shumë punë të rëndomta industriale duhet të mekanizohen, a e shihni punën e përkujdesit në një mënyrë të ngjashme? Apo është shumë intime për këtë?

Fraser: Unë sigurisht nuk jam person që kundërshton teknologjinë e re. E vlerësoj shumë që kam një dritë elektrike për të lexuar gjatë natës, mundësinë që të jem në gjendje të flas përmes Skype-it me ju nga larg e kështu me radhë. Unë nuk jam kundër as atyre teknologjive për të cilat kam shkruar në mënyrë kritike, si ngrirja e vezëve ose pompat mekanike të qumështit të gjirit. Pyetja është konteksti: si prodhohen dhe përdoren, nga kush dhe për përfitimin e kujt? Kështu që unë lehtë mund të imagjinoj një kontekst në të cilin disponueshmëria e atyre gjërave mund të jetë një zgjedhje legjitime. Unë aspak nuk turpëroj askënd për zgjedhjet shumë të kufizuara që ne bëjmë midis opsioneve shumë të këqija dhe opsioneve të kufizuara.

Unë gjithashtu mendoj se aktivitetet e orientuara drejt mbajtjes së lidhjes shoqërore përmbajnë një element personal të pashlyeshëm. Ato janë me përkufizim ndërpersonal që përfshijnë komunikim ndërsubjektiv dhe në disa raste edhe fizik. Kjo lufton kundër idesë së një mekanizimi total të përkujdesit.

Por përsëri, dyshoj se mund të parashikojmë automatizimin total të diçkaje, nëse kjo nënkupton eliminimin e të gjitha inputeve njerëzore.

Leonard: E drejtë, sepse në njëfarë mënyre ne thjesht flasim për kohën. Ne mekanizojmë gjëra të tilla si përkujdesja për të kursyer kohën tonë, sepse nuk kemi sa duhet. Vetëm në një situatë në të cilën keni kohë të mjaftueshme, ju vërtet kuptoni se çfarë dëshironi të mekanizoni.

Fraser: Ndihem mjaft e sigurt se nuk dua të laj të gjitha rrobat e mia me dorë dhe tashmë e di se ka shumë gjëra që nuk dua ta kaloj kohën duke i bërë. Do të doja të kisha më shumë kohë për të bërë gjëra të tjera, duke përfshirë biseda si kjo.

Sarah Leonard dhe Nancy Fraser në Dissent Magazine

Përktheu: Riola Morina



BETTMANN

7

Politikat mbi sutienat – Një histori e shkurtër e kundërshtimit feminist mbi to

Pandemia është tashmë e pranishme për 6 muaj e më shumë. Gjatë kësaj kohe, marrëdhënia jonë me sutienat është bërë më komplekse se kurrë më parë. Përderisa në ditët e sotme gjithnjë e më shumë punojmë nga shtëpia, kemi filluar ta kuptojmë edhe më shumë se sa të parëndësishme janë sutienat. Një mjet mjaft torturues për gratë dhe më delikat sesa egoja e brishtë e burrave. A janë sutienat çështje feministe? Apo nuk janë? Nuk e di. Por përgjatë historisë, çështja e sutienave ka qenë një ndër pikat kryesore në diskutim dhe shpesh ka qenë titulli kryesor i lëvizjes feministe. Ndërkaq, ky shkrim është përpjekje për të zbërthyer se çka do të thotë me të vërtetë sutiena, në kontekstin e patriarkalizmit dhe të “çlirimit të grave”.

Gjoksi i grave është hiperseksualizuar pothuajse në çdo kulturë. Madje kjo është edhe ndër arsyet pse trupi nudo i grave në thelb konsiderohet erotik. Në të njëjtën kohë edhe sutienat asociojnë me erotizëm. Në anën tjetër, sutienat janë dhe kanë qenë ndër faktorët kryesorë që kanë shkaktuar probleme fizike si dhimbja e shpinës, shpatullave apo edhe probleme në qarkullimin e gjakut. Kështu, për shkak të kolonializmit, standardeve të bukuri, evoluimi i tyre nga korsetë në sutiena është përhapur në të gjitha kulturat, ku, sipas këtyre standardeve, “gjoksi i ngritur” konsiderohet më tërheqës. Disa kultura indigjene, si ato spanjolle dhe britanike, i kanë prezantuar sutienat si rregull të kulturës së tyre, por kjo nuk ka përfunduar aty.

Tashmë sutienat janë bërë rregull kudo, ku pothuajse në çdo hapësirë, duke filluar nga shkollat deri në trotuare, gratë janë arrestuar apo qortuar nëse nuk i kanë pasur të vendosura, me arsyetimin se kanë bërë “ekspozim të pahijshëm”.

Feminizmi që i djeg sutienat, çka do të thotë?

“Feministet që dogjën sutienat”, në të vërtetë nuk dogjën sutiena, mirëpo ky mit buron nga konkursi i Miss Amerika i mbajtur në vitin 1968 në New Jersey, ku protestueset feministe hodhën lecat, buzëkuqtë, takat e larta në një kosh plehrash. Ato i hodhën këto gjësende në mënyre simbolike, pasi i konsideronin si shtypëse për gratë. Në këtë event nuk u dogj asnjë palë sutienash, por megjithatë ky emërtim ngeci që nga ajo kohë. Ky veprim nisi valën e re të feminizmit që u përqendrua në autonominë trupore të grave. Përderisa fenomene si racizmi, komercializmi dhe standardet e trupit të konkurseve po kundërshtoheshin, vetëm çështja e sutienave u bë sensacion. Që kur kjo etiketë u ngulit, puna e grave për të luftuar për të drejtat e tyre është konsideruar shumë sipërfaqësore dhe e parëndësishme. “Këta tituj e banalizuan lëvizjen”, tha zonja Morgan, e cila protestoi atë ditë.

Këtyre momenteve nuk u munguan as reagimet e burrave, të cilët komentnin se feministet që po digjin sutienat nuk po kërkonin vërtet liri, por përpiqeshin që të tërhiqnin vëmendjen e burrave. Kjo krijoi një pikturë që çdo grua pa sutiena është “feministe e zemëruar” dhe bëri të nënkuptojë se çdo lloj i feminizmit radikal ka të bëjë me djegie të sutienave. Feministet përshkruheshin edhe si përbindështa të interesuara për shkatërrim. Pas këtij sensacioni – “Feministet që dogjën sutiena” – heqja e sutienave u bë politike dhe më e përhapur se kurrë.

Heqja e sutienave – politike dhe personale

Heqja e sutienave ishte e thjeshtë, “mos i vishni më”. Ishte politike në

kuptimin që gratë po e çlironin veten nga industria miliarda dollarësh. Bëhej fjalë për vetëpranim, autonomi trupore dhe praktikisht kjo ishte më e rehatshme, më e shëndetshme dhe mundësonte të frymuarit lirshëm.

Susan Brownmiller, në librin e saj “Feminiteti”, të botuar në vitin 1984, përshkruan se “mungesa e sutienave i trondit dhe i zemëron burrat, sepse ata në mënyrë të pavetëdijshme nënkuptojnë që gjoksi është pronë e tyre dhe duhet të jenë ata të vetmit që i heqin ato”. Madje edhe në Indi, “bluzat” (bebidollkat), u bënë të njohura përgjatë British Raj-it, pasi grave indiane iu refuzua hyrja në klube për shkak që nuk i kishin veshur bluzat e tilla.

Largoni sutienat

Largimi i sutienave erdhi si lëvizje mbi zgjedhjen. Kjo lëvizje sfidon besimet puritanike dhe synon që të deseksualizojë gjinjtë, megjithëse pjesa më e madhe e fushatës ka të bëjë me pranimin e lakuriqësisë, në mënyrë më aktive, ajo sfidon imponimet që u janë vendosur grave në mbarë botën. Ushqyerja me gji në hapësira publike është ende mjaft tabu, edhe pse ka të bëjë më shumë me çështje praktike. Gratë gjithashtu detyrohen t’u nënshetrohen një mijë rregulloreve të kodit të veshjes dhe shpesh janë pushuar nga puna për shkak të shkeljes së kodit. Më tutje, në shumicën e kulturave, ideja e rritjes së gjinjve ka të bëjë me pjekurinë e vajzave dhe atyre që u zhvillohen shumë herët, shpesh detyrohen për martesë të hershme ose seksualizohen nga vetë familjarët. Kështu, atyre u kërkohet të rrinë në shtëpi, të mos luajnë sport dhe të “zbuten”. E gjitha kjo bëhet për të mos njollosur titullin “grua”.

Nuk është thirrje për nudizëm, por thirrje për liri. Gjithashtu është parë kryesisht në internet, mbështetja e lakuriqësisë artistike dhe kundërshtimi i censurës së thithkave. Sidoqoftë, ekziston një debat i madh se si kjo lëvizje nuk është gjithëpërfshirëse dhe e nuancuar, duke injoruar kryesisht luftën e grave zezake dhe indigjene.

Sutienat si një masë kontrolluese

Edhe në kohët e tashme, vendimi i grave për veshjen e sutienave ndërmjetësohet nga “shikimi mashkullor”. Shkollat ndalojnë “sutienat shumëngjyrëshe”, sepse ato mund të shpërqendrojnë djemtë. Në vendin e punës, ka ligje të ndryshme varësisht nga gjinia.

Në vitin 2013, manekinët në reklama të dyqaneve që mbanin sutiena dhe brekë u ndaluan ligjërisht për të parandaluar “përdhunimin” në Mumbai.

Kjo u bë për të vetmen arsye që burrat të mos eksitohen nga ato pamje.

Gjinjtë gjithashtu janë kontrolluar për të siguruar hierarkinë e kastës. Në shekullin e 18-të, u vendos një kastë për gjinjtë për gratë e Dalit dhe Shudra nga Mbretëria Travancore. Sipas kësaj, nëse ato dëshironin që të mbulonin gjoksën njësoj si gratë e kastës së sipërme, ishin të detyruara të paguanin taksë varësisht nga mosha dhe madhësia e gjinjve të tyre. Sundimtari i atëhershëm e shihte këtë si “shenjë” respekti për kastat e larta të fshatit. Kjo praktikë u shpall e jashtëligjshme në vitin 1924.

Edhe tani mbetet shumë për të bërë sa i përket çlirimit të vërtetë nga kufizimet e sutienave, si në mënyrë figurative, ashtu edhe në kuptimin bukfal. Kjo përfshin zhvendosjen e pronësisë së gjinjve nga burrat te gratë. Nuk ishte thirrje për nudizëm, por thirrje për liri.

Anureet Watta në SheThePeople

Përktheu: Medinë Dauti





Izolimi shpërfaqti shfrytëzimin e grave nga sistemi ekonomik. Federici e ka parapaparë këtë që moti.

Për dekada të tëra Silvia Federici ka paralajmëruar se çfarë ndodh kur nënvlerësojmë punën e papaguar të grave.

Në muajin maj, parku “Prospect” në Brooklyn është jashtëzakonisht i bukur: livadhe me bar të dendur, kodra dhe lugina, gjithçka e mbuluar me lule dhe aromë frutash. Zogjtë si dhe njerëzit janë të zhurmshëm. Mirëpo, majin e kaluar parku ishte më i qetë se zakonisht dhe njerëzit që lëviznin nëpër të ishin me një energji të zbehur dhe të shqetësuar. Disa kishin vënë maska, disa jo. Nganjëherë dikush i bërtiste dikujt tjetër, sepse i ishte afuar shumë. Në mes të kësaj skene, me hap energjik, po ecte Silvia Federici, teoricientja dhe studiuesja 78-vjeçare e punës së papaguar, një nga mendimtarët feministe socialiste më me ndikim të shekullit të kaluar.

Federici kishte vendosur një shall të zi mbi hundë dhe gojë, dhe kishte veshur një bluzë blu që ia kishte bërë nëna e saj shumë kohë më parë. Së paku një herë në ditë, edhe në dimër, Federici së bashku me partnerin e saj, filozofin George Caffenzis, ec rreth e rrotull këtij parku. (Caffenzis-i vuan nga sëmundja Parkinson, tregon Federici, dhe kjo ecje i ndihmon shumë). Megjithatë, gjatë muajit maj, ajo pranoi që për disa ditë me radhë të bënte një shëtitje të dytë me mua.

I kërkova të takohemi sepse problemet sociale, ekonomike dhe politike që i solli pandemia bënë që temat qendrore të punës së Federici-t të diskutoheshin edhe në ato vende ku nuk pritej.

Papritmas konceptet dhe frazat nga puna e saj ishin gjithandej në media sociale, opinione dhe biseda të përditshme mes miqve që diskutonin se cilat lloje të punës konsiderohen esenciale dhe pse. Federici është avokuese e moçme e idesë se punët e kujdesit janë punë e papaguar dhe njëkohësisht ajo ishte themeluese e lëvizjes “Pagë për punët e shtëpisë” në fillim të viteve 1970. Këto punë janë formë e shtypjes ekonomike gjinore, argumenton Federici, dhe një shfrytëzim mbi të cilin mbështetet komplet kapitalizmi.

Federici i takon grupit të studiuesve dhe aktivistëve të cilët, për dekada të tëra, kanë kritikuar mënyrën se si shoqëritë kapitaliste nuk njohin atë që ajo e quan “punë riprodhuese”. Këtë term ajo nuk e përdor thjesht për t’iu referuar lindjes dhe rritjes së fëmijëve; mirëpo për gjithë punën që e bëjmë për të mbajtur veten dhe të tjerët rreth nesh shëndosh, të ushqyer, të sigurt, të pastër, të përkujdesur, të lumtur. Janë mirëmbajtja e kopshtit, përgatitja e mëngjesit apo pastrimi i gjyshes së moshuar – punë që duhen bërë vazhdimisht, punë që nuk vërehen. Janë punë esenciale që sistemi ynë ekonomik nuk i njeh dhe nuk i kompenson. Kjo shpërfillje për punën riprodhuese, shkruan Federici, është e padrejtë dhe e paqëndrueshme.

Nuk mund të themi që këto ide ishin të panjohura para pandemisë. Mirëpo, rrymat e ndryshme të feminizmit, pa përmendur këtu rrymat politike ose ekonomike, kryesisht kanë injoruar punët e kujdesit. Fuqizimi i grave është matur përmes pranisë dhe ndikimit të tyre në vendin e punës, i cila arrihet duke kontraktuar gra më të varfra për të kryer punët e shtëpisë për një pagë të ulët. Megjithatë, gratë ende mbeten të zhytura në punët e shtëpisë. E kemi dëgjuar shpesh termin “orari i dytë” – term i krijuar nga sociologia Arlie Hochschild në vitin 1989, i cili përshkruan se si puna e mirëmbajtjes së shtëpisë dhe kujdesi ndaj fëmijëve bie disproporcionalisht mbi supet e grave edhe nëse ato mbajnë punë me orar të plotë. Për më tepër, personat që paguhen për t’i kryer punët e shtëpisë (kujdesin ndaj fëmijëve, të moshuarve etj.), paguhen shumë pak dhe nuk kanë përfitime të

tjera si sigurimi shëndetësor apo fondi pensional.

Në vitet e fundit, ekspertë të politikave publike dhe ekonomistë të ndryshëm kanë theksuar se është absurde që punët e shtëpisë të mos llogariten në matje të ndryshme ekonomike, siç është GDP-ja. Punët e papaguara të grave përbëjnë një pjesë të madhe të aktivitetit ekonomik të secilit vend dhe duhet domosdoshmërisht të përfshihen në matje ekonomike. Para një viti, Oxfam-i publikoi një hulumtim që tregon se nëse gratë amerikane do të merrnin pagë minimale për punët e shtëpisë, ato do të kishin fituar 1.5 trilion dollarë vetëm në vitin 2019. Globalisht, vlera e punës së papaguar do të ishte pothuajse 11 trilionë dollarë. Marilyn Waring, studiuese e politikave publike, theksoi se sa absurde është konsiderimi i punëve të kujdesit si të pavlera ose si aktivitet i kohës së lirë. “Nuk mund të bëjmë politika të mira nëse sektori më i madh ekonomik është i padukshëm” – tha ajo në një fjalim në vitin 2019.

Megjithatë, ky nuk është problemi i vetëm i sistemit ekonomik të tanishëm. Hendeku mes të pasurve dhe të varfërve është më i madh se që ka qenë në 100 vitet e fundit. Shumica e punëtorëve punojnë me paga të ulëta dhe jostabile. Këto kushte ekonomike kanë rraskapitur të gjithë dhe kanë krijuar një ndjenjë pasigurie. Këto ndjenja u rritën dhe u shndërruan në një krizë kur filloi izolimi për shkak të pandemisë. Së pari filloi diskutimi për “punëtorët esencialë”, një kategori që u vu re shpejt që kishte të bënte me punëtorët me pagat më të ulëta. Pastaj, klasat e mesme dhe të larta vunë re se kishin jetuar rehat pasi kishin kontraktuar dikë tjetër për t’i kryer punët e kujdesit, posaçërisht kujdesin ndaj fëmijëve dhe të moshuarve. Gjithashtu prindërit vërejtën se sa shumë mbështeten në mësues/e (të cilët paguheshin shumë pak) për t’u kujdesur për fëmijët e tyre 8 orë në ditë. Në mungesë të këtyre sistemeve të menaxhimit të kujdesit për fëmijë (kujdesi ditor, gjyshërit, kampet verore, kujdestarët për fëmijë etj.), prindërit amerikanë kuptuan se të kujdesesh për fëmijë është si të mbash një punë me orar të plotë. Këtë e kanë ditur që moti prindërit vetushqyes që edhe me më

shumë që edhe me më shumë se një punë me pagë minimale kanë qenë të paafte të përballojnë qiranë, ushqimin, dhe aq më pak kujdestare për fëmijë.

Kjo situatë e re ka sjellë një frymë radikale. Gjatë vitit të kaluar edhe ata që kanë qenë relativisht të padëmtuar nga pandemia filluan të shprehin ndjenja antikapitaliste, duke kritikuar sistemin ekonomik që i nënçmon dhe injoron punët e shtëpisë. Për shembull, një grup aktoresh (përfshirë Julianne Moore, Charlize Theron, drejtuesit e Birchbox-it dhe Rent the Runway), po bëjnë thirrje për një “Marshall Plan for Moms”, plan i cili do të përfshinte pagesa mujore për nënat. “Jemi lodhur duke punuar pa pagesë” – thonë ato. Shonda Rhimes shkroi në Twitter: “Kam 1 orë e 11 minuta që po ndihmoj me mësimet një 6-vjeçar dhe një 8-vjeçare në shtëpi. Mësimdhënësit duhet t’i paguajmë 1 miliard dollarë në vit. Ose në javë.”

Në mars, aktivistja Keeanga-Yamahtta Taylor aksidentalisht parashikoi këtë situatë të re, duke shkruar se “papritmas dhe drastikisht jeta në Amerikë ka ndryshuar dhe kur gjërat kthehen përmbys, fundi nxirret në sipërfaqe dhe ekspozohet”. Këtë vit iu shpërfaqën realitete të shëmtuara shumicës së amerikanëve që përjetuan izolimin në shtëpi. Shtëpia – vend ku po grumbullohen enët, rrobat e palara dhe pluhuri në emër të kujdesit. Shtëpia – që ka qenë gjithmonë vendi i punës për dikë tani është për më shumë njerëz se kurrë më parë, zonë ku përplasen shumë lloje të punës. Shtëpia, të cilën deri tani 34 milionë amerikanë e kanë humbur ose rrezikojnë ta humbasin për shkak të largimit nga puna dhe dëbimit nga qiradhënësi.

A do të kishte qenë ndryshe viti i kaluar po të vlerësohej si duhet puna që bëjmë për t’u kujdesur për njëri-tjetrin, vetën, dhe botën rreth nesh? Si do të dukej e ardhmja, siç thotë Federici, nëse “refuzojmë të bazojmë jetën tonë në vuajtjet e dikujt tjetër”, nëse “refuzojmë të shohim veten si më ndryshe se ata”? Federici u bë edhe më e njohur gjatë viteve të fundit, për shkak të lëvizjes “Occupy Wall Street”, lëvizje të cilën ajo e ka mbështetur shumë.

Shkrimet e saj mbi këtë lëvizje kanë sjellë një valë të re të lexuesve të majtë feministë. Gjatë vitit të kaluar ajo është cituar vazhdimisht nga artikuj shumë të njohur në “New York Times”, “The Atlantic”, e deri te “Teen Vogue”.

Kur u takuam në maj, Federici dukej më e relaksuar se shumica e personave që njoh. Derisa ecte drejt meje ishte e fokusuar dhe energjike, si dhe buzëqeshte pas maskës. Derisa po ecnim, ajo fliste shpejt, duke përmbledhur sistemet dhe format e ndërlidhura të cenueshmërisë që kanë qenë gjithmonë të pranishme, mirëpo tani përmes pandemisë po kanë ndikim te të gjithë. Federici tha se befasohej kur njerëzit e thërrisnin tani për të biseduar për shkrimet e saj të para 20 ose 30 viteve. Mirëpo, ka kohë që ajo dyshonte se rreziqet e nënvlerësimit të punës së kujdesit dikur do të shndërrohen në një krizë që është vështirë të injorohet. “Sistemi i tanishëm e bën jetën të patolerueshme dhe të pashëndetshme për miliona njerëz”, tha ajo, “është sistem që nuk funksionon”.

Vetë Federici ka lindur “nën bomba”. Ajo është vajza e dytë e një profesori filozofie në Parma të Italisë. “U lindi në Parma në 1942, në njërin nga vitet më të rënda në historinë e njerëzimit”, më tha ajo. Në janar të atij viti filloi të zbatohet “Zgjidhja Përfundimtare” nga nazistët. Nëna e saj flinte me rroba veshur dhe zgjohej mes bombardimeve të natës, kapte Federici-n e porsalindur dhe motrën e saj 4-vjeçare dhe vraponte në periferi të Parmës, ku uleshin dhe pritnin lindjen e diellit. Duke qeshur, ajo më tha se kjo përvojë e bëri që kurrë të mos dëshironte të ketë fëmijë.

Ndryshe nga shumë pjesë të Italisë, Parma ishte bastion i komunistëve pas Luftës së Dytë Botërore. Gjatë adoleshencës Federici u ndikua pikërisht nga kjo lëvizje anti-fashiste në Parma. Teoritë e shtypjes dhe të drejtat e punëtorëve ishin biseda të përditshme. Përgjatë fëmijërisë, prindërit e Federici-t dhe shoqëria e tyre rregullisht diskutonin për luftën dhe ndikimin e fashizmit. Megjithatë, politika e majtë e Parmës “bashkëjetonte” me një frymë intensive patriarkale. Babai i Federici-t,

profesor filozofie, ishte “ai që i dinte gjërat”. Ndërsa nëna e saj, që vinte nga fshati, supozohej se nuk kishte njohuri. Ajo kryente gatimin, pastrimin, blerjet dhe kujdesej për fëmijët. “Askush nuk e sheh punën time”, ankohej nëna e Federici-t. “Sepse kjo nuk është punë e vërtetë” – e ngacmonte babai.

Deri në moshën 30-vjeçare, Federici nuk pranoi të merrej me ato që i quanin “punë të grave”, punët që i kishte kryer nëna e saj. “E ndieja nënçmimin e punës së saj. Ishte aktivitet që as nuk shpërblehej e as nuk ofronte kënaqësi.” Megjithatë, Federici thotë se nëna e saj ishte inspirimi për idetë kryesore të shkrimeve të saj. “Dëgjjoja dhe flisja për punëtorët e fabrikave, ata i konsideroja si klasë punëtore. Mirëpo nëna më tha disa herë: “gjithmonë flet për punëtorët e fabrikave thua se ata janë të vetmit që punojnë!”. Këtë nuk ia thoshte babait tim, i cili ishte “mësuesi, intelektual, personi i ditur”. Nëna më tha gjërat që më vonë u bënë pjesë e politikës dhe shkrimeve të mia.

Politikat e Federici-t filluan të formoheshin 10 vite më vonë, në 1967, kur fitoi bursë për të studiuar në Shtetet e Bashkuara të Amerikës. Atje u inspirua nga lëvizjet studentore kundër luftës dhe lëvizja për të drejtën civile. Mirëpo edhe atëherë ajo nuk e njihte feminizmin si pjesë qendrore të vështrimeve të saj politike. Kjo ndryshoi në vitin 1972 kur një shoqe i sugjeroi të lexonte esenë “Donne e sovversione sociale” ose “Gratë dhe përmbysja e komunitetit” nga feministja Mariarosa Dalla Costa. Ideja qendrore e esesë ishte se kapitalizmi eksploaton gratë të cilat punojnë në shtëpi pa pagë.

Ky nocion ishte i jashtëzakonshëm për Federici-n. “Menjëherë, gjithçka mori kuptim”, tha ajo, përfshirë ankesat e nënës së saj që nuk ishin punëtorë vetëm burrat në fabrika, ankesa të cilat Federici deri tash nuk kishte menduar se lidheshin me nocione marksiste. Federici atëherë filloi të përfshihej me një grup feministësh, përfshirë Dalla Costa-n dhe James-in, të cilat e quanin veten “Kolektivi Feminist Ndërkombëtar”. Ky kolektiv filloi fushatën “Pagë për punët e shtëpisë”. Në vitin 1974, Federici dhe

Nicole Cox themeluan kapitullin e parë të “Pagë për punët e shtëpisë”, në Nju Jork.

Eseja e Federici-t “Pagë kundër punëve të shtëpisë”, botuar në 1975, ishte manifest i hershëm i lëvizjes për paga për punë të shtëpisë dhe ende mbetet njëra nga tekstet më të njohura. “Të kërkojmë paga për punë të shtëpisë ekspozon faktin se punët e shtëpisë janë para për kapital, kapital i cili fiton para nga gatimi ynë, buzëqeshjet tona (dhe gjëra të tjera), – thotë ajo, duke iu referuar marrëdhënieve seksuale. “Në të njëjtën kohë, kjo tregon se ne gatuajmë, buzëqeshim, (dhe bëjmë gjëra të tjera), jo sepse është e lehtë, por sepse nuk kemi zgjidhje tjetër. Na janë shtrembëruar fytyrat nga buzëqeshja.”

Prej fillimit, lëvizja “Pagë për punët e shtëpisë” përmbajti një definicion shumë të gjerë se kush i përket lëvizjes feministe. “Ne duhet të themi se të gjitha jemi amvise, të gjitha jemi prostituta, të gjitha jemi gejt... sepse përderisa mendojmë se jemi diçka më e mirë, diçka më ndryshe se një amvise, automatikisht pranojmë logjikën e ndarjes”, – shkroi Federici. Ajo përdor një ton gati përgjërues kur sugjeron se duhet të heqim qafe idenë se disa njerëz janë servilë ose të nënshtruar, idenë se shumë punë mund të jenë “punë që bëhen nga dashuria”. “Duhet t’u referohemi të gjitha punëve ashtu siç janë – punë”, shkroi ajo, “në mënyrë që përfundimisht të mund të rizbulojmë se çka është dashuria”.

Komiteti i Nju Jorkut veproi nga një zyrë e vogël në Park Slope, Brooklyn, ku avokonin për të përmirësuar kushtet e jetesës për gratë e varfra. Ato mbështetën formimin e grupeve të tjera në SHBA dhe Kanadë, si dhe mbështetën aktivistet Margaret Prescod dhe Wilmette Brown për të formuar “Gratë e zeza për paga për punë të shtëpisë”. Avokuan së bashku në mbështetje të aktivistëve për mirëqenie, pasi konsideronin mirëqenien si fitoren e parë në betejën për të siguruar paga për punët e shtëpisë. Mirëpo, pas katër vitesh punë, ky rrjet ndërkombëtar u prish. Komiteti i Nju Jorkut u shpërbë pas një mosmarrëveshjeje mes James-it dhe Prescod-it. Prescod-i thoshte se komiteti po injoronte prioritetet e grave të zeza; Federici e

mohon këtë dhe thotë se grupi kishte probleme me James-in.

Deri vonë të gjitha palët refuzuan të flasin për këtë konflikt 40-vjeçar, të bindura se do të largonte vëmendjen nga puna e tyre. Është temë veçanërisht e ndjeshme për shkak të historisë së gjatë të injorimit dhe përjashtimit të personave me ngjyrë, indigjenë, gej dhe trans nga lëvizja feministe. Megjithëse nuk u pajtuan kurrë, Federici, James-i dhe Prescod-i patën karriera të gjata në aktivizëm feminist. James-i dhe Prescod-i vazhduan angazhimin brenda Kolektivit Feminist Ndërkombëtar për “Pagë për punët e shtëpisë” dhe për “Grevën globale të grave” dhe Federici vazhdoi si aktiviste me projektin kundër dënimit për vdekje të Shoqatës Radikale të Filozofisë dhe Komitetit për Liri Akademike në Afrikë, si dhe si studiuese në Universitetin Hofstra.

Libri më me ndikim i Federici-t erdhi pothuajse 30 vite më vonë, kur ajo publikoi “Caliban and the Witch” në vitin 2004. Që nga vitet e 70-ta, shumë feministe antikapitaliste përfshirë Bell Hooks, Angela Davis, Wilmette Brown dhe Kolektivi i Lumit Combahee, kanë argumentuar se beteja feministe domosdoshmërisht është betejë antikapitaliste. Kjo betejë duhet të përfshijë vëmendje ndaj identitetit gjinor dhe racës, pasi kapitalizmi shtyp gratë, personat me ngjyrë dhe klasën punëtore. Kontributi i “Caliban and the Witch ” qëndron në faktin se argumentoi që të gjitha këto forma të shtypjes mund të gjurmohen te një burim i vetëm. Originën e kanë të njëjtë.

Federici propozon një teori të re lidhur me kalimin e Evropës nga feudalizmi në kapitalizëm. Ajo prezanton prova historike për të argumentuar se ky ishte momenti kur punët e grave u futën nën kontrollin e burrave kryefamiljarë dhe u kufizuan në sferën shtëpiake. Gratë ishin ato që mund të lindnin dhe ta rrisnin fuqinë punëtore, kështu që autonomia e tyre, posaçërisht aftësia e tyre për të lindur fëmijë, duhej të “mbyllej”. Pastaj duhej të bëhej edhe e “natyrshme”, sikurse amvisëria të ishte gjendje dhe dëshirë e trashëguar nga gratë. Ky ishte një tranzicion i dhunshëm,

argumenton Federici, duke përmendur mijëra gra të vrara gjatë asaj periudhe, kryesisht gra që nuk u pajtuan me këtë realitet të ri shtypës, të cilat u akuzuan se ishin shtriga.

“Kapitalizmi është sistem racist dhe seksist”, shkruan Federici. “Kapitalizmi denigron ‘natyrën’ e atyre që shfrytëzon: gratë, pasardhësit e skllervëve afrikanë, emigrantët etj. Vetëm kështu kapitalizmi mund të justifikojë kontradiktat e ndërthura në marrëdhëniet e veta sociale.” Federici thotë se nuk është “e natyrshme” që punët e kujdesit t’i takojnë vetëm njëres gjini. Njëkohësisht nuk është e natyrshme ose e pashmangshme që të kemi një sistem ekonomik prej të cilit përfitojnë një grup i vogël e të tjerët nënshtrihen. Ky sistem është krijuar vetëm se kushtet ishin të përshtatshme në atë kohë. Tash, ky sistem është përhapur aq shumë, saqë as nuk guxojmë të imagjinojmë diçka tjetër në vend të tij. Sistemi është krijuar që dikush të përfitojë, thotë Federici. Mirëpo, ky sistem mund të ndryshojë.

Viti i fundit, vit murtaje, vit zgjedhor, vit i tmerrshëm – na ofroi mundësi të mirë të vërejmë se kush përfiton nga ky sistem ekonomik dhe në kurriz të kujt. Gjatë vitit të fundit më shumë se 70 milionë amerikanë mbetën të papunë, shumica nga sektori i shërbimeve, ku shumica janë gra me ngjyrë. Personat me paga të ulëta humbën më shumë vendet e punës, si dhe qëndruan më gjatë pa punë. Njëkohësisht, më shumë se gjysma e punëtorëve esencialë, të cilët vazhduan të punojnë gjatë pandemisë duke rrezikuar shëndetin e tyre, kanë qenë gra dhe shumica prej tyre gra me ngjyrë.

Një artikull në “Think Global” nga Catherine Powell, profesore në Fordham, flet për “paradoksin e drejtësisë racore”. Sipas kësaj analize, amerikanët me ngjyrë kanë më shumë gjasa të mbeten të papunë për shkak të ndikimit të pandemisë në tregun e punës, por njëkohësisht përbëjnë pjesën më të madhe të punëtorëve esencialë, ku ekspozohen më shumë ndaj virusit. Ky paradoks u ka kushtuar jetën mijëra njerëzve.

Gjatë vitit të fundit gratë që punojnë në shëndetësi e kanë pasur shumë më vështirë se burrat. Një studim nga A.C.D.C. tregoi se 72% e punëtorëve shëndetësorë të shtruar në spital me Covid-19 mes marsit dhe majit kanë qenë gra. Shumë prej tyre ishin infermiere dhe ndihmësinfermiere, punë që përfshijnë kujdes të drejtpërdrejtë ndaj pacientëve dhe shumica ishin gra dhe persona me ngjyrë. Stafi që kryen vizita shtëpiake, si dhe pastruesit e spitaleve, po ashtu u sëmurën dhe vdiqën në numër të madh. Gjatë vitit të fundit, pastruesit kanë përjetuar një krizë humanitare. Aleanca e Pastruesve raportoi se 60% e pastrueseve humbën punën në maj dhe shtoi se shumica janë emigrante të padokumentuara dhe as që mund të kërkojnë ndihma nga qeveria. Në dhjetor, 156,000 gra humbën vendin e punës, ndërsa 16,000 burra u punësuan. Kur analizojmë këto të dhëna më hollësisht, shohim se gratë e zeza, latine dhe aziatiko-amerikane humbën vendet e punës, ndërsa gratë e bardha u punësuan. Pritet se kur këto gra të rikthehen në treg të punës, do të kenë paga edhe më të vogla se më parë.

Në vitin e fundit miliarderët amerikanë janë pasuruar për 1.1 trilion dollarë. Njëkohësisht po ndodhte një debat pervers mbi atë se jetën e kujt është e pranueshme ta sakrifikojmë për të shpëtuar ekonominë e vendit. Në maj presidenti Trump pranoi se nëse e fillojmë aktivitetin ekonomik, shumë njerëz do të vdesin, mirëpo gjithashtu deklaroi se “duhet ta rikthejmë vendin tonë”. Vendin e kujt? Ta kthejmë për kë?

Nuk është për t'u habitur që po rritet dëshira për një shoqëri ndryshe, një shoqëri që nuk nënçmon jetën e njerëzve për profit të klasës sunduese të përbërë nga burra të bardhë. Siç tha Kieeange-Yamahtta Taylor në mars: “Një shoqëri ku milionerët kanë shtëpi të zbrazëta, derisa familjet e pastreha sillen rrugëve; një shoqëri ku shumë rrezikojnë të dëbohen nga shtëpitë e tyre për shkak të mospagesës së qirasë, derisa qeveria na thotë se duhet të izolohehi në shtëpi, është shoqëri jonjerëzore”. Taylor-i bën pjesë në gjeneratën e re të aktivisteve që po e kthejnë vëmendjen te feminizmi i majtë i udhëhequr nga aktivistë të zinj.

Kjo rrymë feministe është injoruar shpesh nga rrymat e tjera të feminizmit. Në vitin 1984, Hooks-i e përmbledhi në këtë mënyrë: “Shpesh reformat feministe liberale vetëm i forcojnë vlerat kapitaliste dhe materialiste, pa i çliruar gratë ekonomikisht.” Shumë autorë të asaj kohe, përfshirë Hooks-in, Angela Davis-in dhe Audre Lord-in, e kanë thënë shpesh: Një feminizëm që injoron nevojat e grave të varfra, grave të zeza, grave trans dhe gej, grave me aftësi të kufizuara apo imigranteve, është feminizëm hipokrit. Këto vrojtime po vazhdojnë nga aktivistët e drejtësisë sociale si Taylor-i, Adrienne Maree Brown, Rachel Cargle, Dean Spade dhe Mariame Kaba. Te këto gjendet energjia e së majtës, edhe pse u mungon paraja ose fuqia institucionale.

Ende nuk e dimë se si lëvizja feministe amerikane do ta mbledhë veten dhe do të harmonizohet me mendimtarët që u takojnë grupeve të marginalizuara. “Reformat Liberale Feministe” të shekullit 20, në shekullin pasardhës u kthyen në feminizëm të korporatave. Kjo rezultoi në feminizmin e “markave” dhe “sloganeve” të 10 viteve të fundit. U krijua një ide se në mënyrë që gratë të fitojnë pozita vendimmarrëse, duhet të jenë të vendosura, të fuqishme, me vullnet të madh dhe të harrojnë krijimin e familjes. Filloi faza e sloganeve si “E ardhmja është e grave”, dhe “Vajzat bëjnë çfarë duan”, etj. të vendosura në bluza dhe kapela që shiteshin me çmime të larta.

Megjithatë, vajzat (më saktësisht gratë) nuk bënë mu atë çfarë deshën këtë vit. Edhe pse vazhdon të jetë gabim përgjithësimi i kategorisë së “grave”. Gjatë njërit prej takimeve tona e pyeta Federici-n: çka nënkuptojmë me fjalën “gra”? “Për mua gjithmonë ka qenë një kategori politike. Gratë definohej si të gjitha ato që kanë vuajtur prej kushteve dhe kërkesave që u janë caktuar historikisht. Këtu i përfshij edhe personat gej, trans, jo-binarë, intersex dhe queer.” Gratë nuk janë kategori homogjene dhe gratë e ndryshme i përjetojnë kohët e vështira, si vitin 2020, në mënyra të ndryshme. Premtimet e feminizmit liberal asnjëherë nuk kanë qenë më të

zbrazëta sesa tash, kur një numër gjithnjë e më i madh i grave po lihen jashtë këtij versioni. Barazia gjinore në fuqi punëtore (përfaqësim dhe paga të barabarta) nuk u krijua asnjëherë dhe çështjet e punës së kujdesit na kanë kthyer mbrapa me dekada. Këto çështje po tërheqin shumë vëmendje tani, jo sepse janë ide të reja, por se tani kanë filluar të prekin edhe gratë e klasës së mesme dhe të lartë, veçanërisht gratë e bardha. Ngjashëm, nuk është rritur interesimi në socializëm tani pasi kapitalizmi sapo ka filluar të dëmtojë punëtorët, por sepse punët e pasigurta dhe mungesa e sigurisë sociale po dëmtojnë gjithnjë e më shumë njerëz.

“Nuk mund të ndryshojmë jetën tonë të përditshme pa ndryshuar institucionet dhe sistemin politik dhe ekonomik i cili na strukturon jetën”, – shkruan Federici në librin “Re-Enchanting the World: Feminism and the Politics of the Commons”. Ka mënyra se si mund t’i rezistojmë “një sistemi të përkushtuar në nënçmimin e jetëve tona”, argumenton ajo. Ka mënyra për ta rikthyer vlerën dhe ta vendosim aty ku e ka pasur vendin gjithmonë. Që nga viti 1970 e deri sot, Federici jeton në parkun “Slope”. Ajo takoi Gorge Caffentzis-in në vitin 1972, kur edhe filluan të bashkëjetojnë. Gjatë lidhjes së tyre ishte Caffentzis-i ai që kryesisht gatuantë, deri tash vonë kur sëmundja Parkinson ia vështirësoi këtë. Tash Federici ka marrë përsipër gatimin, gjë që i pëlqen më shumë se kur ishte 20-vjeçare. Ajo më tregoi se Caffentzis-i e adhuron gatimin dhe kënaqësia që ai kishte gjatë gatimit i ndihmoi Federici-t të shihte këtë punë si më pak të mërzitshme.

Apartamenti i tyre është i mbushur me qindra libra – në raftë, nën shtrat, nëpër qoshe, bile edhe në kuzhinë. Federici është ende aktive edhe në moshën 78-vjeçare. Momentalisht është duke redaktuar një libër mbi dënimet me vdekje dhe duke shkruar një libër të ri: “Patriarchy of the Wage: Notes on Marx, Gender, and Feminism”, i cili do të publikohet në maj. Në këtë libër ajo shtron pyetje të ngjashme që ka shtruar që nga vitet e 70-ta: “Pse kritikant marksistë të kapitalizmit kanë injoruar plotësisht punët e kujdesit? Cilat janë pasojat e këtij injorimi?”

Gjatë njërit prej takimeve tona, Federici më tregoi se nuk kishte shkruar asgjë për tri vite të tëra. Nëna e saj e moshuar kishte nevojë për përkujdesje 24-orëshe dhe Federici shkoi në Parma që t'i ndihmonte motrës së saj të kujdesej për nënën. “S’mund të lëvizte fare. Unë e motra kujdeseshim tërë ditën, mirëpo nuk mjaftonte.” Më vonë Federici kuptoi se nëna e saj kishte marrë plagë nga qëndrimi në shtrat. “Kurrë nuk e harroj dëshpërimin dhe panikun e atij momenti.” Gjatë ditëve në vijim, Federici dhe motra e saj u kujdesën për nënën e tyre, e ushqenin, e lëviznin gjatë ditës që të mos mbetej e shtrirë në shtrat dhe e lanin. “Imagjino po të kishim ndonjë strukturë në komunitet që mund të na ndihmonte – kjo ishte e tëra që kisha në mendje gjatë atyre ditëve. Unë jam momentalisht këtu, në këtë shtet. Me siguri janë edhe mijëra gra të tjera që po kalojnë vuajtje të ngjashme.”

Ajo u kthye nga unë dhe tha: “Pyetja qëndron te vlera e jetës. Çka është me vlerë? Ku qëndrojnë prioritetet? Pas vdekjes së nënës, Federici u kthye në shtëpi dhe filloi të shkruante mbi bashkësitë.

Gjatë 10 viteve të fundit, Federici e ka zhvendosur fokusin e saj drejt nevojës për ta kthyer mbrapsht “mbylljen” – procesin përmes të cilit e gjithë bota është “mbyllur” brenda kapitalizmit, jo vetëm pronat dhe tokat, por edhe trupat tanë, koha jonë, mënyra se si arsimohemi, shëndeti ynë, marrëdhëniet tona, vëmendja jonë dhe mendjet tona. Siç tha Francisco Cantu në janar duke cituar Federicin: “Edhe aftësia jonë për të komunikuar me familje është materializuar nga kompanitë e teknologjisë”. Federici thotë se “ilaçi” i kësaj mbylljeje është të kthehemi gjithnjë e më shumë nga “bashkësitë”.

“Bashkësitë” – u referohen burimeve (tokës, dijes, materialit kulturor dhe intelektual) që qëndrojnë jashtë çdo tregu. Të jetuarit në bashkësi na kërkon të vendosim gjithnjë e më shumë aspekte të jetës jashtë kufijve të eksploatimit kapitalist. Joshja e “bashkësisë” është se mund të bëhet kudo,

përderisa ka vullnet në atë komunitet: një tokë e vogël e pabanuar mund të shndërrohet në një fermë të vogël; shqetësimet shëndetësore të një lagjeje mund të plotësohen përmes një klinike lokale të drejtuar nga vetë lagjia; punët e kujdesit mund të ndahen mes familjareve etj. “Nuk keni nevojë ‘për leje’ për të krijuar bashkësi”, thotë David Bollier. “Nuk duhet të njihni lobistë dhe avokues në Washington, nuk duhet të jeni ekspert. E keni lirinë të krijoni diçka vetë nga resurset që keni në komunitet.”

Mënyrat se si një komunitet i tillë mund të duket janë po aq të larmishme sa vetë komunitetet e ndryshme. Së fundmi, një grup programerësh ndihmuan disa familje të organizojnë online kujdesjen e përbashkët të fëmijëve. Rrjetet e ndihmës reciproke kanë lulëzuar gjatë pandemisë: duke përdorur Google Doc, fqinjët mund të shkruajnë atë çfarë kanë dhe atë çfarë u nevojitet, duke formuar (ose shpërfaqur) lidhje simbiotike mes vetë fqinjëve. Këto shkëmbime janë të thjeshta: në vend se të punësoni një punëtor, një fqinj mund t’ju ndihmojë të instaloni ventilatorin; në këmbim, ju mund ta ndihmoni atë ose një fqinj tjetër rreth taksave, kujdesit ndaj kafshëve apo kopshtarisë. Përveç donacioneve për organizatat e mëdha jofitimprurëse, ju mundeni gjithashtu t’u përgjigjeni thirrjeve të rrjeteve lokale për të ndihmuar njërin nga fqinjët të paguajë qiranë. Përderisa po bëjmë presion ndaj qeverisë dhe organizatave të tjera të bëjnë shpërndarjen e resurseve të nevojshme, komuniteti juaj mund të bashkohet në mënyrë që të grumbullojë dhe t’i rrisë resurset që tashmë i ka.

Federici thekson se komunitetet indigjene shpesh kanë qenë ato që krijuan dhe përdorën ”bashkësitë”. Ajo flet për “mbrojtësit e ujit” në Amazon, “Lëvizjen e Personave pa Tokë në Afrikë Jugore”, kopshtet urbane në Ghana dhe gratë në Kili që bashkuan dhe ndanë resurset e tyre ushqimore gjatë periudhave të varfërisë. “Nuk janë komunitetet më të industrializuara, por komunitetet më kohezive ato që janë në gjendje t’u rezistojnë dhe në disa raste edhe të përmbysin valën e përhapur të privatizimit”, – shkruan ajo në “Patriarchy of the Wage”.

Një nga shembujt më të mirë të Federici-t për bashkësitë janë protestat e fisit “Standing Rock Sioux” në 2016 dhe 2017. Derisa ishin duke protestuar një projekt privatizimi, ata ndërtuan një rrjet kampesh ku ofruan ushqim, strehim dhe siguri për mijëra protestues. Edhe në dimër. Ata krijuan edhe një shkollë për fëmijë, duke e ditur se nëse familje të tëra do të protestonin, fëmijët do të kishin nevojë për kujdes si dhe arsimim. Ata i shndërruan këto kampe në komunitete afatgjata të jetueshme. Kjo u lejoj të krijojnë një lëvizje afatgjatë të mbështetur ndërkombëtarisht.

“Bashkësitë prodhojnë një përvojë të fuqishme dhe të rrallë të të qenit pjesë e diçkaje më të madhe se jeta jonë individuale”, – shkruan Federici. “Krijojnë një ndjenjë që nuk po banojmë si të huaj në këtë botë, ndjenjë që kapitalizmi mundohet ta shtyjë përpara, mirëpo kjo është shtëpia jonë”. “E majta shumë shpesh nuk e njeh forcën e komuniteteve”, – i tha Federici autores Astra Taylor në një intervistë të vitit 2019. Politikat e Federici-t theksojnë mundësitë revolucionare për t’u thënë njerëzve se ata mund të luftojnë për ndryshim aty ku janë, qoftë në shtëpi, në supermarket, në kishë apo në strehimore. “Jeta e përditshme është terreni kryesor i ndryshimit shoqëror.”

Kur Federici imagjionon një botë me të vërtetë të drejtë, shkruan për mënyrën se si veprimi kolektiv e transformues mund të përputhet me magjinë e natyrës, e cila rigjenerohet vazhdimisht. Kështu ajo vazhdon ta mbajë parkun Prospect si shembull të krijimtarisë, mundësisë dhe bukurisë. Në një ditë të errët vitin e kaluar e pyeta se çka e bënte të ndiente magjinë e botës, ajo tha: “Kjo!”. Tundi duart rreth e rrotull në ajër, duke bërë me gisht nga pemët, zogjtë, papastërtitë dhe baltën ku po luanin disa fëmijë.” Asaj iu rrudhën sytë prapa maskës. “Krijimtaria e natyrës më magjeps. Vetë njerëzit më magjepsin.” Kur shpërtheva duke qeshur me mosbesim, ajo protestoi: “Ka vërtet shumë bukuri, bujari dhe guxim te njerëzit”.

Ka ende gëzim, e shoh, ka ende shumë bukuri në këtë botë. Dhe shpresoj këto bukuri të mbizotërojnë mbi ata që duan ta kontrollojnë dhe ta copëtojnë.

Jordan Kisner në NY Times

Përktheu: Donjeta Morina



9

Stigma mbi menstruacionet është një formë e mizogjinisë

Pse po i kushtëzojmë gratë e reja që ta konsiderojnë të turpshëm një proces biologjik?

Kur më erdhën menstruacionet për herë të parë, isha në banjën e një supermarketi. Si një 12-vjeçare, në siklet shikoja poshtë të brendshmet e mia dhe isha e tmerruar dhe e hutuar. Megjithëse e dija që ishin menstruacione, nuk e dija si dhe pse. Dija vetëm se konsiderohej e neveritshme, ndihesha sikur kisha bërë diçka tmerrësisht të gabuar dhe e mbajta të fshehur derisa u detyrova nga nevoja t'i tregoja nënës sime. Tash që e mendoj, e kuptoj se sa e tmerrshme ishte të ndiheshe kaq e turpëruar për një proces natyror. Menstruacionet nuk duhet të jenë një ngjarje traumatike dhe e turpshme.

Shoqëria, përmes konotacioneve negative mbi ciklin e grave dhe këndvështrimit të shpifur me gjithçka që lidhet me menstruacionet, na bën të ndihemi në këtë mënyrë. Instagram-i censuroi artisten Rupī Kaur për postimin e një fotoje të saj në shtrat me një njollë të menstruacioneve. Sipas Kaur-it, fotografia u fshi dy herë, sepse nuk përputhej me standardet e komunitetit të faqes. Ironikisht, fotografia ishte pjesë e një projekti artistik që sfidonte stigmën shoqërore mbi menstruacionet.

Qëndrimi regresiv i Instagram-it është shembull se si portat tona kulturore tregojnë pakënaqësi me çdo gjë që lidhet me menstruacionet. Një seri e fotografive e jakut menstrual e botuar në Cosmopolitan u etiketua si “jo e përshtatshme për punë”, edhe pse asnjë nga imazhet nuk ishte grafike.

Në një shkrim të botuar në The Guardian, shkrimtarja Rose George vuri në dukje absurditetin e kritikës ndaj sportistëve gra, të cilat përmendin menstruacionet e tyre, edhe nëse ato shkaktojnë dhimbje dhe shqetësime që ndikojnë negativisht në performancën e tyre.

Kaur-i dhe mbështetësit e saj vunë në dukje se Instagram-i lejon gratë të shpërndajnë fotografi shumë seksuale. Vendimi i kompanisë për të censuruar një imazh të gjakut menstrual përçoi mesazh se trupat e grave janë të pranueshëm nëse janë seksualisht të dëshirueshëm. Kjo hipokrizi pasqyrohet te shumë burra që kam njohur, të cilët pa hezitim shikojnë filma të dhunshëm, apo luajnë video-lojëra vrasëse, por që neveriten nga ideja e menstruacioneve. Në këtë mënyrë, tabutë mbi menstruacionet njëloj si turpi mbi trupin janë formë thellësisht e rrënjësuar e mizogjinisë. Ne nuk mund të zhdukim sjelljen e urrejtjes ndaj grave përderisa refuzojmë konceptin se kjo formë biologjike e gjakderdhjes është e turpshme.

Pikërisht për shkak të stigmatizimeve të tilla, gratë e reja, duke e përfshirë edhe veten time në moshë më të re, kushtëzohen të besojnë se nëse kanë një njollë të menstruacioneve në publik, është njëra ndër gjërat më të turpshme që mund t'u ndodhë atyre. Historitë “poshtëruese” të menstruacioneve të botuara shpesh në revistat e adoleshentëve dhe grave janë praktikisht një zhanër më vete. Kjo është arsyeja pse kemi kaq shumë eufemizma dhe terma të pahijshëm për menstruacionet.

Gati çdo grua që njoh ka pasur një fatkeqësi menstruale, një aksident në shkollë apo në punë. Shumë prej nesh jemi gjendur në hapësira publike pa tampon dhe peceta sanitare. Disa prej nesh kanë pasur përvoja të këqija të tilla si heqja e kupës menstruale të mbushur dhe të përdorim produkte silikoni të ripërdorshme për të mbledhur gjak menstrual. Këto aksidente janë të pakëndshme dhe të papërshtatshme, por pse mos t'i pranojmë njëloj siç mund të na derdhet një filxhan kafe në pantallona?

Fatmirësisht kemi hasur diskutime, shumica e të cilave janë në qendër të vëmendjes së publikut. Larry Wilmore nga Comedy Central “The Nightly Show” organizoi një panel në të cilin ai dhe mysafirët e tij diskutuan mbi menstruacionet si kundërpërgjigje ndaj një shkrimi, i cili argumentonte se Hillary Clinton është kandidate e përshtatshme për presidencën, sepse është në postmenopauzë, në këtë mënyrë është më e fortë dhe më energjike. Wilmore me të drejtë u tall me këtë nocion të ciklit menstrual të një gruaje si një hendikep dobësues. Një nga anëtarët e panelit, Nicole Wallace, ish-drejtoresh e komunikimit për George Bush, tha: “Po, unë kam punuar në Shtëpinë e Bardhë. Çdo 28 ditë kam gjakosur, por shteti vazhdoi punën.”

Për të respektuar gratë plotësisht, ne duhet të heqim dorë nga të perceptuarit e menstruacioneve si diçka e neveritshme dhe ta konsiderojmë atë si një proces të natyrshëm. Jose Garcia, një djalë adoleshent bëri pikërisht këtë gjë: Ai u bë i famshëm në Instagram pasi postoi një fotografi të vetes duke mbajtur në dorë peceta menstruale dhe duke inkurajuar djem të tjerë që të mbështesin vajzat dhe gratë, duke vepruar njëjtë si ai. “Frymëzimi im nuk erdhi vetëm nga një burim, por nga gjërat e përditshme që kanë ndodhur rreth meje, të tilla si një shoqe që ndihet në siklet për të kërkuar një triko që ta lidhë rreth belit për shkak se pantallonat e saj janë njollosur”, tha Garcia në një intervistë për The Daily Dot. Si një feminist, ai beson se inkurajimi i djemve dhe burrave për të mbajtur produkte femërore mund të ndihmojë në ndalimin e stigmës mbi menstruacionet.

Kështu, përpjekjet e ndërgjegjësimit dhe edukimit, të tilla si Dita e Higjienës Menstruale, e cila festohet nga organizatat në të gjithë botën, do ta thyejë heshtjen rreth nevojave të higjienës së grave. Avokimi i higjienës menstruale është kritike jo vetëm për shkak se gratë në SHBA dhe në vende të tjera janë turpëruar për menstruacionet e tyre, por gjithashtu sepse shumë prej tyre nuk kanë qasje në produktet e nevojshme për menaxhimin e tyre.

Një peticion nga studentja universitare australiane Subeta Vimalarajah, për t'u dhënë fund taksave të qeverisë mbi tamponët dhe pecetat, në mënyrë të ngjashme tërheq vëmendjen sistematike nga produkte të tilla si më pak të domosdoshme krahasuar me kremin mbrojtës ndaj diellit apo fashat nikotike, të cilat konsiderohen si mallra të rëndësishme shëndetësore, me ç'rast janë të liruar nga taksa.

Personalisht, unë kuptova plotësisht se çfarë ndodh çdo muaj në mitrën time vetëm kur ndoqa një kurs mbi shëndetin riprodhues në një klinikë lokale të grave në kolegji. Unë nuk isha më e turpëruar apo në siklet. Ndihesha me fat të mësoja për gjërat e mahnitshme që trupi im bënte çdo muaj. Është koha që të tjerët, gratë dhe burrat, ta kuptojnë këtë gjë.

Erika L. Sánchez në Aljazeera

Përktheu: Greta Avdyli



10

Si ndikojnë kapitalizmi dhe epërsia e të bardhëve në standardet e bukurisë

Përshëndetje, quhem Jessica DeFino, jam reportere në industrinë e bukurisë dhe kam për qëllim ta shkatërroj këtë industri.

Ndoshta e teprova pak. Unë ‘dua’ të përpiqem t’i shkatërroj standardet e bukurisë përmes rubrikës sime të përmuajshme “Standard Issues” (Shqetësimet e zakonshme) në Teen Vogue.

Sipas mendimit tim, standardet e bukurisë janë rrënjët e kalbura dhe të lidhura nyjë të të gjitha të këqijave të kësaj industrie dhe botës si tërësi. Janë mjete të shtypjes që fuqizojnë seksizmin, racizmin, diskriminimin në bazë të ngjyrës, klasës, moshës dhe normave gjinore. Janë te vendosura në shoqëritë tona dhe të ngulitura në trurin tonë. Kontribuojnë në rritjen e ankthit, depresionit, dismorfisë, çrregullimeve në të ushqyer, vetëlëndimeve dhe nënvlerësimit për veten. Edhe vetë termi kontradiktor “standardet e bukurisë” më nervozon. Imagjinoni mundin për akomodimin e “bukurisë”, një koncepti të pamatshëm, të padefinuar, emocional, energjik dhe evolues në një standard të vetëm. Pse? Për çfarë arsye? T’i shërbejë kujt?

Para se t’u përgjigjem këtyre pyetjeve, për qëllim të kësaj rubrike, më duhet t’i definoj “standardet e bukurisë”. Standardet e bukurisë janë kualifikime individuale që gratë pritet t’i plotësojnë që të arrijnë “idealin e bukurisë femërore”, në mënyrë që të jenë të suksesshme personalisht dhe profesionalisht.

(“Gratë” dhe “femërore”, këta dy terma janë përdorur këtu pasi industria e bukurisë qëllimshëm është e ndërtuar mbi bazën e themelit që mbështet patriarkatin dhe ndikon negativisht te gratë, burrat dhe njerëzit e papërcaktuar rreth gjinisë. Por kjo mbetet si temë për rubrikat e ardhshme). Këto kualifikime na komunikohen qartë dhe vazhdimisht përmes filmave, televizionit, literaturës, revistave, sistemit arsimor, sistemit shëndetësor, politikës, marrëdhënieve personale, medie sociale, ligjeve dhe reklamave. Është e ngjashme me shpëlarjen e trurit: shumë psikologë kanë argumentuar se si është e pamundshme të bëhet ndarja se çka konsiderojmë ne individualisht dhe natyrshëm të bukur dhe çka na thotë shoqëria të na duket e bukur. Që të dyja, standardet e bukurisë dhe ideali i bukurisë femërore janë shënjestra në lëvizje të vazhdueshme. Ndryshojnë me kalimin e kohës dhe nga kultura në kulturë. Sidoqoftë, duke iu falënderuar kolonializmit perëndimor (do t’i kthehem kësaj për një çast), standardet e bukurisë eurocentrike janë shndërruar në standarde globale të bukurisë. Përgjatë hulumtimit tim në Afrikë, kam intervistuar tregtarë të produkteve kozmetike që thonë se Afrika dhe Azia ndikohen nga lëvizjet në perëndim. “Çka shohim sot [te trendët e bukurisë në Amerikë], pas tri viteve do të arrijë në Afrikë dhe Azi”, tha Amira Adawe, themeluese e organizatës jofitimprurëse The Beautywell Project.

Standardet perëndimore të bukurisë janë produkt i shoqërisë kapitaliste, kolonialiste, patriarkale, me epërsi të të bardhëve.

“Nuk ka një arsytim legjitim historik apo biologjik për justifikimin e mitit të bukurisë”, shkruan Naomi Wolf në The Beauty Myth: How Images of Beauty Are Used Against Women. “Antropologët nuk kanë gjetur prova mbi teorinë që modelet e përkryera të të sotmes burojnë nga procesi evolucionar i përzgjedhjes së partnerëve”, theksoi ajo.

Natyrisht, koncepti i përgjithshëm i së bukurës ka ekzistuar prej shekujsh – por, në të kaluarën bukuria dukej se kishte të bënte më pak me sipërfaqësoren dhe më shumë me shpirtëroren.

Në librin *History of Aesthetics* (*Historia e Estetikës*), autori Władysław Tatarkiewicz bën kërkime mbi idenë greko-romake se bukuria lidhet me hyjnore dhe të mirën. Vlera shpirtërore kishte edhe në Egjiptin e lashtë. Grimi ishte një formë zbukurimi që përdorej për të imituar dhe për të komunikuar me perënditë. Ngritja e krishterimit në Evropë bëri që lidhja mes të bukurës dhe shpirtërores të marrë një kthesë më autoritare në Mesjetë. “Gratë nxiteshin të paraqiteshin të dëlira dhe virgjërore, gjithmonë të reja”, shkruan Mark Tungate në *Branded Beauty: How Marketing Changed the Way We Look*. Tiparet me ngjyra të lehta si: flokë biond, sy të kaltër dhe lëkurë me ngjyrë të hapur besohesh se ishin manifestime fizike të “ndriçimit hyjnor”. Me fillim të shekullit XV, kolonizatorët arritën në Afrikë, Azi dhe Amerikë Latine duke prezantuar idenë se bardhësia është e mirë, s’ka asgjë më të mirë se e bardha”, thotë Adawe. “Nëse ishte i bardhë, kishte mirëqenie më të mirë ekonomike, arritje më të mëdha në punësim dhe shkollim”, shtoi ai.

Ka kohë që tonet e lëkurës kanë konotacion klasor. Në shoqëritë e lashta egjiptiane, greke dhe romake, ngjyra e lëkurës së hapur shoqërohej me përkatësinë në një klasë më të lartë, sepse “një grua me lëkurë të hapur bënte jetë tërësisht të ndryshme nga një punëtore krahu me ngjyrë lëkure të errët, por kolonializmi e mori këtë koncept dhe e shtriu nëpër raca”, shkruan Tungate.

“E njëjta ideologji ishte edhe gjatë kohës së skllavërisë në Shtetet e Bashkuara”, thotë Adawe. “Ata me lëkurë më të errët punonin jashtë në fushë, ndërsa ata me lëkurë më të hapur favorizoheshin dhe punonin në shtëpi. Ata me lëkurë më të hapur konsideroheshin të bukur. Ky standard vazhdon të ekzistojë përbrenda kulturave dhe grupeve”. Ajo thotë se ky standard qëndroi edhe pas largimit të kolonizatorëve nga Shtetet e Bashkuara, edhe pas shfuqizimit të skllavërisë. “Kolonizuesit u larguan, por ata lanë një trashëgimi: trashëgiminë e së bardhës që është një kolonizim i vazhdueshëm i mendësisë.”

Mendësia kolonizuese vazhdon edhe sot. Ajo reflektohet në fytyrat e pasqyruara nëpër faqet e revistave të modës, të cilat deri vonë ishin pothuajse ekskluzivisht me fytyra të bardha. Në çdo asortiment të ngjyrave të kremi pudër ekzistonte mundësia e përzgjedhjes së nuancave prej 10 llojeve për gratë e bardha por vetëm dy lloje për gratë e zeza; një dukuri shumë e zakonshme pavarësisht vëmendjes së kohëve të fundit të industrisë për përfshirjen e më shumë nuancave. Kremrat për zbardhjen e lëkurës vazhdojnë të jenë pjesë e shitjeve në korporatat kozmetike.

Në këtë mënyrë, kolonializmi i dha kapitalizmit një model biznesi të shkëlqyer për të ndjekur: I tregoi se sa lehtë është të përfitohet nga pasiguritë e mbjella thellë, të dala nga trajtimi i keq. Kështu përgjatë historisë kapitalizmi mbolli farat e pasigurisë të gjithë ne. Shumë nga ato që i besojmë si të vërteta për trupin tonë nuk janë asgjë më shumë se marketing, të shpikura nga kompanitë kozmetike me qëllime përfitimi për ta.

Në librin e saj “War Paint” autorja Lindy Woodhead paraqet karrierën e sipërmarrëses së kozmetikës Helena Rubenstein duke shkruar “Ishte specialistja e parë e bukurisë që bëri klasifikimin e lëkurës si ‘e thatë’, ‘normale’ dhe ‘e yndyrshme’ në fillim të viteve 1900 dhe përdori këto klasifikime për shitjen e kremi të saj të fytyrës Valaze. Që nga atëherë gratë filluan të vërejnë se funksioni normal i lëkurës së tyre (formësimi i rrudhave dhe skuqeve, shfaqja e yndyrës, ekzistimi i qelizave të vdekura të lëkurës) ishte i gabuar dhe se “blerja e kremrave do ta përmirësojë atë”.

Ngjashëm, rutina e sotme tipike për përkujdesje të flokëve nuk është e rekomanduar nga ekspertë flokësh, por nga një tregtar. Kur Eugène Schueller, krijuesi i L’Oréal, prezantoi shampun e kompanisë në vitin 1938, ai gjithashtu prezantoi një standard të ri: “Janë 43 milionë njerëz në Francë” tha ai sipas Tungate-it. “Të paramendojmë që këta 43 milionë njerëz lajnë flokët e tyre një herë në javë. Ne do të shisnim 20 herë më shumë numër të artikujve sesa shesim për momentin”.

Schueller-i e përmbloodhi qasjen e tij të marketingut kështu: “Tregojuni njerëzve se janë të gërditshëm, nuk mbajnë aromë të mirë dhe nuk duken tërheqës”. Ama ua thoni me delikatesë. Manipulimi psikologjik është gurthemeli mbi të cilin është ndërtuar marketingu për bukurinë. Kjo metodë jo vetëm që është ideale për shitjen e produkteve, por është ideale edhe për mirëmbajtjen e patriarkatit.

“Gratë janë thjesht ‘bukuroshe’ në kulturën e burrave”, shkruan Wolf-i në The Beauty Myth. Ajo argumenton se standardet moderne të bukurisë janë përdorur si ‘armatim politik kundër avancimit të gruas me një prapavijë të dhunshme kundër feminizmit’ duke krijuar edhe paralele në mes të lëvizjeve feministe në vitet e ‘60-ta dhe të ‘70-ta dhe rritjes së kontrollimit të dukjes së gruas në këtë kohë. Feministet stereotipizoheshin si të “shëmtuara” në përpjekje për të nënvlerësuar mesazhin e tyre. Numri i artikujve që kishin të bënin me dietat në revistat e grave u rrit për 70% nga viti 1968 në 1972. Në vitin 1975, Xerox tërhoqi një ofertë pune të bazuar në peshën e gruas. Përgjatë viteve të ‘60-ta dhe ‘70-ta gjykatat në vazhdimësi mbështetën të drejtën e punëdhënësve që të zbatojnë politika të bazuara në pamjen e jashtme për punonjëset gra. Politikisht mesazhi ishte i qartë: Si në botën jashtë, ashtu edhe në vend pune, gratë konsideroheshin të vlefshme përderisa ishin të bukura.

“Puna e Bukurisë” u bë puna e dytë e heshtur e grave të punësuar anembanë – përderisa avancimi estetik ngriti karrierën e tyre në disa mënyra, në disa të tjera i ngeci prapa. “Ne nuk konsiderojmë se hendeku gjinor është te koha dhe paratë e shpenzuara për t’u dukur bukur”, tha Renee Ebgehn. “Por koha dhe paratë janë të rëndësishme. Janë burimet esenciale të forcës dhe influencës dhe gjithashtu burimet kryesore të lirisë”, shtoi ajo.

Industria e bukurisë reagoi ndaj kësaj duke ribrenduar ndjekjen e së bukurës si formë e fuqizimit personal. Vëreni sloganin e famshëm të

L'Oréal-it: "Sepse unë ia vlej." Ky thuhet të jetë shkruar nga një autor burrë në vitin 1973. "Ishte një mendim ideal në periudhën kur gratë po kërkonin barazi më të madhe", thotë Tungate. Ishte kalimi nga kërkesa për t'u dukur bukur për të tjerët në nevojën për t'u dukur bukur për vete. "Kemi kaluar nga një kulturë që ta rikujton se trupi yt po shikohet te një kulturë ku ti je kontrolluesi i vazhdueshëm i trupit tënd", thekson Ebgein. Mesazhi i "fuqizimit të vetvetes" vazhdon të evoluojë krahas lëvizjes feministe sot – por fuqizimi i marketingut vazhdon të mbjellë pasiguri. (Korporatat munden vetëm të "fuqizojnë" klientët me produkte nëse klientët janë së pari të shfuqizuar). Ndoshta shembulli më i mirë për këtë është kampanja e Dove-s e vitit 2004 për Bukurinë e Vërtetë, ku u paraqitën gra të vërteta në vend të modeleve. Përgjatë viteve, seritë e tilla janë lavdëruar për rebelimin kundrejt standardeve të bukurisë. Megjithatë ironikisht produkti në reklamën e parë ishte një krem për fiksimin e lëkurës që premntonte se zvogëlon paraqitjen e celulitit.

Celuliti është natyral dhe normal dhe mënjanimi i tij është i pamundshëm. Ne tentojmë të zbardhim apo ta errësojmë lëkurën tonë. Ne ndryshojmë ngjyrën dhe strukturën e flokut. Ne largojmë dhjamin nga barku dhe krahët për ta vendosur pastaj te gjinjtë apo te të pasmet. Ne heqim qimet nga këmbët dhe nënsqetullat; për t'i ngjitur te qerpikët dhe te vetullat. Gjërat që ne idealizojmë janë pamundësi fizike, pra shpenzimi i kohës dhe parave në ndjekje të tyre nuk përfundon asnjëherë dhe gjithë kjo është e qëllimshme.

"Shitja e produkteve është qëllimi i vetëm", tregon Phyllis Ellis, realizuesja e dokumentarit të vitit 2018, Toxic Beauty. "Nëse mendojmë se industria e bukurisë ka qëllime të tjera, atëherë gabohemi. Por kam ndjeshmëri dhe e kam të qartë pjesën e turpërimit të bukurisë. Nuk është ideja të bëjmë njerëzit të ndihen keq pse përdorin maskarë. Jam e interesuar t'i përkulem pyetjes pse e përdorin atë", shtoi ajo.

Pse-ja është ajo çka dua të eksploroj çdo muaj në “Standard Issues”, një hapësirë e dedikuar për zbulimin dhe shkëlqimin e rrënjëve të kalburave të industrisë së bukurisë dhe ndërtimin e diçkaje më të mirë. Një industri që pasiguritë nuk i ka pre të saj gjatë gjoja shitjes në emër të fuqizimit. Një definicioni të së bukurisë që nuk përshtatet tërësisht me definicionin e patriarkatit. Një botë ku nuk duhet të shohim vrasje gjakftohta të grave dhe burrave zezakë, në mënyrë që të dalin në pah në titujt kryesorë produktet e brendeve të zezakëve.

Unë besoj se angazhimi për përmbysjen e standardeve të bukurisë është angazhimi për liri, barazi, mirëqenie dhe kujdes ndaj vetes e komunitetit. Ky lloj angazhimi është shpirtëror, politik, thelbësor. Sepse kur standardet e bukurisë ndryshojnë, ndryshon vetë bota.

Jessica DeFino në TeenVogue

Përktheu: Bardha Nikoliqi



11

‘Miti i virgjërisë’ ende po vazhdon!

Në mesjetë, para se një grua të bëhej nuse e mbretërisë, duhej të kontrollohej para natës së dasmës nëse ajo ishte e virgjër apo jo. “Himeni është një membranë jo krejtësisht pa gjak”, shkroi Louise Bourgeois, një obstetëre e shekullit të 17-të. “Në mes ka një vrimë të vogël, në të cilën zbrazet gjaku menstrual. Në momentin e penetrimit të parë, himeni prishet, gjë që shkakton pak dhimbje dhe rrjedhje të gjakut. Kjo tregon se një grua është e virgjër”, vazhdonte ajo.

Në realitet, shumë vajza lindin pa himen, ndërsa të tjerat e grisin membranën shumë kohë përpara se të kryejnë marrëdhënie seksuale, më së shpeshti duke ushtruar. Megjithatë, kërkesa për testimin e virgjërisë – zakonisht, një ekzaminim gjinekologjik në të cilin mjeku kontrollon se a është himeni – është zakon që vazhdon edhe në kohët e sotme. Në vitin 1979, qeveria britanike i bëri një ekzaminim të tillë një gruaje indiane 35-vjeçare me qëllim që “të shihte nëse ishte në të vërtetë një virgjëreshë e mirëfilltë”, meqenëse ajo kishte udhëtuar në Londër për t’u martuar. (The Guardian më vonë zbuloi se zyrtarët e imigracionit i nënshtruan më shumë se 80 gra në teste të tilla nga viti 1976 deri në 1979.) Ndërsa autoritetet egjiptiane përdorën pretekstin e inspektimeve të virgjërisë për të sulmuar protestat e grave gjatë pranverës së vitit 2011 (ku ndodhën protesta të shumta kundër qeverisë arabe) dhe deri në korrik të vitit 2021 ku ushtria indoneziane kryente rregullisht inspektime të tilla, jo vetëm për rekrutet gra, por edhe për të fejuarat e ushtarëve burra.

Sot, kjo praktikë vazhdon në mesin e disa komuniteteve myslimane në Evropë, Azi dhe Afrikë, romët në Evropë dhe disa komunitete ortodokse hebreje dhe fundamentalisht të krishtera në Shtetet e Bashkuara. Dy vite më parë, reperi amerikan T.I. (Clifford Joseph Harris Jr.) pohoi se ai çdo vit e çonte vajzën e tij në kontroll te gjinekologu për të vërtetuar “virgjërinë” e saj. “Po, unë shkoj me të... që nga ditëlindja e saj e 18-të, himeni i saj është ende i paprekur”, tha ai. Ndërsa më vonë ai tha se kjo histori ishte bërë sensacion, sepse ai nuk kishte qenë kurrë në dhomën kur bëhej ekzaminimi dhe se vajza e tij nuk kishte asnjë kundërshtim për këtë. Megjithatë, vajza e tij Deyjah Harris, tha se ndiente se “nuk mund të thoshte jo”.

Vjeshtën e vitit të kaluar, Britania ishte bërë gati të ndalojë testet e virgjërisë dhe po konsideronte ndalimin e operacionit për riparimin e himenit. Kjo do të ishte një fitore mbresëlënëse, sepse në një epokë që u jep prioritet çështjeve romantizuese dhe sensacionale, meqenëse feministet e kanë të vështirë që të mbajnë interesin në fushatat të ngadalta kundër traditave të dëmshme dhe patriarkale. (Shumë njerëz supozojnë se një praktikë që tingëllon si kjo mesjetare duhet të jetë hequr deri tani.) Një ndërlikim tjetër është se testi i virgjërisë dhe operacioni i riparimit të himenit praktikohen kryesisht nga anëtarë të pakicave fetare dhe etnike, gjë që i bën shumë liberalë të frustruar në kritikimin e atyre që kërkojnë këto procedura. Mbrojtësve të të drejtave të grave u është dashur gjithashtu të kundërshtojnë një lloj spinazhi tinëzar politik. Praktikuesit e testimit të virgjërisë dhe kirurgjisë së riparimit të himenit janë përpjekur t’i riemërojnë ato në një mënyrë neutrale dhe pozitive: shumë faqe mjekësore në internet i paraqesin këto procedura jo si metoda patriarkale të vjetruara për zbatimin e pastërtisë, por si forma fuqizuese – rinovuese të kujdesit ndaj vetes, duke i krahasuar me mbushjen e buzëve ose ngritjen e fytyrës.

Testet e virgjërisë nuk janë vetëm degraduese, por edhe të padobishme. Organizata Botërore e Shëndetësisë e ka bërë të qartë: “Nuk ka asnjë meritë shkencore apo indikacion klinik për “testimin e virgjërisë” apo “ekzaminimin e virgjërisë”. Përveç inspektimeve të himenit, metoda tjetër kryesore është “testi me dy gishta”, e cila shërben për të kontrolluar ngushtësinë e vaginës. Këto teste janë shumë më invazive dhe njëkohësisht të pakuptimta.

Për këtë arsye, qeveria e kryeministrit britanik Boris Johnson kohët e fundit u angazhua për t’i bërë të paligjshme testet e virgjërisë. Richard Holden, anëtar i ri konservator i Parlamentit, ka propozuar një amendament që kriminalizon këtë praktikë. Ai gjeti 21 klinika që ofronin këtë shërbim në Mbretërinë e Bashkuar, duke paguar deri në 300 £ (358 euro) për një certifikatë virgjërie. Ndërkohë, në Shtetet e Bashkuara, një studim i vitit 2016 me 300 gjinekologë zbuloi se 10.1 % kishin pasur të paktën një pacient që kishte kërkuar një test virgjërie në 12 muajt e fundit dhe 3.5 % kishin kryer një test të tillë.

Njëherë e një kohë, familjet kërkonin të shihnin çarçafët e njollosur me gjak në mëngjesin pas dasmës, ose të dërgonin vajzat te një mami për testimin me dy gishta. Diana Nammi, themeluesja e Organizatës për të Drejtat e Grave Iraniane dhe Kurde me qendër në Londër (IKWRO), kishte thënë se tani “kjo praktikë është ‘modernizuar’ duke i dërguar gratë për t’u kontrolluar para natës së martesës në klinikë”. Aneeta Prem, themeluesja e grupit për të drejtat e grave, Freedom Charity, më tha se testimi i virgjërisë është bërë pjesë e “paketës” që kërkohet nga familja: “Nuk është vetëm fotografia, edukimi, gatimi apo pastrimi. Në këtë paketë hyn edhe prova e virgjërisë.”

Anipse qeveria britanike duket e gatshme të ndalojë testimin e virgjërisë, përgjigjja e saj ndaj propozimit të Holden-it për të ndaluar gjithashtu të ashtuquajturat operacione të riparimit të virgjërisë ka qenë më pasive. Ashtu si testimi i virgjërisë, himenoplastika është një pseudoshkencë e

pastër: Një studim i vitit 2012 nga studiues holandezë zbuloi se 17 nga 19 gra që kishin bërë operacionin nuk kishin pasur gjakderdhje natën e tyre të dasmës. Shpesh ka ndodhur që nuk ka pasur mbetje të himenit mjaftueshëm për t'u qepur, kështu që kirurgët krijojnë një himen artificial duke përdorur lëkurën e murit vaginal. Himenoplastika është një formë e gjymtimit gjenital femëror, tha Holden-i. “Kjo është një praktikë mjekësore mashtruese. Ne nuk do t'i lejonim njerëzit të thoshin se ekzistojnë elfë që jetojnë në flokët e tyre! Meqenëse është demantuar nga shkenca mjekësore, pse dreqin po e lejojmë ende atë?”

E megjithatë operacionet estetike janë të vështira për t'u ndaluar nëse ekziston kërkesa për to. Himenoplastika është një procedurë e reklamuar gjerësisht në Amerikën e Veriut dhe Evropë, e kryer zakonisht si operacion ambulator nën anestezi lokale ose të përgjithshme me një kosto prej rreth 4000 dollarësh. Ai kryhet nga më shumë se një duzinë klinika në Harley Street të Londrës, shtëpia tradicionale e mjekësisë britanike, si dhe nga kirurgë në të gjitha Shtetet e Bashkuara dhe Kanada.

Mjekët që reklamojnë procedurën (ose mbrojnë operacionin) përdorin thirrjet feministe të zgjedhjes dhe fuqizimit. “Duke ofruar këtë shërbim, ne hapim derën për gratë që duan të kërkojnë këtë trajtim dhe u japim atyre mundësi. Nuk varet nga unë apo nga qeveria, opsioni është i grave”, tha një mjek në Britani për Sky News këtë verë. Dy vjet më parë, një mjek nga Nju Jorku që kryen himenoplastikë – duke përfshirë vajzat nën 18 vjeç me pëlqimin e prindërve – i tha një intervistuesi se zyra e tij ishte një “hapësirë e sigurt” për vajzat dhe gratë.

Megjithatë, shumë nga gratë që kërkojnë himenoplastikë, e bëjnë këtë sepse kanë frikë për jetën e tyre. Në vitin 2002, 16-vjeçarja Heshu Jones, nga komuniteti kurd në Londrën Perëndimore, u vra nga babai i saj pasi dyshohet se dështoi në testin e virgjërisë. Babai i saj ia preu fytyrën dhe më pas tentoi ta vriste veten. Vrasja ishte e para që u njoh si një “vrasje nderi” në Britani.

Që nga fillimi i pandemisë së koronavirusit, Aneeta Prem ka vërejtur një rritje prej 40% të thirrjeve në linjën telefonike Freedom Charity, pasi mbylljet e shkollave dhe bizneseve kanë bërë të paarrtshme burimet e tjera të mbështetjes emocionale. Disa nga gratë telefonojnë të kërkojnë ndihmë për të mbledhur paratë për kirurgji. “Një vajzë na kërkoi të paguanim himenoplastikën për të”, tha ajo. Kur Prem-i refuzoi, vajza i tha se do të duhej të bëhej prostitutë për të mbledhur paratë, sepse familja e të fejuarit do ta vriste nëse do të zbulonte se ajo nuk ishte e virgjër. “Unë njoh vajza që kanë thënë në natën e tyre të dasmës se do të marrin gjak të rremë, ose do të marrin një brisk në shtrat me vete, vetëm për të gjakosur diku.” Amazon kishte shitur “pilula të himenit artificial”, të cilat pas një proteste të mbajtur në Indi kundër tyre, i hoqi nga shitja në disa vende. Megjithatë, shitësit e palëve të treta ende i shesin këto pilula, të cilat përmbajnë gjak të rremë. Prem-i beson se vetëm sanksionimi i këtyre veprimeve mund të frenojë obsesionin me virgjërinë, i cili po nxit dhunën e bazuar në nder.

Kundërshtarët e testimit të virgjërisë dhe riparimit të virgjërisë në Mbretërinë e Bashkuar përballen me dy pengesa. E para është frika se çdo ndalim do të rezultojë me bërjen e tij në mënyrë ilegale ose, më shumë gjasa, jashtë vendit. Kjo është arsyeja pse avokuesit e të drejtave të grave duan që legjislacioni të kriminalizojë edhe dërgimin e vajzave jashtë shtetit për operacion. Diana Nammi nga IKWRO, është e bindur se e vetmja zgjidhje për shkatërrimin e kultit të virgjërisë është kriminalizimi i tij. “Duhet ta fshijmë, për të bërë histori”, tha ajo. Organizata e saj e sheh testimin e virgjërisë si pjesë të fiksimit më të gjerë kulturor mbi “nderin”.

Menaxherja e fushatave në IKWRO është 33-vjeçarja Payzee Mahmod, motra e së cilës, Banaz, u vra në Londër me urdhër të familjes së saj, sepse ishte larguar nga martesë e saj abuzive dhe e detyruar. (Babai dhe xhaxhai i Mahmodit u dënuan për vrasjen në vitin 2007, së bashku me tre burra të tjerë.)

E rritur në Iran, më tha Mahmodi, ajo ishte paralajmëruar të mos luante shumë, ose të ngiste biçikletë, apo edhe të ulej në mënyrë të gabuar sepse mund të griste aksidentalisht himenin e saj. Ajo tani bën fushata kundër martesës së fëmijëve dhe martesës së detyruar, si dhe kundër vrasjeve për nder dhe testimin të virgjërisë.

Pengesa e dytë është frika liberale për t'u dhënë municion racistëve dhe ksenofobëve, të cilët komentojnë në mënyrë oportuniste martesën e detyruar, gjykimin gjenital të femrave dhe praktika të tjera për të forcuar një narrativë të epërsisë së bardhë, perëndimore. “Kjo është dhunë ndaj grave,” tha Nammi. “Nuk duhet respektuar apo toleruar. Është një krim.” Ajo vëren se praktika nuk kufizohet vetëm në komunitetet myslimane, por kryhet edhe nga disa hebrenj dhe të krishterë.

Testimi i virgjërisë nuk ka vend në botën moderne. Është një formë dhune që normalizon dhunën e mëtejshme ndaj grave duke mbështetur idenë se sjellja seksuale është një çështje e reputacionit familjar ose e debatit publik. Kirurgjia për riparimin e virgjërisë është gjithashtu një formë dhune. Kirurgët nuk duhet të shfrytëzojnë procedurat qesharake pa përfitime mjekësore, vetëm për përfitime personale. Nuk ka asgjë paragjyquese për kundërshtimin e të dyja praktikave. Koha për t'i ndaluar këto praktika ka skaduar moti.

Helen Lewis në *The Atlantic*

Përktheu: Medinë Dauti



12

Unë nuk jam feministe, por...

Fëmijët e mi adoleshentë dhe unë po rrinim në kuzhinën tonë, ashtu siç kishim bërë mijëra herë më parë, kur njëri prej tyre tha diçka që më bëri të them: “Epo, unë e konsideroj veten feministe”.

Vajza ime 14-vjeçare më shikoi me habi: “A po?” Djali im 16-vjeçar dukej po aq i befasuar. U trondita. A ishte ky një zbulim i madh për ta? A nuk e kishin lidhur kurrë më parë idenë e feminizmit – absolutisht thelbësore për identitetin tim – me mua, nënën e tyre? Me sa duket jo.

Biseda që pasoi, në të cilën u përpoqa të jepja përkufizimin tim për feminizmin dhe të kuptoja të tyrin, ishte e vështirë. Unë krenohem që jam tipi i prindit që nuk inatoset nga mendimet e fëmijëve – ata janë qenie në fluks, por kësaj radhe e humba qetësinë. E kam quajtur veten feministe të paktën që nga viti i fundit i shkollës së mesme. Edhe më herët, si një fëmijë që u rrita në vitet 1970 – dhe si vajza e autorit të librit “Çështje në kritikën e filmit feminist” (1990) – unë përvetësova vlerat dhe synimet themelore të feminizmit. Gratë duhet të kenë të njëjtat mundësi pune si burrat dhe të paguhen njësoj për punën e tyre. Gratë janë dhe duhet të trajtohen si të barabarta me burrat, në ligj, moral dhe intelekt. Gratë duhet të kenë kontroll mbi trupin e tyre. E kështu me radhë.

Kur fëmijët e mi ishin shumë të vegjël, mora një vendim të vetëdijshëm, një vendim për të cilin fillova të pendohesha atë pasdite në kuzhinë, që nuk do të merresha shumë me çështjen “vajzat kundër djemve” dhe as nuk do t’u

jepja atyre biseda të forta për atë se si vajzat janë po aq të fuqishme sa djemtë. Pse të fusnin në kokat e tyre të pafajshme idenë që dikush e kishte menduar ndonjëherë ndryshe? Por tani pyesja veten nëse kisha gabuar. Ndoshta duhet të kisha prezantuar fjalën me F kohë më parë.

Kur i shtyva më tej fëmijët e mi, m'u bë e qartë se djali im asocionte feministet me vajzat në shkollën e tij, të cilat, sipas tij, ankoheshin vazhdimisht se ishin viktimizuar sepse ishin vajza, porse atij i dukej se kishin çdo avantazh që djemtë kanë. Vajza ime thjesht ndiente se barazia midis burrave dhe grave ishte arritur, dhe kështu nuk e kuptonte pse dikush sot do ta identifikonte veten me luftën feministe. Për të, të qenët feministe dukej se kishte aq kuptim sa të qenët një abolicioniste. Tashmë, unë kisha lot në sytë e mi. Si mund ta shpjegoj se, për mua, feminizmi nuk ka të bëjë vetëm me ligjet dhe qasjen në punë, por është diçka shumë më e madhe: një filozofi dhe një këndvështrim që informohet nga një studim i kujdesshëm i historisë, antropologjisë, biologjisë, sociologjisë dhe psikologjisë?

Në një blog në The Guardian këtë qershor, një vajzë 17-vjeçare britanike e quajtur Jinan Younis përkroi se i ishte nënshtruar një breshërie abuzimi në Twitter nga djemtë që ajo njihnte, pasi u përpoq të krijonte një shoqëri feministe në shkollën e saj. Komentet përfshinin deklaratat e tilla si: “të qenët feministe nuk do të thotë se nuk e pëlqejnë P [penisin], ato thjesht nuk kanë gjetur ende një për t'i kënaqur”. Abuzimi u shtua kur shoqëria feministe e Younis-it mori pjesë në projektin online “Who Needs Feminism”, në të cilin vajzat mbajnë shenja që plotësojnë fjalinë “Kam nevojë për feminizëm sepse...”. Siç raportoi Younis-i: “Na u tha se vaginat tona militante ishin të thata sa shkretëtira e Saharasë”. Detajet e jetës seksuale të disa prej vajzave u postuan pranë fotove të tyre, dhe të tjerave u dërguan mesazhe kërcënuese duke i paralajmëruar se gjërat së shpejti do të bëheshin personale.

A pasqyrojnë komentet e tilla të neveritshme qëndrimet e përhapura të djemve adoleshentë ndaj feminizmit? A tregojnë se çfarë pritjeje do t'i nënshtroheshin vajzat adoleshente nëse e identifikojnë veten si feministe? A ishte indiferenca e fëmijëve të mi fytyra më e mirë e një armiqësie të përgjithshme adoleshente ndaj idesë së feminizmit?

E shqetësuar nga pyetje të tilla, vendosa ta kryej studimin tim në shkallë të vogël mbi atë se çfarë mendojnë adoleshentët sot për feminizmin dhe feministët. A ndihen ata borxhli ndaj lëvizjeve feministe të së shkuarës, apo e shohin feminizmin si një tendencë periferike dhe një histori të parëndësishme?

Për të marrë përgjigje të qëndrueshme për pyetje të tilla, do të duhej një studim i madh dhe vite raportimi, por prapë mund të shihja një paraqitje të shkurtër të së vërtetës. Në vend që të përpiqem të arrij një diversitet të gjinisë, racës dhe klasës në grupin tim të vogël të të intervistuarve (15), vendosa një shkallë të caktuar rastësie. I pyeta fqinjët e mi dhe anëtarët e grupit tim të librit nëse mund të flisja me fëmijët e tyre dhe përfundova me nëntë vajza dhe gjashtë djem të intervistuar, duke përfshirë dy fëmijët e mi, të cilët i intervistova të fundit, duke i bërë të njëjtat pyetje formale që ua kisha bërë të tjerëve. Mosha ishte nga 13 deri në 19 vjeç. Njëmbëdhjetë të intervistuar ishin të bardhë, dy afrikano-amerikanë dhe dy ishin të përzier aziatikë të bardhë. Shtatë vijonin shkolla private, gjashtë vijonin shkolla publike dhe dy ishin të diplomuar në shkolla publike. Demografia ishte përgjithësisht me fëmijë të klasës së mesme dhe të lartë, megjithëse disa nga familjet po përjetonin vështirësi financiare për shkak të mungesës së punës së një prindi ose borxhit për shkollimin e tyre ose të fëmijëve të tyre. Qyteti ynë anon shumë nga drejtimi liberal dhe demokrat.

Kur i pyeta të intervistuarit e mi se çfarë dinin për historinë e të drejtave të grave, njohuritë e tyre ishin jashtëzakonisht të thata. Epokës së skllavërisë, emancipimit dhe të drejtave civile i kushtohet vëmendje e madhe në

shkollat tona lokale; lëvizjeve të ndryshme të grave më pak: vetëm beteja për votën ishte përfshirë në kurrikulë. Këta adoleshentë nuk po merrnin informacion as nga klubet jashtëshkollore. Megjithëse gjashtë shkolla lokale ishin të përfaqësuar në grupin tim të intervistave, vetëm njëra prej tyre kishte klub që mund të konsiderohej feminist. Një artikull i botuar në gazetën e shkollës pretendonte se grupi kishte më shumë se 30 anëtarë të të dy gjinive dhe ishte krijuar për t'u shpëputur nga stereotipat që zakonisht identifikohen me feministët. Gjithçka që të intervistuarit e mi dinin për klubin ishte se ai kishte bërë peticion për t'i lejuar vajzat të mbanin bluza pa mëngë, gjë që aktualisht ishte e ndaluar nga kodi i veshjes së shkollës. Kjo ishte jashtëzakonisht dëshpëruese.

Adoleshentët nuk po dëgjonin për feminizmin as në shtëpi. Vështirë se mund të ankohesha për këtë, pasi kisha zgjedhur vetë të njëjtën metodë. Pra, ku i merrnin informacionin dhe opinionet e tyre për feminizmin dhe barazinë gjinore? Kryesisht nga një amalgamë e diturisë së pranuar, vëzhgimit personal, medias, vetë-kureshtjes, dhe siç kuptova, përmes shembujve të dhënë nga nënat e tyre.

Kur i pyeta të intervistuarit e mi nëse besonin se ende ekzistonin pabarazi mes burrave dhe grave, pothuajse të gjitha vajzat dhe rreth gjysma e djemve thanë po. Vendi i punës u identifikua si vendndodhja e pabarazisë, në veçanti mungesa e grave në punët më të paguara dhe të profilit më të lartë. Nuk e di nëse kjo ishte për shkak se libri *Lean In* (2013) i Sheryl Sandberg-ut kishte marrë një vëmendje të madhe në atë kohë, apo sepse si fëmijë të familjeve të pasura, ata projektuan veten në grupin më me ndikim të punës, por në përgjithësi nuk kishte shumë vetëdije për betejat e grave në shkallët ekonomike më të ulëta.

Një vëlla dhe motër, 16 dhe 13 vjeç, u përpoqën të kuptonin pse nëna e tyre kishte lënë punën kur ishin të vegjël. “Në shumicën e familjeve, si në familjen tonë, sapo nëna të ndiejë se fëmijët nuk kanë kohë të mjaftueshme [me prindin], ajo do të largohet nga puna. Është gjithmonë nëna, por është kështu?”, tha vëllai.

Mamaja ime punoi derisa vendosi se donte të ishte me ne më shumë sesa të punonte me orar të plotë, kështu që supozoj se ata ranë dakord që mamaja ime të tërhiqej dhe babai im të vazhdonte punën. Por nuk jam vërtet e sigurt pse. Nuk është se babai im kishte një punë më të mirë apo ndonjë gjë tjetër, të dy kishin punë me pagesë të ngjashme”, tha motra. “Pse babai nuk qëndroi në shtëpi, pse është nëna ajo që duhet të heqë dorë nga puna?”, pyeti vëllai. “Sepse nënat janë më të ngrohta. Nënat janë më shumë Nëna”, u përgjigj motra e tij.

Një djalë e dalloj sportin si një fushë tjetër të pabarazisë për gratë, duke thënë se sportet e grave nuk financoheshin dhe frekuentoheshin pak. Disa nga të intervistuarit e mi, duke përfshirë një të diplomuar që kishte kryer punë vullnetare dhe kishte punuar jashtë vendit, kishin një perspektivë globale dhe theksuan se prostitucioni i detyruar, përdhunimi pa pasoja dhe skllavërimi virtual i grave ende ekzistojnë në shumë vende të tjera.

Në përgjithësi, adoleshentët me të cilët fola ishin të panjoftuar mbi zhvillimet e fundit në lidhje me të drejtat e grave. Ata kishin informata mbi incidente të izoluara që tërhoqën shumë vëmendjen e medieve, të tilla si komentet e bëra në vitin 2012 nga Todd Aiken, anëtar i Dhomës së Përfaqësuesve, i cili tha se “përdhunimi legjitim” nuk mund të rezultojë në shtatzëni, ose edhe për panelin që drejtoi një seancë dëgjimore mbi kontrollin e lindjeve, panel i cili ishte i tëri i përbërë nga burrat. Radioja Publike Kombëtare (NPR) ishte më së shpeshti burimi i informacioneve të tilla, ku fëmijët dëgjonin lajme kur prindërit e tyre i kishin ndezur televizorët. Prindër, kini parasysh: ekziston ende një mënyrë për t’u siguruar që fëmijët tuaj po i përvetësojnë lajmet.

Dyshoj se këta adoleshentë nuk janë më injorantë për skenën politike sesa homologët e tyre të mëparshëm. Nuk mbaj mend të kem kuptuar shumë procesin politik të SHBA-së apo polemikat aktuale derisa shkova në universitet, edhe pse unë dhe miqtë e mi, ndryshe nga shumica e

adoleshentëve sot, lexonim rregullisht gazetën e përditshme dhe shikonim lajmet e mbrëmjes në TV. Megjithatë, u habita nga mungesa e njohurive të të intervistuarve të mi për lëvizjen e grave. Historia politike e 20 apo 40 viteve të fundit ishte pothuajse bosh për shumicën prej tyre. Një e moshuar kishte më shumë informacion për shkak të një shkolle në të cilën kishte bërë një prezantim mbi historinë ligjore dhe sociale të dhunës ndaj grave. Vetëm katër adolehentë, njëri prej tyre djalë, përmendën çështjen gjyqësore Roe kundër Wade-it të vitit 1973, e cila legalizoi abortin në SHBA, ose betejën për të drejtat riprodhuese në përgjithësi; vetëm njëra prej tyre përmendi termin “vala e dytë” dhe lëvizjen e grave të viteve 1970. Kur e pyeta se ku kishte mësuar për këto gjëra, ajo tha se ishte kryesisht nga një artikull në Jezebel ose nga Wikipedia.

Ndërsa shumica e adolehentëve pohuan se nuk shihnin pabarazi gjinore në shkollat e tyre, disa raportuan se djemtë ndonjëherë nuk i merrnin seriozisht mendimet e vajzave brenda ose jashtë klasës dhe se në klasë djemtë flisnin më shumë se vajzat. Një vajzë 15-vjeçare u ankua se në javën e parë të shkollës së mesme, mësuesja e saj e matematikës, një grua, shprehu habinë që klasa kishte më shumë vajza sesa djem. “Ata presin që djemtë të jenë më inteligjentë”, tha studentja.

Çështja për të cilën vajzat – jo djemtë – aludonin më shpesh pas çështjes së vendit të punës dhe mungesës së respektit shoqëror, ishte ajo që disa prej tyre e quajtën “kultura e përdhunimit” ose “slut-shaming”. Ato nënkuptonin inkurajimin e agresionit seksual mashkullor dhe fajësimin ose turpërimin e grave që dhunohen seksualisht ose që sillen në mënyrë më të hapur seksuale. Nëse ka një ide femine të valës së dytë që duket se mbahet si një nen besimi nga adolehentët që nuk kanë dëgjuar kurrë për Susan Brownmiller-in, ajo ide është se përdhunimi nuk është një krim i dëshirës seksuale, por i pushtetit. Më kujtohet se si më tronditi ai formulim kur lexova veprën e Brownmiller-it “Kundër vullnetit tonë” (1975) kur isha 18 ose 19 vjeç. Tani kjo ide thjesht merret si e mirëqenë.

Një vajzë 15-vjeçare më tha se përdhunimi ishte “fakti që një burrë mendon se duhet të jetë superior ndaj grave dhe kjo është e vetmja mënyrë që munden ta manifestojnë këtë superioritet”. Një djalë 16-vjeçar tha se përdhunimi ishte i lidhur me faktin se “disa burra besojnë se kanë pushtet mbi gratë ose mund të marrin gratë nën kontroll. Kjo tregon se ata i mendojnë gratë si qenie inferiore”.

Tre të intervistuarit më të zëshëm për problemin e kulturës së përdhunimit ishin ndër më të moshuarit. Një nga të diplomuarit më tha se “përdhunimi është një çështje e madhe në kampuset e universiteteve”. Ajo foli për një grua në një universitet afër saj, raportimet e së cilës për përdhunim nuk u besuan dhe e cila më pas shfaqti simptoma post-traumatike. Ajo përmendi se orientimi i saj në universitet përfshinte prezantime që shpjegonin se si gratë mund të shmangin përdhunimin. Skenarët hipotetikë të paraqitur në to dukej se fajësonin gruan, me shkrime si: “Ajo duhet të kishte qenë më e qartë për atë që donte. Ajo nuk duhet të kishte qenë e dehur”. “Vajzat ndonjëherë mësojnë që në moshë të re se duhet të kenë frikë nga përdhunimi. Kam folur me miq që janë vërtet të shqetësuar për përdhunimin, edhe pse nuk janë as në situata kërcënuese. Ata thjesht shqetësohen për këtë në përgjithësi, si një lloj gjëje abstrakte. Dhe kjo është gjëja më e tmerrshme! Kjo nuk duhet të jetë diçka për të cilën njerëzit duhet shqetësuar në mënyrë konstante”, shtoi ajo.

E diplomuara tjetër tregoi një histori të ngjashme. Në vitin e saj të fundit të shkollës së mesme, grupi në klasën e saj rreth shëndetit lexoi një histori për një vajzë që ishte përdhunuar në një festë. “Pas leximit, unë dhe dy vajza të tjera kaluam pjesën e mbetur të klasës duke u përpjekur të bindnim një grup djemsh se, pavarësisht se çfarë kishte thënë apo kishte veshur viktimë në histori, përdhunimi ishte 100 për qind faji i përdhunuesit. Ne ishim të pasuksesshme. Ne nuk ishim të vetmet vajza në grup, i cili ishte mjaft i madh. Profesori nuk ndërhyri asnjëherë për të thënë se ne kishim të drejtë;

në vend të kësaj, ai mori pjesë sikur të ishte duke organizuar një debat abstrakt filozofik dhe në fakt sugjeroi që njerëzit t'i caktonin secilit personazh në histori nga një përqindje të fajit”, shkroi ajo në një email drejtuar mua. Një maturante e shkollës së mesme tha se kultura e përdhunimit ka të bëjë me “mendësinë se seksi është një produkt”. “Është ideja se seksi është diçka që burrat dëshirojnë dhe që gratë duhet ta japin në këmbim të mbështetjes emocionale ose takimeve të këndshme. Nga këndvështrimi mashkullor, mendohet se ‘OK, nëse bëj këtë dhe këtë, atëherë e meritoj seksin... Nëse nuk jeni duke bërë seks me mua ose nuk jeni në një marrëdhënie romantike me mua, atëherë unë jam disi i mashtruar””, shtjelloi ajo.

Për të intervistuarit e mi, kultura e përdhunimit dhe “slut-shaming” dukeshin më shumë si presione atmosferike sesa forca me të cilat do të përballeshin në jetën e tyre. Por kjo mund të jetë pasojë e asaj që të intervistuarit e mi nuk po më ofronin detaje rreth përvojave të tyre seksuale dhe romantike. Disa prej tyre ishin shumë të rinj për të pasur ndonjë të tillë. Kur intervistova më të moshuarit, ata pretenduan se kishin përjetuar pak dilema të rolit gjinor me partnerët e tyre të seksit të kundërt (asnjë prej tyre nuk u vetëpërcaktua, të paktën për mua, si homoseksual). Një djalë 15-vjeçar më tha se rolet tradicionale gjinore ende qëndrojnë kur bëhet fjalë për makinat. “Zakonisht nuk shoh një vajzë duke e vozitur një djalë, përveç nëse vajza është më e madhe dhe djali nuk mund të ngasë makinën”, tha ai. Kur e pyeta të spekulonte pse kjo ndodh, ai tha: “Nuk e di, në fakt. Është diçka që thjesht ekziston. Gjithmonë në filma e shohim se djali e merr vajzën nga shtëpia, djali e kthen në shtëpi”.

Pra, të intervistuarit e mi ishin të vetëdijshëm për pabarazinë gjinore dhe disa nga vajzat ishin të sensibilizuara për lidhjet midis seksualitetit dhe pushtetit. Por a e përkufizuan ata në të vërtetë kulturën e përdhunimit dhe përdhunimin si çështje feministe? Po në lidhje me çështjet e lidhura me trupin dhe seksualitetin, si aborti dhe dhuna në familje? Për mua nuk ka

dyshim se janë të lidhura. Ju nuk mund ta kuptoni plotësisht mbizotërimin e këtyre realiteteve shoqërore, apo ndikimin e tyre te gratë, pa kuptuar se si shoqëritë në mënyrë alternative i kanë ndaluar, inkurajuar, injoruar ose mbuluar këto akte. Kështu që pyeta secilin nga të intervistuarat e mia nëse e shihnin përdhunimin, abortin ose dhunën në familje si çështje specifike feministe. Vajzat më të moshuara prireshin të thoshin po. “Aborti është një çështje feministe në atë që pjesa më e madhe e debatit rreth moralit të ndërprerjes së shtatzënisë nënvlerëson opinionin dhe mirëqenien e gruas me fëmijë. Në një kuptim të ngjashëm, përdhunimi dhe dhuna në familje janë çështje feministe jo sepse janë unike për gratë, por për shkak të mënyrës se si diskutohen në media dhe trajtohen nga ligji”, u përgjigj njëra prej tyre.

Por disa nga djemtë dhe vajzat më të vogla ishin në mëdyshje. Ata dukej se mendonin se “feministe” do të thoshte “çështje vetëm për gratë”. Disa u përgjigjën se – ndonjëherë me bezdi – “Jo, kjo është një çështje njerëzore”. U theksua se edhe burrat përdhunohen dhe rrihen, kështu që përdhunimi dhe dhuna në familje nuk mund të jenë çështje feministe. Ndërsa folëm më shumë, disa thanë se aborti, përdhunimi dhe dhuna në familje mund të shiheshin si çështje feministe në raste të caktuara – për shembull, nëse policia ose gjykatat refuzonin të ndiqnin një rast përdhunimi. Një djalë 16-vjeçar tha se edhe ky i fundit nuk do ta konsideronte domosdoshmërisht përdhunimin një çështje feministe. “Ndjenja ime është se nëse kjo do të ndodhte, nuk do të ishte për shkak se përdhunimi nuk u mor seriozisht, por sepse është shumë e vështirë të ndjekësh penalisht çështjet e përdhunimit. Duhet të merren prova fizike shpejt, dhe nëse nuk mund të merren, është dëshmia e një personi kundër një tjetri, përveç nëse ka dëshmitarë. Cili prokuror do të donte të merrte një çështje që nuk mund ta fitonte? Është e drejtë që nuk duhet të dënohesh në këto raste, shtoi ai. I njëjti djalë tha se aborti dikur ishte një çështje feministe, por që nga Roe kundër Wade-it, nuk është më e tillë. Kur theksova se shumë shtete të

SHBA-së po zvogëlojnë qasjen në abort, ai ndryshoi mendje, duke thënë se nuk e kishte ditur këtë dhe se mund ta shilte mbrojtjen e asaj që tashmë ishte arritur si një qëllim feminist. Nëse shkollat tona japin mesazhe të përziera, nëse feminizmi nuk diskutohet në shtëpi dhe nëse disa stereotipa gjinorë ende qëndrojnë, ku po e marrin këta adoleshentë pranimin bazë të idesë së barazisë gjinore? Ata e pranuan se besonin në atë ide. Shumë kishin një përgjigje të thjeshtë për këtë pyetje: nënat e tyre. Nuk dukej se kishte rëndësi nëse ato nëna punonin jashtë shtëpisë apo jo. “Gjatë fëmijërisë sime nëna ime gjithmonë kishte një karrierë. Gjithmonë kam menduar se burrat dhe gratë duhet të jenë të barabartë”, tha njëra prej vajzave. Kur theksova se nëna e saj kishte lënë punën për të rritur katër fëmijë dhe ishte kthyer në punë vetëm kur e intervistuar ime, fëmija i tretë ishte rreth nëntë vjeç, ajo u përgjigj: “Nuk di si ta shpjegoj. Ajo në njëfarë mënyre gjithmonë ka qenë një nënë që punonte; ajo ka qenë gjithmonë shumë ambicioze”.

“Mamaja ime ka një pozitë të fortë në punë dhe ajo sapo u avancua. Kështu që unë kam qenë rreth grave në pozita më të larta. Ajo ka një ndikim të mirë tek unë për të më shtyrë të jem e fortë dhe e pavarur. Shumë nga shoqet e mia kanë prindër që janë divorcuar, kështu që ato kanë nëna që janë të forta”, më tha një vajzë tjetër. Megjithatë, një vajzë tjetër tha se nëna e saj, e cila nuk ishte e punësuar, nuk i kishte folur kurrë drejtpërdrejt për feminizmin, por ishte nënë e fortë, e cila ia kishte përcjellë mesazhin se “nuk duhet t’i lini njerëzit t’ju pengojnë; ju mund të bëni çfarë të doni”.

A i shtyn këto adoleshente transmetimi i qëndrimeve të tilla që të përkufizohen si feministe? Iu ktheva pyetjes me të cilën fillova – çfarë mendojnë vërtet adoleshentët për atë term? Edhe pse kisha frikë se shumë nga këta të rinj do të thoshin se feministet ishin burra-urrejtëse të zemëruara që digjnin sutienat, u befasova këndshëm. Akuza se feministet ankoheshin shumë ishte komenti më negativ që u dha. Disa të intervistuar nuk mund të krijonin një paramendim për një feministe, por mes atyre që e krijuan, Rosie the Riveter ishte përgjigja më e shpeshtë.

Kjo figurë propagandistike amerikane e epokës së Luftës së Dytë Botërore, me mëngët e saj të përveshura dhe bicepsin e zhvilluar, është bërë disi një ikonë e përgjithësuar e forcës dhe kompetencës femërore. Fëmijët kishin mësuar për Rosie-n nga burime të ndryshme – disa nga shkolla; nga një vëlla a motër, nga fakti se nëna e tyre kishte marrë një kuti mjekesh për ditëlindjen e saj me një kartë Rosie (Ne mundemi!). Isha e lumtur që kujtesa e tyre ishte kaq pozitive, por nuk jam e sigurt se çfarë të mendoj për faktin se pothuajse askush nuk përmendi një figurë më bashkëkohore. Hillary Clinton? Alice Walker? Tina Fey? Një 17-vjeçare tha se mendonte për Buffy the Vampire Slayer dhe Barack Obama, teksa ai ishte shfaqur në montazhin e kopertinës së revistës Ms. në vitin 2009, duke grisur këmbishën e tij për të zbuluar sloganin: Kështu duket një feminist.

Sa i përket faktit nëse të intervistuarit e mi e shihnin veten si feministë/e, përgjigjet ishin të ndara. Asnjëri nga djemtë nuk e pranoi këtë, me përjashtim të një 18-vjeçari që u përgjigj me po dhe jo, duke sugjeruar se nuk ishte i sigurt se termi “feminist” mund të përdorej për një burrë. Djem të tjerë dhe një vajzë, më thanë se një djalë apo një burrë nuk mund të jetë feminist. Dy të tretat e vajzave thanë se ishin feministe. Mosha bëri të gjithë ndryshimin. Të gjitha vajzat e moshës 16 vjeç e lart thanë se ishin feministe, ndërsa të gjitha, përveç njëres prej vajzave më të reja, thanë se nuk ishin feministe ose kishin vështirësi t’i përgjigjeshin pyetjes.

Unë u largova nga bisedat e mia duke u ndier mjaft optimiste për adoleshentët e sotëm, të paktën ata që po pranojnë arsimim të mirë dhe jetojnë në familje të qëndrueshme. Edhe pse shumë prej tyre nuk kishin një koncept veçanërisht të saktë ose të detajuar të feminizmit, shumica dukej se kishin zhvilluar zakonet e mendjes – kuriozitetin, skepticizmin, respektin për informacionin e ri; të gjitha këto kanë të ngjarë t’i çojnë ata në pozicione të mirë-menduara për këto çështje.

Megjithatë, në disa aspekte, mbetem e shqetësuar. Unë nuk e kuptoj se si

termi “feminist” do të fitojë ndonjëherë më shumë pranim sesa ka tani, kur të rriturit dhe adoleshentët njësoj vazhdojnë ta përkufizojnë atë në mënyra të ngushta. Kur i pyeta vajzat që nuk e konsideronin veten feministe pse nuk e konsideronin ashtu, ato thanë ose se nuk ishin aktiviste, ose sepse çështje të tjera ishin më të rëndësishme për to. Unë e shoh feminizmin si një lente përmes së cilës mund të shikosh botën, ose si një grup mjetesh interpretuese. Por shumica e këtyre të rinjve e shohin feminizmin si një akt. Bëhet fjalë për mbajtjen e pankartave dhe krijimin e tolloive. Është gjithashtu një emërtim ekskluziv. Një 15-vjeçare tha se nuk mund ta quante veten feministe, sepse kishte prioritetë të tjera – në rastin e saj, një interes për qeverinë dhe atë që ajo e quajti udhëheqje. Ajo nuk e shihte të qenit feministe si diçka që mund të bashkëjetonte dhe madje të informonte ato pasione të saj.

Në të njëjtën kohë, mungesa e bazës në historinë dhe mendimin feminist mund të prodhojë gjithashtu një feminizëm aq të gjerë, sa e bën të jetë i pakuptimtë. Një 17-vjeçare më tha se besonte se ne ishim në një fazë në të cilën feminizmi është “çfarëdo që ne duam të jetë”. “Nëse ti [një grua] gjen diçka fuqizuese për ty, shumë mirë. Nëse dëshiron të jesh shtëpiake dhe të bësh biskota gjatë gjithë ditës, përsëri shumë mirë. Nëse jo, përsëri shumë mirë”, shpjegoi ajo. E pyeta nëse kishte ndonjë akt që ajo nuk do ta quante feminist vetëm sepse një grua e deklaroi si të tillë. Ajo përmendi një raport për një grua që kishte nxjerrë në ankand në internet virgjërinë e saj. Gruaja deklaroi se ky ishte një akt feminist, sepse ajo po e kthente vlerën që shoqëria patriarkale i vë virgjërisë së një gruaje, në përfitimin për vete. “Por nëse po përfitoni vetëm ju, nuk mund ta quani atë akt feminist. Ai akt ende po promovon patriarkatin”, shtoi studentja. Kjo studente është qartësisht mjaft e sofistikuar për të bërë dallime, por “feminizmi është çfarëdo që ne duam të jetë” është një nocion miqësor i kulturës pop që mund të çojë në rezultate perverse.

Kur e pyeta këtë studente qartazi të pasionuar dhe të motivuar se nëse

kishte lexuar ndonjë nga librat kryesorë mbi feminizmin, ajo tha nuk e kishte lexuar as Susan Brownmiller-in, as Susan Faludi-n, as Naomi Wolf-in dhe as Betty Friedan-in, megjithëse kishte dëgjuar për librin e saj “The Feminine Mystique” dhe planifikonte ta lexonte ndërkohë. Që të zhyten në këtë literaturë, mund të jetë kërkesë shumë e madhe për nxënës të shkollave të mesme. Por nëse edhe ky rast i veçantë – një vajzë 17-vjeçare që tha se e kishte quajtur veten feministe që në moshën gjashtëvjeçare – jo vetëm nuk kishte lexuar, por nuk dukej se ishte në dijeni të shumicës së letërsisë feministe të valës së dytë dhe pas valës së dytë, mendoj se krijon arsye për shqetësim. Ajo mund t’i lexojë këta libra në universitet – nuk do të habitesha; unë vetë nuk arrita t’i lexoj deri në universitet. Por shumica e bashkëmoshatareve të saj, dhe pothuajse të gjithë bashkëmoshatarët e saj, ndoshta nuk do t’i lexojnë kurrë. Ata nuk do të ndjekin ligjëratat e studimeve mbi gratë; ata nuk do ta bazojnë impulsin e tyre refleksiv drejt barazisë me një njohuri që do ta bëjë atë më fleksibël dhe më të qëndrueshme, në mënyrë që të mund të nxjerrin përfundime koherente për rastin e ardhshëm të përdhunimit ose debatin mbi buxhetin ose padinë për diskriminim në lajme.

Të rinjtë e sotëm ndoshta janë më egalitar se çdo brez i mëparshëm. Por ata ka gjasa të mos gjejnë një kuptim për termin e pakapshëm “feminist”, dhe kjo është një humbje për të gjithë ne.

Pamela Erens në Aeon

Përktheu: Riola Morina

Artikujt origjinal

1. **Ferrante, E.** (2018, March 17, *The Guardian*).
Retrieved from tinyurl.com/2z96rxce
2. **Gerassi, J.** (1995, *Marxist.org*).
Retrieved from tinyurl.com/2uckze38
3. **Taddeo, L.** (2021, June 13, *The Guardian*).
Retrieved from tinyurl.com/3jcwnf62
4. **Butler, J.** (2019, July 10, *The New York Times*).
Retrieved from tinyurl.com/4drxtsru
5. **Eliot, L.** (2019, February 27, *Nature*).
Retrieved from tinyurl.com/3pycxwfy
6. **Fraser, S. L.** (2016, *Dissent Magazine*).
Retrieved from tinyurl.com/t6zt4d4k
7. **Watta, A.** (2020, July 27, *SheThePeople*).
Retrieved from tinyurl.com/bddhet9m
8. **Kisner, J.** (2021, February 17, *The New York Times*).
Retrieved from tinyurl.com/37m26tzm
9. **Sánchez, E. L.** (2015, May 28, *America.AlJazeera*).
Retrieved from tinyurl.com/57ztm2px
10. **Defino, J.** (2020, October 19, *Teen Vogue*).
Retrieved from tinyurl.com/4cnmecum
11. **Lewis, H.** (2021, September 16, *The Atlantic*).
Retrieved from tinyurl.com/2y2sxc5
12. **Erens, P.** (2013, October 14, *Aeon*).
Retrieved from tinyurl.com/2p8as52j

